ASCAP

VEPRIMTARI PRAKTIKE

NË ARSIMIN E MESËM TË LARTË

Klasa X

Gjuhë shqipe, Letërsi, Gjuhët e huaja

www.ascap.edu.al

2026

I. HYRJE 3

II. QËLLIMI I UDHËZUESIT 4

III. PËRDORUESIT E UDHËZUESIT 5

IV. PARIMET PËR HARTIMIN E VEPRIMTARIVE PRAKTIKE 6

V. LIDHJA E VEPRIMTARIVE PRAKTIKE ME REZULTATET E TË NXËNIT 8

VI. VEPRIMTARITË PRAKTIKE PËR LËNDËT: GJUHË SHQIPE, LETËRSI, GJUHË E HUAJ E PARË DHE GJUHË E HUAJ E DYTË (GJUHË ANGLEZE, GJUHË FRËNGE, GJUHË ITALIANE DHE GJUHË GJERMANE) 9

LËNDA: GJUHË SHQIPE 9

LËNDA: LETËRSI 102

LËNDA: GJUHË ANGLEZE 169

LËNDA: GJUHË E HUAJ E DYTË, KLASA 10 DHE 11 209

GJUHË FRËNGE 209

GJUHË ITALIANE 226

GJUHË GJERMANE 257

I. HYRJE

Përditësimi i Kornizës Kurrikulare, i kurrikulave bërthamë dhe i programeve lëndore në arsimin parauniversitar ka sjellë nevojën për rishikimin e mënyrës së planifikimit dhe zhvillimit të procesit mësimor, duke e orientuar atë më qartë drejt të nxënit aktiv dhe përfshirjes së nxënësit në situata reale të të nxënit. Këto përditësime synojnë forcimin e koherencës ndërmjet qëllimeve kurrikulare, rezultateve të të nxënit dhe praktikës mësimore në klasë.

Veprimtaritë praktike gjatë orës mësimore përbëjnë një komponent thelbësor për përvetësimin e njohurive, koncepteve dhe aftësive, si dhe për arritjen e rezultateve të të nxënit. Ato u krijojnë nxënësve mundësi konkrete për të zbatuar njohuritë në situata nga jeta e përditshme dhe kontekste reale, për të zhvilluar aftësi praktike, për të ndërtuar njohuri të qëndrueshme dhe për të demonstruar kompetencat e synuara. Në këtë mënyrë, procesi mësimor zhvendoset nga një qasje e fokusuar kryesisht në transmetimin e njohurive drejt një të nxëni aktiv, të mbështetur në veprim, eksplorim, bashkëpunim dhe reflektim.

Përditësimet kurrikulare theksojnë gjithashtu përdorimin e metodave bashkëkohore të mësimdhënies, të cilat marrin në konsideratë diversitetin e nxënësve, ritmet e ndryshme të të nxënit dhe ndërlidhjen ndërmjet lëndëve. Në këtë kontekst, veprimtaritë praktike shërbejnë si element lidhës ndërmjet përmbajtjes së programeve lëndore dhe përvojave konkrete të nxënësve, duke ndikuar pozitivisht në motivimin dhe angazhimin e tyre në procesin e të nxënit.

Ky udhëzues synon të mbështesë mësuesit në zbatimin e programeve lëndore të përditësuara, duke ofruar shembuj orientues të veprimtarive praktike të strukturuara sipas cikleve arsimore, klasave dhe lëndëve përkatëse. Veprimtaritë e përfshira janë hartuar në përputhje me parimet e programit lëndor dhe synojnë të lehtësojnë planifikimin, organizimin dhe zhvillimin e orëve mësimore që kontribuojnë drejtpërdrejt në zhvillimin e kompetencave dhe përmbushjen e rezultateve të të nxënit.

II. QËLLIMI I UDHËZUESIT

Qëllimi i këtij udhëzuesi është të shërbejë si një instrument mbështetës për mësuesit në zbatimin sa më cilësor të programeve të përditësuara lëndore, përmes veprimtarive praktike mësimore të orientuara drejt përmbushjes së rezultateve të të nxënit dhe zhvillimit të kompetencave kyçe, si dhe kompetencave specifike të lëndës. Ai synon të lehtësojë kalimin nga dokumenti kurrikular në zbatimin konkret të tij në klasë, duke ofruar shembuj veprimtarish të strukturuara, të shpjeguara qartë dhe të përshtatshme për kontekste të ndryshme mësimore.

Nëpërmjet veprimtarive të propozuara, udhëzuesi mbështet mësuesit në planifikimin dhe organizimin e situatave të të nxënit që nxisin pjesëmarrjen aktive të nxënësve, zhvillojnë mendimin kritik, *aftësinë* për zgjidhjen e problemeve, bashkëpunimin dhe komunikimin. Këto veprimtari synojnë të krijojnë lidhje funksionale ndërmjet njohurive teorike dhe përvojave konkrete në klasë, duke ndihmuar nxënësit të kuptojnë më mirë konceptet e reja, t'i zbatojnë ato në situata praktike dhe të ndërtojnë njohuri të qëndrueshme.

Udhëzuesi ofron orientime për përzgjedhjen dhe përdorimin e metodave dhe strategjive bashkëkohore të mësimdhënies, duke nxitur përshtatjen e tyre sipas karakteristikave të klasës, ritmeve dhe stileve të ndryshme të të nxënit, si dhe nevojave individuale të nxënësve. Në këtë mënyrë, ai kontribuon në zhvillimin e një mësimdhënieje gjithëpërfshirëse, fleksibile dhe të orientuar drejt nxënësit.

Gjithashtu, udhëzuesi synon të mbështesë koherencën ndërmjet planifikimit mësimor, zbatimit të orës së mësimit dhe vlerësimit të të nxënit, duke ndihmuar mësuesit të lidhin më qartë rezultatet e të nxënit me veprimtaritë konkrete. Kjo qasje ndihmon në rritjen e efektivitetit të procesit mësimor dhe në monitorimin më të mirë të progresit të nxënësve.

Udhëzuesi synon të kontribuojë në unifikimin e praktikave mësimore, në rritjen e cilësisë së mësimdhënies dhe në forcimin e rolit të mësuesit si lehtësues i të nxënit dhe udhëheqës pedagogjik në klasë, duke mbështetur zbatimin koherent dhe të qëndrueshëm të kurrikulës dhe programeve të përditësuara.

III. PËRDORUESIT E UDHËZUESIT

Ky udhëzues është hartuar për të mbështetur aktorë të ndryshëm të përfshirë në procesin arsimor, duke synuar zbatimin sa më efektiv të kurrikulës së përditësuar në praktikën e përditshme mësimore. Përdoruesit kryesorë të tij janë mësuesit e arsimit parauniversitar, sipas cikleve arsimore, klasave dhe lëndëve për të cilat janë hartuar veprimtaritë praktike. Për mësuesit, udhëzuesi shërben si material referues për planifikimin ditor, javor dhe afatmesëm të mësimit, duke ofruar shembuj veprimtarish që mund të përzgjidhen, përshtaten ose kombinohen në funksion të rezultateve të të nxënit, nivelit të klasës dhe karakteristikave të nxënësve.

Veprimtaritë e paraqitura nuk kanë karakter detyrues, ato janë orientuese dhe fleksibile, duke i lënë mësuesit hapësirë për përshtatje sipas kontekstit të klasës, ritmeve dhe stileve të ndryshme të të nxënit, si dhe nevojave individuale të nxënësve. Në këtë mënyrë, udhëzuesi lidhet drejtpërdrejt me procesin e planifikimit mësimor dhe me vlerësimin e të nxënit, duke ndihmuar mësuesit të ndërtojnë situata të të nxënit që mbështesin zhvillimin e kompetencave dhe monitorimin e progresit të nxënësve.

Udhëzuesi është gjithashtu një mbështetje për kryetarët e ekipeve lëndore dhe drejtuesit e rrjeteve profesionale, të cilët mund ta përdorin për të nxitur shkëmbimin e praktikave të mira, për të organizuar diskutime profesionale dhe për të forcuar bashkëpunimin ndërmjet mësuesve. Ai shërben si referencë e përbashkët për reflektim profesional dhe për harmonizimin e praktikave mësimore në nivel shkolle apo rrjeti.

Udhëzuesi përbën një burim të dobishëm edhe për trajnerët duke ofruar shembuj konkretë të praktikave mësimore dhe orientime për zhvillimin profesional të mësuesve. Në një këndvështrim informues, udhëzuesi mund të shërbejë edhe për prindërit, duke i ndihmuar të kuptojnë më qartë mënyrën se si organizohen veprimtaritë praktike dhe si lidhen ato me zhvillimin e njohurive, aftësive dhe kompetencave të nxënësve.

IV. PARIMET PËR HARTIMIN E VEPRIMTARIVE PRAKTIKE

Hartimi dhe zbatimi i veprimtarive praktike në këtë udhëzues mbështetet në parimet themelore të kornizës kurrikulare dhe të programeve të arsimit parauniversitar. Është e rëndësishme të theksohet se ***udhëzuesi nuk trajton zhvillimin e plotë të një ore mësimore***, ***por ofron modele të veprimtarive të veçanta mësimore,*** të cilat mund të integrohen në struktura të ndryshme të orës, në varësi të planifikimit të mësuesit dhe qëllimeve të përcaktuara në programin lëndor.

Veprimtaritë janë ndërtuar në funksion të arritjes së rezultateve të të nxënit dhe sigurimit të koherencës ndërmjet programit lëndor, zbatimit në klasë dhe vlerësimit. Ato synojnë të konkretizojnë në praktikë përditësimet kurrikulare, duke mbështetur zhvillimin e nxënësit si individ aktiv, i përgjegjshëm dhe i aftë për të zbatuar njohuritë në situata të ndryshme.

Veprimtaritë praktike udhëhiqen nga këto parime:

- ✓ **Qasja e bazuar në kompetenca.** Çdo veprimtari synon integrimin e njohurive, aftësive dhe qëndrimeve në situata konkrete të të nxënit, duke kontribuar në zhvillimin e kompetencave kyçe dhe atyre specifike të lëndës.
- ✓ **Nxënësi në qendër të procesit.** Veprimtaritë marrin në konsideratë karakteristikat zhvillimore, interesat, ritmet dhe stilet e ndryshme të të nxënit, duke garantuar përfshirje aktive dhe angazhim kuptimplotë.
- ✓ **Të nxënit aktiv dhe përmes përvojës.** Të nxënit realizohet përmes veprimit, eksplorimit, analizës, diskutimit dhe reflektimit, duke nxitur ndërtimin e njohurive të qëndrueshme.
- ✓ **Lidhja me kontekste reale.** Veprimtaritë krijojnë mundësi për zbatimin e njohurive në situata autentike, duke rritur kuptimin dhe relevancën e të nxënit.
- ✓ **Bashkëpunimi dhe komunikimi.** Puna në grup, shkëmbimi i ideve dhe ndërveprimi i strukturuar kontribuojnë në zhvillimin e aftësive sociale dhe qytetare.

- ✓ **Gjithëpërfshirja.** Veprimtaritë janë konceptuar në mënyrë që të krijojnë mundësi reale pjesëmarrjeje për të gjithë nxënësit, duke respektuar diversitetin dhe nevojat individuale.
- ✓ **Fleksibiliteti në zbatim.** Veprimtaritë janë orientuese dhe mund të përshtaten sipas kontekstit të klasës, burimeve në dispozicion dhe nivelit të nxënësve, pa cenuar rezultatet e synuara.
- ✓ **Vlerësimi për të nxënit.** Vlerësimi integrohet natyrshëm brenda veprimtarisë, përmes vëzhgimit, pyetjeve orientuese, reflektimit dhe vetëvlerësimit, në funksion të përmirësimit të vazhdueshëm të të nxënit.

V. LIDHJA E VEPRIMTARIVE PRAKTIKE ME REZULTATET E TË NXËNIT

Veprimtaritë praktike të përfshira në këtë udhëzues janë hartuar në lidhje të drejtpërdrejtë me rezultatet e të nxënit të përcaktuara në programet lëndore, sipas tematikave përmbajtjesore përkatëse. Kjo do të thotë se veprimtaria nuk paraqitet si aktivitet i izoluar, por si pjesë funksionale e arritjes së objektivave të përcaktuara në program.

Lidhja ndërmjet rezultateve të të nxënit dhe veprimtarive praktike bazohet në parimin e koherencës kurrikulare. Për secilën tematikë janë identifikuar rezultatet përkatëse dhe janë propozuar veprimtari që u krijojnë nxënësve mundësi reale për t'i demonstruar ato përmes veprimit, analizës, diskutimit, argumentimit apo zgjidhjes së situatave problemore. Në këtë mënyrë, fokusi nuk qëndron vetëm në përvetësimin e njohurive faktike, por në aftësinë për t'i përdorur ato në kontekste të ndryshme dhe për të ndërtuar kuptim të thelluar.

Përmes veprimtarive praktike, nxënësit kanë mundësi të tregojnë se kuptojnë konceptet, të aplikojnë njohuritë në situata të reja, të analizojnë informacionin, të bashkëpunojnë me të tjerët dhe të reflektojnë mbi procesin e të nxënit. Kjo e bën të dukshme arritjen e rezultateve jo vetëm në nivel njohurish, por edhe në nivel aftësish dhe qëndrimesh. Veprimtaritë krijojnë gjithashtu hapësirë për diferencim, duke i mundësuar mësuesit të përshtatë kërkesat sipas nivelit të nxënësve, pa devijuar nga rezultatet e synuara.

Kjo lidhje e qartë ndërmjet rezultateve të të nxënit dhe veprimtarive praktike mbështet mësuesin në planifikimin e qëndrueshëm të procesit mësimor dhe në përzgjedhjen e metodave të përshtatshme. Ajo lehtëson gjithashtu vlerësimin e progresit të nxënësve, pasi kriteret e vlerësimit mund të ndërtohen drejtpërdrejt mbi rezultatet që synohen të arrihen përmes veprimtarisë.

Udhëzuesi ofron një kornizë praktike që garanton koherencë ndërmjet planifikimit, zbatimit dhe vlerësimit, duke e bërë procesin mësimor më të strukturuar, më transparent dhe më të orientuar drejt arritjeve konkrete të nxënësve.

VI. VEPRIMTARITË PRAKTIKE PËR LËNDËT: GJUHË SHQIPE, LETËRSI, GJUHË E HUAJ E PARË DHE GJUHË E HUAJ E DYTË (GJUHË ANGLEZE, GJUHË FRËNGE, GJUHË ITALIANE DHE GJUHË GJERMANE)

LËNDA: GJUHË SHQIPE

Veprimtaritë praktike në lëndën e gjuhës shqipe

Veprimtaritë praktike në lëndën e gjuhës shqipe mbështeten në qasjen metodologjike të përqendruar te nxënësi, ku të nxënit zhvillohet përmes përvojës, bashkëveprimit, reflektimit dhe përdorimit funksional të gjuhës në situata të ndryshme komunikimi. Ato ndërtohen duke u nisur nga tekste të ndryshme joletrare, situata komunikimi, çështje me interes për të rinjtë dhe problematika të jetës shoqërore, kulturore e qytetare, duke i angazhuar nxënësit në procese të tilla si leximi kritik, analiza, interpretimi, diskutimi, argumentimi, kërkimi, krijimi i teksteve dhe prezantimi i ideve. Kjo qasje synon ta vendosë nxënësin në qendër të procesit të të nxënit, jo vetëm si përvetësues të njohurive, por edhe si përdorues aktiv të gjuhës shqipe për të kuptuar botën, për të ndërtuar qëndrime dhe për të komunikuar në mënyrë efektive. Nëpërmjet veprimtarive praktike, nxënësit zhvillojnë aftësitë për të analizuar dhe për të interpretuar tekste të ndryshme, për të vlerësuar informacionin dhe burimet, për të ndërtuar argumente të mbështetura në fakte dhe prova, si dhe për të shprehur mendimet dhe qëndrimet e tyre në mënyrë të qartë, të logjikshme dhe të përgjegjshme. Veprimtaritë praktike kanë një rol të rëndësishëm në zhvillimin e kompetencave të lëndës së gjuhës shqipe, të cilat janë:

- Të dëgjuarit dhe të folurit për qëllime të ndryshme;
- Të lexuarit e teksteve të ndryshme;
- Krijimi i teksteve të ndryshme;
- Përdorimi i drejtë i gjuhës.

Nëpërmjet këtyre kompetencave, nxënësit zhvillojnë jo vetëm njohuritë gjuhësore, por edhe aftësitë e komunikimit, të mendimit kritik, të bashkëpunimit dhe të të nxënit gjatë gjithë jetës. Veprimtaritë krijojnë mundësi që ata të lidhin njohuritë e reja me përvojat e tyre, të reflektojnë mbi çështje të ndryshme dhe të zbatojnë në praktikë atë që mësojnë.

Veprimtaritë lidhen drejtpërdrejt me rezultatet e të nxënit, pasi çdo hap i tyre është i orientuar drejt demonstrimit konkret të njohurive, aftësive, qëndrimeve dhe vlerave që nxënësi duhet të zhvillojë. Njëkohësisht, ato i ofrojnë mësuesit mundësi për të vlerësuar në mënyrë të vazhdueshme progresin e nxënësve përmes vëzhgimit të pjesëmarrjes së tyre, produkteve të punës, diskutimeve, prezantimeve dhe performancës në situata të ndryshme të të nxënit.

Ky material është hartuar si një mbështetje praktike për mësuesit në planifikimin dhe zhvillimin e veprimtarive që ndihmojnë në përmbushjen e disa rezultateve të të nxënit të përcaktuara në programin lëndor të gjuhës shqipe për klasën e dhjetë. Materiali është organizuar sipas katër kompetencave kryesore të lëndës. Për secilën kompetencë janë përzgjedhur disa rezultate të nxëni dhe janë hartuar modele veprimtarish praktike që ilustrojnë mënyra konkrete të realizimit të tyre në klasë.

Çdo veprimtari përfshin situatën e të nxënit, hapat e zhvillimit, momentet e diskutimit dhe të reflektimit, si dhe produktin e pritshëm të nxënësit. Veprimtaritë synojnë të nxisin angazhimin aktiv të nxënësve, zhvillimin e të menduarit të pavarur, aftësitë analitike dhe përdorimin e gjuhës si mjet komunikimi, njohjeje dhe krijimtarie.

Veprimtaritë e paraqitura në material kanë karakter orientues dhe nuk synojnë të kufizojnë krijimtarinë pedagogjike të mësuesit. Ato mund të përshtaten, të pasurohen ose të riorganizohen në përputhje me kontekstin e klasës, tekstet shkollore përkatëse, interesat dhe nevojat e nxënësve, duke ruajtur gjithmonë fokusin te arritja e rezultateve të të nxënit dhe zhvillimi i kompetencave gjuhësore.

Tabela 1. Shembuj veprimtarish praktike për përmbushjen e rezultateve të të nxënit të kompetencës "Të dëgjuarit dhe të folurit për qëllime të ndryshme"

<table>
<tr><th>REZULTATET E TË NXËNIT</th><th>VEPRIMTARITË PRAKTIKE</th></tr>
<tr><td>Nxënësi shpreh mendim të argumentuar në diskutime, duke u bazuar në informacionin e dëgjuar.</td><td>
Veprimtaria "A jemi gjithmonë të informuar mirë?"
Prezantimi i veprimtarisë
Mësuesi u tregon nxënësve se do të dëgjojnë një fragment audio (ose një tekst të lexuar nga mësuesi) me temë: "Ndikimi i rrjeteve sociale në informimin e të rinjve".
Para dëgjimit, nxënësit diskutojnë shkurt:
• Nga cilat burime informoheni më shpesh?
• A kontrolloni gjithmonë nëse informacioni është i saktë?
• A mund të ndikojnë rrjetet sociale në mënyrën si formojmë mendimet tona?
Mësuesi u kërkon nxënësve të dëgjojnë me vëmendje argumentet që paraqiten në material.
Zhvillimi i veprimtarisë
Hapi 1: Dëgjimi aktiv
Nxënësit dëgjojnë materialin. Gjatë dëgjimit mbajnë shënime në një tabelë:
<table>
<tr><th>Informacioni kryesor</th><th>Argumentet ose faktet që e mbështesin</th></tr>
<tr><td></td><td></td></tr>
</table>
Hapi 2: Organizimi i informacionit
</td></tr>
</table>

	Pas dëgjimit, nxënësit punojnë në dyshe dhe krahasojnë shënimet. Së bashku identifikojnë: • idenë kryesore të materialit; • argumentet kryesore të paraqitura; • shembujt ose faktet që janë përdorur për t'i mbështetur ato. *Hapi 3: Qëndrimi im* Mësuesi drejton pyetjen: *A mendoni se rrjetet sociale janë burim i besueshëm informacioni për të rinjtë?* Nxënësit marrin disa minuta për të ndërtuar qëndrimin e tyre. Ata plotësojnë skemën: Qëndrimi im: _____ Argumenti 1: _____ Argumenti 2: _____ Informacion nga materiali që mbështet mendimin tim: _____ *Hapi 4: Diskutimi i argumentuar* Nxënësit organizohen në grupe. Secili paraqet mendimin e tij duke u mbështetur në informacionin e dëgjuar. Mësuesi kujton se nuk mjafton të thuhet: "*Jam dakord.*" ose "*Nuk jam dakord*.", por duhet të përdoren formulime të tilla si: • Mendoj se... • Sipas informacionit që dëgjuam... • Një argument që e mbështet këtë është...

	• Një shembull i përmendur në material ishte... Nxënësit dëgjojnë dhe reagojnë ndaj argumenteve të njëri-tjetrit. *Hapi 5: Përmbledhja e diskutimit* Çdo grup përzgjedh argumentin që iu duk më bindës dhe shpjegon pse. Diskutohet: • Cilat argumente mbështeteshin më mirë në informacionin e dëgjuar? • Cilat ishin më bindëse? • Pse faktet dhe shembujt e bëjnë një mendim më të fortë? ***Reflektimi*** Mësuesi pyet: • Si ju ndihmoi dëgjimi i materialit për të ndërtuar mendimin tuaj? • Pse është e rëndësishme të mbështesim mendimet me argumente? • A ndryshoi qëndrimi juaj pas diskutimit? Nxënësit arrijnë në përfundimin se një mendim bëhet më bindës kur mbështetet në informacion, fakte dhe argumente të marra nga materiali i dëgjuar. ***Produkti*** Çdo nxënës harton një paragraf të shkurtër argumentues ku shpreh qëndrimin e tij mbi çështjen e diskutuar, duke përdorur të paktën dy argumente të mbështetura në informacionin e dëgjuar.

<table>
<tr>
<td>Nxënësi reflekton për përmbajtjen e tekstit, duke e lidhur me përvojat dhe njohuritë personale.</td>
<td>

Veprimtaria “Ky tekst më kujtoi...”

Prezantimi i veprimtarisë

Pas dëgjimit të një teksti me karakter shoqëror ose motivues (p.sh. një rrëfim për vullnetarizmin, përballimin e vështirësive, ndikimin e teknologjisë, marrëdhëniet familjare etj.), mësuesi u drejton nxënësve pyetjet:

- Cila pjesë e tekstit ju bëri më shumë përshtypje?
- A ju kujtoi ky tekst ndonjë përvojë tuajën?
- A keni përjetuar ndonjë situatë të ngjashme?
- A lidhet tema e tekstit me diçka që keni mësuar më parë?

Mësuesi shpjegon se të kuptuarit e një teksti bëhet më i thellë kur lexuesi ose dëgjuesi e lidh atë me përvojat, njohuritë dhe realitetin e vet.

Zhvillimi i veprimtarisë

Hapi 1: Dëgjo dhe mbaj shënime

Nxënësit dëgjojnë tekstin dhe mbajnë shënime në një tabelë të thjeshtë:

Ide ose mesazh i rëndësishëm nga teksti	Çfarë më kujton mua?

Hapi 2: Lidhja me jetën personale

Nxënësit punojnë individualisht dhe plotësojnë fjalitë:

- Ky tekst më kujtoi _____.
- Kam përjetuar diçka të ngjashme kur _____.

</td>
</tr>
</table>

- Ajo që më bëri më shumë përshtypje ishte _____.
- Mendoj se mesazhi i tekstit është i rëndësishëm sepse _____.

Mësuesi i nxit të japin përgjigje personale dhe të argumentuara.

Hapi 3: Diskutimi në grupe

Nxënësit ndahen në grupe të vogla dhe ndajnë reflektimet e tyre. Gjatë diskutimit ata duhet të shpjegojnë:

- cilën përvojë personale lidhën me tekstin;
- cilat njohuri të mëparshme i ndihmuan ta kuptonin më mirë;
- nëse teksti ndikoi në mënyrën si e shohin çështjen e trajtuar.

Mësuesi kujton se nuk ka vetëm një përgjigje të saktë, pasi secili mund ta lidhë tekstin me përvoja të ndryshme.

Hapi 4: "Nga teksti te jeta"

Në tabelë paraqitet organizuesi:

Në tekst	**Në jetën time**
Çfarë ndodhi?	Kam përjetuar...?
Çfarë mësova?	Çfarë kam mësuar unë?
Cili ishte mesazhi?	Pse është i rëndësishëm për mua?

Nxënësit e plotësojnë tabelën e mësipërme individualisht dhe më pas ndajnë disa prej reflektimeve me klasën.

Hapi 5: Reflektimi i shkurtër

	Çdo nxënës shkruan një paragraf të shkurtër duke filluar me një nga këto fjali: • Ky tekst më bëri të mendoj për... • Përvoja ime lidhet me tekstin sepse... • Pas dëgjimit të tekstit kuptova se... ***Reflektimi*** Mësuesi pyet: • Pse është e rëndësishme ta lidhim tekstin me përvojat tona? • A ju ndihmoi kjo lidhje ta kuptonit më mirë mesazhin? • A mund të kenë nxënës të ndryshëm reflektime të ndryshme për të njëjtin tekst? Nxënësit arrijnë në përfundimin se kuptimi i një teksti pasurohet kur e lidhim atë me përvojat, njohuritë dhe këndvështrimet tona. ***Produkti*** *Një paragraf reflektues*, ku nxënësi lidh përmbajtjen dhe mesazhin e tekstit të dëgjuar me përvoja, njohuri ose situata nga jeta e tij.
Nxënësi vlerëson përmbajtjen, strukturën dhe përdorimin e elementeve joverbale (gjeste, mimikë, ton, intonacion).	**Veprimtaria "Analiza e një prezantimi publik"** ***Prezantimi i veprimtarisë***

	Mësuesi u tregon nxënësve një video të shkurtër (2–4 minuta) nga një fjalim motivues i të rinjve ose një prezantim publik i përshtatshëm për moshën e tyre. Para shikimit, mësuesi shtron pyetjen: *Çfarë e bën një prezantim tërheqës: vetëm ajo që thuhet apo edhe mënyra si thuhet?* Nxënësit japin mendimet e tyre. Mësuesi shpjegon se gjatë veprimtarisë do të veprojnë si analistë komunikimi dhe do të vlerësojnë jo vetëm përmbajtjen, por edhe mënyrën e paraqitjes. ***Zhvillimi i veprimtarisë*** *Hapi 1: Shikimi i parë - Çfarë thotë folësi?* Nxënësit ndjekin videon pa mbajtur shënime. Pas shikimit diskutojnë: • Cila ishte tema? • Cili ishte mesazhi kryesor? • Cilat ide ju kujtohen më shumë? Mësuesi evidenton në tabelë idetë kryesore. *Hapi 2: Shikimi i dytë - Si e thotë folësi?* Këtë herë klasa ndahet në katër grupe. Çdo grup merr një detyrë. • *Grupi i përmbajtjes:* A ishte informacioni interesant? A kishte argumente dhe shembuj? • *Grupi i strukturës:* A kishte hyrje? Si u zhvilluan idetë? A kishte përfundim? • *Grupi i gjuhës së trupit:* Çfarë gjestesh përdori? A kishte kontakt me dëgjuesit? • *Grupi i zërit:* Si ishte toni? Kur ndryshonte intonacioni? A përdorte pauza?

	Gjatë shikimit secili grup mban shënime. *Hapi 3: Krijimi i panelit të ekspertëve* Pas videos formohet një panel. Një përfaqësues nga secili grup prezanton gjetjet. P.sh.: • Mendojmë se prezantimi kishte strukturë të qartë, sepse në fillim folësi paraqiti problemin, më pas shpjegoi shkaqet dhe në fund propozoi disa zgjidhje. • Folësi e tërhoqi vëmendjen e audiencës duke nisur prezantimin me një shembull nga jeta e përditshme. • Vumë re se zëri bëhej më i fortë në momentet kur prezantoheshin argumentet kryesore. • Folësi mbante kontakt me sy me audiencën, gjë që e bënte komunikimin më të drejtpërdrejtë. • Pauzat e shkurtra ndërmjet ideve ndihmonin dëgjuesin të kuptonte më mirë informacionin. • Fotografitë e përdorura në slajde lidhen drejtpërdrejt me temën dhe ndihmonin në kuptimin e mesazhit. *Hapi 4: Sfida "Hiqe zërin!"* Mësuesi rishfaq 30–40 sekonda të videos pa zë. Nxënësit diskutojnë: • Çfarë emocionesh përcjell folësi vetëm me mimikë? • A duket i sigurt? • Si ndikojnë gjestet në kuptimin e mesazhit?

Më pas videoja shfaqet vetëm me zë (pa figurë). Nxënësit diskutojnë:

- Si ndikon intonacioni?
- A kuptohet kur folësi është i emocionuar apo i bindur?
- Çfarë roli kanë pauzat?

Hapi 5: Vlerësimi me rubrikë

Në grupe nxënësit plotësojnë një tabelë. Për çdo vlerësim duhet të japin një argument.

Elementi	Vlerësimi	Argumenti
Përmbajtja		
Struktura		
Gjestet dhe mimika		
Toni dhe intonacioni		

Hapi 6: Bëhu trajner komunikimi

Çdo grup përgatit një këshillë për folësin. P.sh.

- Mund të përdorte më shumë shembuj.
- Mund të mbante më shumë kontakt me audiencën.
- Mund të përdorte pauza më të shkurtra.

Këshillat prezantohen para klasës.

Reflektimi

	Mësuesi pyet: • Cili element ndikoi më shumë te ju: përmbajtja apo mënyra e paraqitjes? • A mund të jetë një mesazh i mirë, por i paraqitur dobët? • Si ndikojnë gjestet, mimika dhe intonacioni në bindjen e audiencës? Nxënësit arrijnë në përfundimin se komunikimi efektiv ndërtohet nga bashkëveprimi i përmbajtjes, strukturës dhe elementeve jo verbale. ***Produkti*** *Një vlerësim kritik i prezantimit*, ku nxënësi argumenton cilësinë e përmbajtjes, organizimin e ideve dhe përdorimin e elementeve jo verbale, duke mbështetur gjykimet e tij me shembuj konkretë nga videoja.
Nxënësi vlerëson besueshmërinë e burimit, duke dalluar faktet nga opinionet.	**Veprimtaria "A mund t'i besoj këtij informacioni?"** ***Prezantimi i veprimtarisë*** Mësuesi paraqet në ekran ose në tabelë dy postime të shkurtra që trajtojnë të njëjtën temë. *Postimi A:* Sipas UNESCO-s, në botë ekzistojnë mijëra gjuhë të ndryshme. Shumë prej tyre fliten nga komunitete të vogla dhe një pjesë konsiderohen gjuhë të rrezikuara. Humbja e një gjuhe shoqërohet me humbjen e një pjese të trashëgimisë kulturore dhe historike të komunitetit që e flet. *Postimi B:* Mendoj se çdo gjuhë duhet të ruhet, pavarësisht nga numri i folësve të saj. Sipas meje, gjuhët përfaqësojnë identitetin dhe kujtesën e një populli. Humbja e një gjuhe është një humbje për të gjithë njerëzimin. Mësuesi pyet:

- A janë të dyja informacione të njëjta?
- Cili mbështetet në të dhëna?
- Cili shpreh një gjykim personal?
- Cilin do të konsideronit më të besueshëm nëse do të shkruanit një ese?

Mësuesi shpjegon se jo çdo informacion që dëgjojmë ose lexojmë ka të njëjtin nivel besueshmërie. Për të gjykuar një burim, duhet të dallojmë faktet nga opinionet dhe të shqyrtojmë se kush e jep informacionin.

Zhvillimi i veprimtarisë

Hapi 1: Lexo si verifikues faktesh

Nxënësit ndahen në grupe. Çdo grup merr dy tekste të shkurtra për të njëjtën temë. Nxënësit nënvizojnë:

- *Faktet*
- *opinionet*

Hapi 2: Tabela e hetimit

Grupet plotësojnë tabelën:

Pyetja	Teksti A	Teksti B
Kush e jep informacionin?		
A ka fakte, prova ose të dhëna?		
A ka mendime personale?		
A është i besueshëm burimi?		

Nxënësit diskutojnë përgjigjet dhe argumentojnë zgjedhjet e tyre.

	Hapi 3: Roli i gazetarit Mësuesi paraqet disa pohime. P.sh.: • Shqipëria ka mbi 400 km vijë bregdetare. • Shqipëria ka plazhet më të bukura në botë. • Leximi ndihmon në pasurimin e fjalorit. • Leximi është mënyra më e këndshme për të kaluar kohën. Nxënësit duhet të vendosin: *Fakt* apo *Opinion*? Gjithashtu duhet gjithmonë të argumentojnë, si p.sh.: • *Ky është fakt sepse mund të verifikohet me të dhëna.* • *Ky është opinion sepse shpreh një gjykim personal.* *Hapi 4: Vlerësimi i burimit* Çdo grup merr një burim të ndryshëm: • një lajm nga një portal informativ; • një postim në rrjetet sociale; • një fragment enciklopedik; • një reklamë. Detyra është të përgjigjen:

	• Kush e ka publikuar? • Cili është qëllimi i mesazhit? • A ka më shumë fakte apo opinione? • Sa i besueshëm është burimi? Në fund grupet paraqesin përfundimet e tyre para klasës. *Hapi 5: Semafori i besueshmërisë* Në tabelë vendosen tri zona: • I besueshëm • Duhet verifikuar më tej • Jo i besueshëm Grupet vendosin burimet e analizuara në një nga tri kategoritë dhe argumentojnë zgjedhjen. ***Reflektimi*** Mësuesi pyet: • Pse nuk duhet t'i besojmë menjëherë çdo informacioni? • Si na ndihmon dallimi mes faktit dhe opinionit? • Cilat pyetje duhet t'i bëjmë vetes kur lexojmë një informacion?

	Nxënësit arrijnë në përfundimin se besueshmëria e një burimi varet nga autori, provat e paraqitura, qëllimi i mesazhit dhe prania e fakteve. ***Produkti*** Çdo nxënës harton një *kartë vlerësimi të burimit*, ku identifikon: • autorin ose institucionin; • faktet dhe opinionet; • nivelin e besueshmërisë së burimit; • argumentimin e gjykimit të tij.
Nxënësi respekton etikën e dëgjimit në diskutime online: dëgjon me kujdes, nuk e ndërpret folësin, nuk përdor gjuhë ofenduese në reagimet e tij dhe përdor një ton të matur dhe të përgjegjshëm.	**Veprimtaria "Debati virtual"** ***Prezantimi i veprimtarisë*** Mësuesi paraqet një situatë: *Një grup nxënësish po zhvillon një diskutim online për përdorimin e telefonit celular në shkollë. Gjatë diskutimit disa nxënës ndërpresin vazhdimisht njëri-tjetrin, përdorin komente ironike dhe reagojnë pa dëgjuar deri në fund mendimin e tjetrit.* Mësuesi pyet: • Çfarë problemesh vëreni në këtë diskutim? • Si do të ndiheshit nëse dikush do t'ju ndërpriste vazhdimisht? • A ndryshojnë rregullat e komunikimit kur diskutojmë online?

	Nxënësit ndajnë mendimet e tyre. Mësuesi shpjegon se, ashtu si në komunikimin ballë për ballë, edhe në mjediset digjitale duhet të respektohen rregulla etike që garantojnë komunikim të qytetëruar dhe të respektueshëm. ***Zhvillimi i veprimtarisë*** *Hapi 1: Vëzhgo dhe vlerëso* Mësuesi paraqet një fragment të shkurtër dialogu online: • Nxënësi A: Mendoj se telefonat mund të përdoren për kërkime gjatë mësimit. • Nxënësi B: Jo, e ke krejt gabim! • Nxënësi C: Lëre të mbarojë mendimin. • Nxënësi B: Po them të vërtetën. Nxënësit punojnë në grupe dhe identifikojnë: • sjelljet që respektojnë etikën e diskutimit; • sjelljet që nuk e respektojnë atë. Diskutojnë se si mund të përmirësohen reagimet. *Hapi 2: Rishkruaj komentin* Çdo grup merr komente tipike të rrjeteve sociale. P.sh.: *S'ke fare të drejtë. Kjo është një ide pa kuptim. Po flet kot.*

Detyra është t'i riformulojnë në mënyrë të respektueshme. P.sh.: *Unë e shoh ndryshe këtë çështje sepse... Nuk jam plotësisht dakord me këtë argument. A mund ta shpjegosh më tej mendimin tënd?*

Nxënësit kuptojnë se mund të kundërshtojnë pa ofenduar.

Hapi 3: Simulimi i forumit online

Klasa ndahet në grupe dhe zhvillon një diskutim mbi një temë aktuale për të rinjtë, p.sh.:

- A ndikojnë rrjetet sociale në rezultatet në mësime?
- A duhet të përdoret inteligjenca artificiale në shkollë?

Një nxënës luan rolin e moderatorit. Gjatë diskutimit secili grup duhet të respektojë rregullat:

- dëgjo deri në fund;
- mos e ndërprit folësin;
- argumento me qetësi;
- përdor gjuhë të respektueshme;
- kundërshto idenë, jo personin.

Hapi 4: Vëzhguesit e etikës

Disa nxënës kanë rolin e vëzhguesve. Ata plotësojnë një tabelë:

Sjellja	U respektua?	Shembull
Dëgjimi me vëmendje		
Mos ndërprerja e folësit		

Gjuha e respektueshme		
Toni i matur		

Pas diskutimit japin vërejtjet e tyre.

Hapi 5: Kodi i klasës për diskutimet online

Nxënësit hartojnë së bashku një listë me 5–7 rregulla që duhet të ndiqen në diskutimet online. P.sh.:

- Dëgjojmë para se të përgjigjemi.
- Respektojmë mendimet e ndryshme.
- Nuk përdorim gjuhë fyese.
- Argumentojmë me fakte.
- Ruajmë ton të qetë dhe profesional.

Kodi afishohet në klasë ose në platformën digjitale të klasës.

Reflektimi

Mësuesi pyet:

- Cila sjellje ishte më e vështirë për t'u respektuar?
- Pse është e rëndësishme të dëgjojmë para se të reagojmë?
- Si ndikon toni i komunikimit në cilësinë e diskutimit?

Nxënësit arrijnë në përfundimin se komunikimi i përgjegjshëm online kërkon respekt, vetëkontroll dhe dëgjim aktiv, po aq sa edhe aftësi për të argumentuar.

	Produkti *Një kod etik për diskutimet online*, i hartuar nga nxënësit, si dhe një vetë reflektim i shkurtër ku secili vlerëson nëse gjatë diskutimit:
Nxënësi zgjedh me kujdes fjalët, fjalitë dhe mjetet stilistike për të ndërtuar një mesazh të qartë, të bindshëm dhe të përshtatur sipas qëllimit, dëgjuesit dhe kontekstit.	**Veprimtaria "I njëjti mesazh, dëgjues të ndryshëm"** ***Prezantimi i veprimtarisë*** Mësuesi paraqet situatën: ***Shkolla dëshiron të organizojë një ditë pa telefona celularë gjatë pushimeve.*** Më pas pyet: • A do të flisnit njësoj me shokët e klasës, me drejtorin e shkollës dhe me prindërit për këtë ide? • A do të përdornit të njëjtat argumente? • A do të ishte i njëjtë toni i komunikimit? Nxënësit diskutojnë dhe arrijnë në përfundimin se mënyra e komunikimit ndryshon sipas dëgjuesit dhe qëllimit. ***Zhvillimi i veprimtarisë*** *Hapi 1: Analizo audiencën* Klasa ndahet në tri grupe. Të gjitha grupet kanë të njëjtin mesazh: "*Duhet të kemi më shumë aktivitete sportive në shkollë.",* por secili grup ka një audiencë të ndryshme: • Grupi A: nxënësit; • Grupi B: prindërit;

- Grupi C: drejtoria e shkollës.

Detyra është të diskutojnë:

- Çfarë argumentesh do të përdornin?
- Çfarë toni do të përdornin?
- Cilat fjalë do të ishin më bindëse për atë audiencë?

Hapi 2: Laboratori i fjalëve

Çdo grup harton një mesazh 1–2 minuta.

Mësuesi u kërkon të përdorin argumente, shembuj, pyetje retorike, krahasime ose figura të tjera stilistike, fjalor të përshtatshëm për audiencën.

P.sh.: Për nxënësit: *A nuk do të ishte më interesante pushimi i madh nëse do të kishim më shumë aktivitete sportive?*

Për drejtorin: *Aktivitetet sportive ndikojnë pozitivisht në mirëqenien dhe bashkëpunimin mes nxënësve.*

Hapi 3: Sfida e komunikuesit

Çdo grup prezanton mesazhin. Ndërsa dëgjojnë, grupet e tjera plotësojnë një fletë vlerësimi:

Elementi	Po	Pjesërisht	Jo
Mesazhi ishte i qartë			
Argumentet ishin bindëse			
Fjalori ishte i përshtatshëm			
Toni përputhej me audiencën			

	U përdorën mjete stilistike			

Hapi 4: Ndrysho audiencën

Mësuesi jep një sfidë të re. Mesazhi i grupit duhet t'i drejtohet një audience tjetër. P.sh.: Mesazhi që iu drejtua drejtorit tani duhet t'u drejtohet bashkëmoshatarëve. Nxënësit analizojnë:

- Çfarë duhet të ndryshojnë?
- Cilat fjalë nuk funksionojnë më?
- Cilat argumente bëhen më të rëndësishme?

Hapi 5: Juria e komunikimit

Klasa zgjedh mesazhet që:

- ishin më të qarta;
- kishin argumentet më bindëse;
- përshtatën më mirë gjuhën me dëgjuesin;
- përdorën në mënyrë efektive elemente stilistike.

Vendimet duhet të argumentohen.

Reflektimi

Mësuesi pyet:

- Pse nuk mund të përdorim të njëjtin mesazh për çdo audiencë?

	• Si ndikojnë zgjedhja e fjalëve dhe toni në bindjen e dëgjuesit? • Cilat mjete stilistike e bënë mesazhin më tërheqës? Nxënësit arrijnë në përfundimin se komunikimi efektiv kërkon jo vetëm ide të mira, por edhe përshtatjen e gjuhës, argumenteve dhe stilit sipas qëllimit dhe dëgjuesit. ***Produkti*** *Një mesazh argumentues i prezantuar gojarisht*, i ndërtuar për një audiencë të caktuar, ku nxënësi përdor me vetëdije fjalorin, strukturën, tonin dhe mjetet stilistike për të komunikuar në mënyrë të qartë dhe bindëse.
Nxënësi mbron qëndrimin personal, duke argumentuar mendimet e veta dhe duke respektuar rregullat e diskutimit (*koha, rolet, rendi i fjalës*).	**Veprimtaria "Debati i strukturuar"** ***Prezantimi i veprimtarisë*** Mësuesi paraqet një pohim që lidhet me interesat e të rinjve: *"Rrjetet sociale ndikojnë më shumë negativisht sesa pozitivisht në jetën e të rinjve."*. Nxënësit pozicionohen në klasë sipas qëndrimit të tyre: • Pajtohem; • Nuk pajtohem; • Jam i pavendosur. Mësuesi thekson se qëllimi i veprimtarisë nuk është të "*fitohet*" debati, por të argumentohet një qëndrim dhe të respektohen rregullat e komunikimit. ***Zhvillimi i veprimtarisë*** *Hapi 1: Ndërtimi i argumenteve* Nxënësit punojnë individualisht dhe plotësojnë tabelën:

Qëndrimi im	Argumenti 1	Argumenti 2	Shembull/Fakt

Mësuesi i orienton që argumentet të mbështeten në përvoja, njohuri, shembuj ose të dhëna konkrete.

Hapi 2: Përgatitja e diskutimit

Në çdo grup përcaktohen role:

- folësi i parë;
- folësi i dytë;
- përmbledhësi;
- vëzhguesi i rregullave.

Vëzhguesit marrin një fletë ku do të evidentojnë:

- respektimin e kohës;
- respektimin e rendit të fjalës;
- përdorimin e argumenteve;
- respektin ndaj mendimit ndryshe.

Hapi 3: Debati

Diskutimi zhvillohet në tri raunde.

Raundi I - Paraqitja e qëndrimit: Çdo nxënës ka 1 minutë për të paraqitur qëndrimin dhe argumentin kryesor.

Rregull: Askush nuk ndërhyn gjatë kohës së folësit.

	Raundi II - Reagimi ndaj argumenteve: Nxënësit mund të kundërshtojnë ose të mbështesin argumentet e dëgjuara duke përdorur formulime të tilla si: *Jam dakord me këtë argument sepse... Unë e shoh ndryshe këtë çështje sepse... Mendoj se duhet të kemi parasysh edhe faktin se...* *Raundi III – Përfundimi:* Secili përmbledh qëndrimin e vet dhe argumentin që e konsideron më bindës. *Hapi 4: Vlerësimi i diskutimit* Vëzhguesit raportojnë: • Kush argumentoi më qartë? • Kush solli shembuj bindës? • A u respektua koha? • A u respektua rendi i fjalës? • A pati ndërprerje ose reagime të papërshtatshme? Diskutohet se cilat sjellje e ndihmojnë dhe cilat e pengojnë një diskutim cilësor. *Hapi 5: Reflektimi personal* Nxënësit plotësojnë një fletë reflektimi: • Cilin argument tim e konsideroj më të fortë? • A dëgjova me vëmendje argumentet e të tjerëve? • A respektova radhën e fjalës? • Çfarë mund të përmirësoj në diskutimin e ardhshëm?

	Reflektimi Mësuesi pyet: • Pse argumentimi është më i rëndësishëm se thjesht shprehja e një mendimi? • A mund të mos pajtohemi dhe njëkohësisht të respektojmë njëri-tjetrin? • Si ndikojnë rregullat e diskutimit në cilësinë e debatit? Nxënësit arrijnë në përfundimin se një diskutim i mirë kërkon jo vetëm ide dhe argumente, por edhe respekt për folësin, kohën dhe mendimet e të tjerëve. ***Produkti*** *Pjesëmarrja në një debat të strukturuar,* ku nxënësi: • paraqet dhe mbron qëndrimin e vet; • përdor argumente dhe shembuj mbështetës; • dëgjon argumentet e të tjerëve; • respekton kohën, rolet dhe rendin e fjalës gjatë diskutimit.
Nxënësi prezanton në grup projekte të përbashkëta, me ndarje të qartë rolesh dhe përgjegjësish.	**Veprimtaria "Konferenca e nxënësve"** ***Prezantimi i veprimtarisë*** Mësuesi paraqet situatën: *Shkolla po organizon një aktivitet me temë "Të rinjtë dhe sfidat e botës digjitale". Çdo grup duhet të përgatisë dhe të prezantojë një projekt përpara klasës***.** Mësuesi pyet:

	• Çfarë e bën të suksesshëm një prezantim në grup? • A duhet të flasë vetëm një person? • Si mund të sigurohemi që secili anëtar të ketë një rol të qartë? Nxënësit diskutojnë dhe evidentojnë rëndësinë e bashkëpunimit dhe të ndarjes së përgjegjësive. ***Zhvillimi i veprimtarisë*** *Hapi 1: Formimi i grupeve dhe ndarja e roleve* Nxënësit ndahen në grupe me 4–5 anëtarë. Çdo grup zgjedh rolet: • *Koordinatori* organizon punën dhe menaxhon kohën; • *Kërkuesi* mbledh informacion dhe burime; • *Hartuesi* përgatit materialin e prezantimit; • *Folësi kryesor* prezanton hyrjen dhe përfundimet; • *Moderatori i pyetjeve* përgjigjet ose koordinon përgjigjet gjatë diskutimit. Çdo grup plotëson një tabelë ku përcakton detyrat e çdo anëtari. *Hapi 2: Hartimi i projektit* Grupet punojnë për një temë të caktuar, p.sh.: • Inteligjenca artificiale dhe shkolla • Rrjetet sociale dhe komunikimi; • Dezinformimi në internet

	• Leximi në epokën digjitale • Mjedisi dhe aktivizimi i të rinjve Nxënësit përzgjedhin informacionin, organizojnë idetë dhe vendosin strukturën e prezantimit. *Hapi 3: Prova e prezantimit* Para prezantimit përfundimtar, grupet zhvillojnë një provë. Mësuesi u kërkon të kontrollojnë: • A ka çdo anëtar një rol të qartë? • A janë të shpërndara në mënyrë të barabartë pjesët e prezantimit? • A ka kalime logjike nga një folës te tjetri? • A respektohet koha e caktuar? *Hapi 4: Konferenca e nxënësve* Secili grup prezanton projektin para klasës. Gjatë prezantimit duhet të jenë të dukshme: • ndarja e roleve; • bashkëpunimi mes anëtarëve; • kontributi i secilit; • përdorimi i gjuhës së përshtatshme dhe i mjeteve mbështetëse. Nxënësit e tjerë mbajnë shënime për pyetje ose komente. *Hapi 5: Sesioni i pyetjeve*

	Pas çdo prezantimi, klasa zhvillon një sesion pyetje-përgjigje. Pyetjet nuk drejtohen vetëm te një nxënës, por te grupi. Anëtarët duhet të tregojnë se njohin të gjithë projektin, edhe pse kanë pasur role të ndryshme. *Hapi 6: Reflektimi i grupit* Pas prezantimit, çdo grup diskuton: • Çfarë funksionoi mirë në bashkëpunim? • A u respektuan rolet e përcaktuara? • Si mund të përmirësohet puna në grup në një projekt tjetër? Çdo grup përgatit një reflektim të shkurtër mbi procesin e bashkëpunimit. ***Reflektimi*** Mësuesi pyet: • Pse është e rëndësishme ndarja e roleve në një prezantim? • A ndihmoi kjo ndarje në cilësinë e prezantimit? • Çfarë aftësish zhvillohen gjatë punës në grup? • Si ndikon përgjegjësia individuale në suksesin e grupit? Nxënësit arrijnë në përfundimin se një prezantim i suksesshëm kërkon bashkëpunim, organizim, përgjegjësi individuale dhe komunikim efektiv mes anëtarëve të grupit. ***Produkti*** *Një prezantim në grup i një projekti të përbashkët*, ku evidentohet:

	• ndarja e qartë e roleve dhe detyrave; • kontributi i çdo anëtari; • bashkëpunimi gjatë prezantimit; • aftësia për të komunikuar dhe për të përfaqësuar punën e grupit.

Tabela 2. Shembuj veprimtarish praktike për përmbushjen e rezultateve të të nxënit të kompetencës "Të lexuarit e teksteve të ndryshme"

REZULTATET E TË NXËNIT	*VEPRIMTARITË PRAKTIKE*
Nxënësi shpjegon kuptimin e fjalëve e shprehjeve në kontekst, përfshirë edhe kuptimet e figurshme.	**Veprimtaria "Fjala nën lupë"** ***Prezantimi i veprimtarisë*** Mësuesi paraqet një paragraf nga një tekst joletrar me temë teknologjinë: "*Sot interneti është bërë pjesë e pandashme e jetës së të rinjve. Përmes tij ata komunikojnë, mësojnë dhe shkëmbejnë informacione me bashkëmoshatarë nga vende të ndryshme. Shpesh thuhet se interneti ka hapur dritare të reja për brezin e ri, sepse u ka krijuar mundësi që më parë ishin të vështira për t'u arritur.".* Mësuesi pyet: • A ka vërtet interneti dritare? • Çfarë kuptimi ka shprehja **"***ka hapur dritare të reja"*? • Cilat pjesë të tekstit ju ndihmuan ta kuptoni këtë shprehje? Nxënësit diskutojnë dhe arrijnë në përfundimin se në tekstet joletrare përdoren jo vetëm fjalë me kuptim të drejtpërdrejtë, por edhe shprehje me kuptim figurshëm që e bëjnë komunikimin më të gjallë dhe më shprehës. ***Zhvillimi i veprimtarisë*** *Hapi 1: Gjej kuptimin nga konteksti* Nxënësit lexojnë tekstin: *Teknologjia ka ndryshuar mënyrën se si informohemi dhe komunikojmë. Sot informacioni qarkullon me shpejtësi marramendëse dhe kufijtë e komunikimit janë ngushtuar ndjeshëm. Ngjarje që ndodhin në një vend të botës bëhen të njohura pothuajse menjëherë edhe në vende të tjera.*

	Në dyshe, ata nënvizojnë fjalët ose shprehjet që mund të jenë të panjohura ose të përdorura në mënyrë figurshme: • marramendëse; • kufijtë e komunikimit janë ngushtuar. Më pas përpiqen të shpjegojnë kuptimin e tyre duke u mbështetur te konteksti dhe jo te fjalori. *Hapi 2: Detektivët e kuptimit* Çdo grup merr një fletë me një fjali. P.sh.: • Mediat sociale janë bërë një urë lidhëse mes kulturave të ndryshme. • Informacioni përhapet me shpejtësi rrufeje. • Të rinjtë lundrojnë çdo ditë në botën digjitale. Detyra: • të gjejnë shprehjen figurshme; • të shpjegojnë kuptimin e saj; • të tregojnë cilat fjalë i ndihmuan ta kuptonin. *Hapi 3: Fjalori i kontekstit* Mësuesi u jep nxënësve një paragraf të ri. Ata zgjedhin tri fjalë ose shprehje dhe plotësojnë tabelën:

Fjala/Shprehja	Çfarë mendoj se do të thotë?	Cila pjesë e tekstit më ndihmoi?

Nxënësit krahasojnë përgjigjet dhe argumentojnë zgjedhjet e tyre.

Hapi 4: Kuptim i drejtpërdrejtë apo figurshëm?

Mësuesi paraqet shprehje të ndryshme:

- ka hapur dritare të reja;
- rruga kryesore;
- është një urë lidhëse mes kulturave;
- informacioni përhapet me shpejtësi rrufeje;
- biblioteka e shkollës;
- informacion i besueshëm;
- rrjetet sociale janë bërë një shesh takimi virtual;
- interneti ka shembur kufijtë e komunikimit.

Nxënësit punojnë me kartona:

- Kuptim i drejtpërdrejtë
- Kuptim figurshëm

Për çdo zgjedhje duhet të japin edhe arsyetimin përkatës.

	Hapi 5: Riformuloje Nxënësit zgjedhin një shprehje figurshme nga teksti dhe e zëvendësojnë me një shpjegim të drejtpërdrejtë. P.sh.: *Interneti ka hapur dritare të reja: Interneti ka krijuar mundësi të reja për të mësuar, komunikuar dhe bashkëpunuar me të tjerët*. Diskutohet nëse kuptimi mbetet i njëjtë dhe si ndryshon mënyra e shprehjes. ***Reflektimi*** Mësuesi pyet: • Si na ndihmon konteksti të kuptojmë fjalë ose shprehje të panjohura? • Pse autorët përdorin shprehje figurshme edhe në tekstet joletrare? Nxënësit arrijnë në përfundimin se kuptimi i fjalëve dhe shprehjeve zbulohet duke analizuar kontekstin dhe lidhjet që ato krijojnë me pjesët e tjera të tekstit. ***Produkti*** Një fletë pune, ku nxënësi: • identifikon fjalë dhe shprehje nga teksti; • shpjegon kuptimin e tyre në kontekst; • dallon kuptimin e drejtpërdrejtë nga ai figurshëm; • argumenton se cilat pjesë të tekstit e ndihmuan të arrinte në këtë kuptim.
Nxënësi analizon elementet pamore e grafike (fotografi,	**Veprimtaria “Lexo përtej tekstit”** **Prezantimi i veprimtarisë**

tabela, grafikë, harta), dhe shpjegon se si ato plotësojnë, mbështesin ose ndryshojnë kuptimin e tekstit të shkruar.	Mësuesi paraqet një tekst joletrar me temë: *"Përdorimi i rrjeteve sociale nga të rinjtë"* Teksti shoqërohet me një grafik që paraqet kohën mesatare që adoleshentët kalojnë në rrjetet sociale gjatë ditës. Mësuesi nuk u kërkon nxënësve të lexojnë menjëherë tekstin. Fillimisht ata vëzhgojnë vetëm grafikun. Më pas pyet: • Çfarë informacioni merrni vetëm nga grafiku? • Cilat përfundime mund të nxirrni? • A mjafton grafiku për të kuptuar të gjithë temën? Nxënësit kuptojnë se elementet pamore japin informacion të rëndësishëm, por fiton kuptim më të plotë kur lidhet me tekstin. ***Zhvillimi i veprimtarisë*** *Hapi 1: Analiza e elementit pamor* Nxënësit punojnë në grupe. Çdo grup analizon një element të ndryshëm: • Grupi A: fotografi; • Grupi B: grafik; • Grupi C: tabelë; • Grupi D: hartë.

Për çdo element plotësojnë:

Çfarë shoh?	Çfarë informacioni jep?	Çfarë pyetjesh më lind?

Hapi 2: Lidhja me tekstin

Pas leximit të tekstit, grupet plotësojnë një organizues:

Informacioni në tekst	Informacioni në elementin pamor	Si lidhen?

Nxënësit evidentojnë:

- informacionet që përsëriten;
- informacionet që plotësojnë njëra-tjetrën;
- informacionet që theksohen më qartë në grafik, tabelë ose fotografi.

Hapi 3: Çfarë do të humbnim?

Mësuesi sfidon grupet: *"Imagjinoni sikur grafiku/fotografia/tabela hiqet nga teksti."*

Nxënësit diskutojnë:

- Çfarë informacioni do të mungonte?
- A do të ishte teksti po aq bindës?
- A do të ishte më e vështirë të kuptoheshin të dhënat?

Çdo grup prezanton përfundimet e veta.

	Hapi 4: Hetuesit e mesazhit Grupet analizojnë më thellë elementin pamor: • Pse autori ka zgjedhur pikërisht këtë fotografi? • Çfarë tregojnë ngjyrat, përmasat ose renditja e të dhënave? • Cila pjesë e informacionit theksohet më shumë? • A ndikon elementi pamor në mënyrën si e interpretojmë tekstin? Diskutohet se elementet grafike nuk janë thjesht zbukurime, por pjesë e mesazhit. *Hapi 5: Krijo titullin* Çdo grup duhet të shkruajë një fjali që shpjegon marrëdhënien mes tekstit dhe elementit pamor. P.sh.: "*Grafiku mbështet informacionin e tekstit duke treguar me të dhëna konkrete sa kohë kalojnë të rinjtë në rrjetet sociale."* Ose *"Fotografia e bën më të prekshëm mesazhin e tekstit për ndotjen e mjedisit.".* ***Reflektimi*** Mësuesi pyet: • Cili element ju ndihmoi më shumë për ta kuptuar tekstin? • A mund të japë një grafik informacion që nuk shprehet drejtpërdrejt në tekst? • Si ndikojnë fotografitë dhe elementet grafike në interpretimin tonë? Nxënësit arrijnë në përfundimin se kuptimi i një teksti ndërtohet nga bashkëveprimi i tekstit të shkruar me elementet pamore dhe grafike, të cilat mund të plotësojnë, të mbështesin ose të theksojnë mesazhin e autorit.

	Produkti Çdo nxënës harton një *analizë të shkurtër*, ku: • përshkruan elementin pamor ose grafik; • shpjegon informacionin që ai përcjell; • analizon lidhjen e tij me tekstin; • argumenton se si ndikon ai në kuptimin e përgjithshëm të mesazhit.
Nxënësi krahason tekstet rrëfyese dhe tekstet përshkruese duke gjykuar ndryshimet në mënyrën e ndërtimit, në qëllim dhe në mënyrën se si ndikojnë te lexuesi.	**Veprimtaria "Dy tekste, dy mënyra komunikimi"** ***Prezantimi i veprimtarisë*** Mësuesi u shpërndan nxënësve dy tekste të shkurtra me të njëjtën temë. *Teksti A (rrëfyes):* Kur mbërrita në liqen atë mëngjes, mjegulla mbulonte ende sipërfaqen e ujit. U ula pranë bregut dhe dëgjova zogjtë që këndonin. Pak nga pak dielli doli dhe peizazhi ndryshoi krejtësisht... *Teksti B (përshkrues):* Liqeni kishte ujë të qetë e të kthjellët. Mjegulla e hollë qëndronte mbi sipërfaqe, ndërsa rrezet e para të diellit pasqyroheshin në ujë. Pemët përreth krijonin një kurorë të gjelbër dhe ajri ishte i freskët. Mësuesi pyet: • Cili tekst ju tregon çfarë ndodh? • Cili tekst ju ndihmon ta përfytyroni vendin? • Si ndryshon përvoja e leximit?

Zhvillimi i veprimtarisë

Hapi 1: Leximi krahasues

Nxënësit lexojnë të dyja tekstet dhe plotësojnë tabelën:

Elementi	Teksti rrëfyes	Teksti përshkrues
Çfarë paraqet?		
A ka ngjarje?		
A ka personazhe?		
Çfarë bie më shumë në sy?		

Nxënësit diskutojnë në grupe përgjigjet e tyre.

Hapi 2: Analiza e ndërtimit

Çdo grup analizon mënyrën e organizimit të teksteve. Mësuesi pyet:

Për tekstin rrëfyes:

- A ka fillim, zhvillim dhe fund?
- A paraqiten ngjarjet sipas rrjedhës kohore?
- Çfarë veprimesh kryhen?

Për tekstin përshkrues:

- Çfarë detajesh jepen?
- Cilat shqisa aktivizohen?

- Çfarë përfytyrimi krijohet?

Grupet paraqesin përfundimet e tyre.

Hapi 3: Qëllimi i autorit

Mësuesi vizaton në tabelë dy kolona:

Teksti rrëfyes	Teksti përshkrues

Nxënësit shkruajnë në tabelë:

- të tregojë një ngjarje;
- të krijojë përfytyrime;
- të paraqesë zhvillimin e veprimit;
- të nxjerrë në pah detaje;
- të tregojë se çfarë ndodhi;
- të përshkruajë si është diçka;
- të ketë personazhe, kohë dhe mjedis;
- të organizojë informacionin sipas një rendi logjik ose kronologjik;
- të përdorë folje për të shprehur veprime dhe zhvillim ngjarjesh;
- të përdorë mbiemra dhe shprehje përshkruese për të paraqitur tipare dhe veçori;
- të krijojë lëvizje dhe dinamikë;
- të ndalet te vëzhgimi dhe detajet;

	• të përdorë gjuhë që ndihmon lexuesin të kuptojë ngjarjet; • të krijojë imazhe të qarta. Diskutohet se cili qëllim i përket secilit lloj teksti. *Hapi 4: Ndikimi te lexuesi* Çdo grup diskuton: • Si u ndjetë gjatë leximit të tekstit rrëfyes? • Çfarë ju shtyu të ndiqnit ngjarjen? • Si u ndjetë gjatë leximit të tekstit përshkrues? • Cilat imazhe ju krijoi në mendje? Nxënësit kuptojnë se teksti rrëfyes zgjon kureshtje për ngjarjet, ndërsa teksti përshkrues ndihmon lexuesin të përfytyrojë më qartë personat, vendet ose objektet. *Hapi 5: Sfida e transformimit* Mësuesi u jep nxënësve një paragraf rrëfyes. *Detyra*: *Ta shndërrojnë në një paragraf përshkrues*. Më pas një grup tjetër merr një paragraf përshkrues dhe përpiqet ta kthejë në rrëfim. Në fund krahasohen tekstet e krijuara dhe diskutohen ndryshimet. ***Reflektimi*** Mësuesi pyet: • Cili lloj teksti ju duket më i përshtatshëm për të treguar një ngjarje?

	• Cili ndihmon më shumë për të krijuar pamje në mendje? • A mund të bashkëjetojnë rrëfimi dhe përshkrimi në të njëjtin tekst? Nxënësit arrijnë në përfundimin se tekstet rrëfyese dhe përshkruese kanë funksione të ndryshme, por shpesh plotësojnë njëra-tjetrën në komunikim. ***Produkti*** Çdo nxënës harton një *tekst krahasues*, ku shpjegon: • si ndërtohet një tekst rrëfyes dhe një tekst përshkrues; • cili është qëllimi i secilit tekst; • si ndikojnë te lexuesi; • cilat janë ngjashmëritë dhe dallimet kryesore mes tyre.
Nxënësi reflekton mbi idetë e lexuara dhe i lidh ato me përvojat personale, me aktualitetin dhe me situata të ndryshme shoqërore e kulturore.	**Veprimtaria "Nga teksti te bota jonë"** ***Prezantimi i veprimtarisë*** Nxënësit lexojnë një tekst joletrar me temë: "*Vullnetarizmi i të rinjve dhe ndikimi i tij në komunitet"*. Teksti trajton raste të të rinjve që angazhohen në nisma për mbrojtjen e mjedisit, ndihmën ndaj grupeve në nevojë dhe përmirësimin e jetës në komunitet. Pas leximit, mësuesi pyet: • Cila ide ju bëri më shumë përshtypje? • Pse mendoni se autori e ka trajtuar këtë temë?

- A ka lidhje kjo çështje me realitetin tonë?

Mësuesi shpjegon se leximi nuk ka si qëllim vetëm kuptimin e informacionit, por edhe reflektimin mbi idetë dhe lidhjen e tyre me jetën reale.

Zhvillimi i veprimtarisë

Hapi 1: Tri lidhje me tekstin

Nxënësit plotësojnë organizuesin:

Ide nga teksti	Me çfarë lidhet?
	Një përvojë personale
	Një ngjarje aktuale
	Një situatë shoqërore ose kulturore

Mësuesi nxit nxënësit të japin shembuj konkretë.

Hapi 2: Diskutimi "Kjo më kujton..."

Nxënësit punojnë në grupe dhe zgjedhin një ide nga teksti.

Secili duhet të plotësojë një nga fjalitë:

- Kjo ide më kujton...
- Kam parë diçka të ngjashme kur...
- Kjo lidhet me një problem që diskutohet sot në shoqëri...
- Në kulturën ose komunitetin tonë kjo çështje shfaqet kur...

Anëtarët e grupit krahasojnë reflektimet e tyre dhe evidentojnë ngjashmëri e dallime.

	Hapi 3: Teksti dhe aktualiteti Mësuesi u kërkon grupeve të gjejnë një shembull nga aktualiteti që lidhet me temën e tekstit. P.sh.: një nismë mjedisore, një aktivitet vullnetar, një fushatë ndërgjegjësimi, një problem social i diskutuar në media. Çdo grup shpjegon: • cili është lidhja me tekstin; • cilat ide janë të përbashkëta; • pse tema mbetet aktuale. *Hapi 4: Këndvështrime të ndryshme* Nxënësit diskutojnë pyetjen: "*A do të ishte i njëjtë mesazhi i tekstit në një shoqëri ose kulturë tjetër?*" Ata analizojnë: • si mund të ndryshojnë përvojat e njerëzve; • si ndikojnë vlerat kulturore; • cilat ide janë universale dhe cilat varen nga konteksti. *Hapi 5: Reflektimi personal* Çdo nxënës shkruan një paragraf reflektues duke nisur me një nga formulimet: • Pas leximit të këtij teksti kuptova se... • Ideja që më bëri më shumë përshtypje ishte...

	• Ky tekst lidhet me realitetin tonë sepse... • Kjo temë më bëri të reflektoj për... Nxënësit lexojnë disa nga reflektimet e tyre para klasës. ***Reflektimi*** Mësuesi pyet: • Pse është e rëndësishme ta lidhim tekstin me jetën reale? • Si na ndihmon kjo të kuptojmë më mirë idetë e autorit? • A mund të ketë lexues të ndryshëm dhe reflektime të ndryshme për të njëjtin tekst? Pse? Nxënësit arrijnë në përfundimin se kuptimi i një teksti pasurohet kur idetë e tij lidhen me përvojat personale, me ngjarjet aktuale dhe me realitetin shoqëror e kulturor. ***Produkti*** *Një reflektim argumentues,* ku nxënësi: • identifikon një ide kryesore të tekstit; • e lidh atë me një përvojë personale, një ngjarje aktuale ose një situatë shoqërore; • shpjegon pse kjo ide është e rëndësishme në jetën e sotme.
Nxënësi analizon funksionin, strukturën, përmbajtjen dhe gjuhën e një teksti rrëfyes,	**Veprimtaria "Si ndërtohet një rrëfim i vërtetë?"** ***Prezantimi i veprimtarisë***

<table>
<tr>
<td>duke shqyrtuar elemente, si: personazhet, ngjarjet, renditja, mjedisi, këndvështrimi etj.</td>
<td>
Nxënësit lexojnë një tekst rrëfyes joletrar, p.sh. një fragment nga një autobiografi, një reportazh me përvoja personale, një rrëfim udhëtimi ose një dëshmi e një personi për një ngjarje reale.
Pas leximit, mësuesi pyet:

• A kemi të bëjmë me një histori të trilluar apo me një ngjarje reale?
• Çfarë e dallon këtë tekst nga një artikull informues?
• Pse autori ka zgjedhur ta tregojë përvojën në formë rrëfimi?

Mësuesi shpjegon se tekstet rrëfyese joletrare tregojnë ngjarje reale, por përdorin shumë nga elementet e rrëfimit për t'i bërë përvojat më të kuptueshme dhe më tërheqëse për lexuesin.
Zhvillimi i veprimtarisë
Hapi 1: Dosja e hetimit
Nxënësit punojnë në grupe dhe plotësojnë një dosje analize.
<table>
<tr><th>Elementi</th><th>Çfarë gjejmë në tekst?</th></tr>
<tr><td>Personazhet</td><td></td></tr>
<tr><td>Ngjarja kryesore</td><td></td></tr>
<tr><td>Mjedisi</td><td></td></tr>
<tr><td>Koha</td><td></td></tr>
<tr><td>Rrëfimtari</td><td></td></tr>
</table>
Grupet duhet të mbështesin përgjigjet me pjesë konkrete nga teksti.
Hapi 2: Harta e rrëfimit
Mësuesi shpërndan një organizues grafik:
</td>
</tr>
</table>

Nxënësit rindërtojnë rrjedhën e ngjarjeve dhe analizojnë renditjen e tyre.

Diskutojnë:

- A paraqiten ngjarjet sipas rendit kronologjik?
- A ka kthime pas në kohë?
- Si ndikon kjo në kuptimin e tekstit?

Hapi 3: Kush po rrëfen?

Nxënësit analizojnë këndvështrimin. Mësuesi i orienton me pyetje:

- Kush i tregon ngjarjet?
- A përdoret veta e parë?
- Çfarë mësojmë për përjetimet dhe mendimet e rrëfimtarit?
- Si do të ndryshonte teksti nëse do të rrëfehej nga një person tjetër?

Grupet argumentojnë përgjigjet e tyre duke iu referuar tekstit.

	Hapi 4: Gjuha e rrëfimit Nxënësit kërkojnë në tekst: • folje që tregojnë veprime; • përshkrime; • komente ose reflektime personale; • shprehje që tregojnë emocione dhe qëndrime. Më pas diskutojnë: • A synon autori vetëm të tregojë çfarë ka ndodhur? • Apo dëshiron të ndajë edhe përjetimet dhe reflektimet e tij? *Hapi 5: Paneli i kritikëve* Çdo grup përgatit një prezantim të shkurtër me titull: "*Si është ndërtuar ky rrëfim?".* Në prezantim duhet të përfshihen personazhet, ngjarjet, renditja e tyre, mjedisi, këndvështrimi, veçoritë e gjuhës, funksioni i tekstit. Grupet prezantojnë dhe mbrojnë analizën e tyre para klasës. ***Reflektimi*** Mësuesi pyet: • Pse autori ka zgjedhur të tregojë ngjarjen në formë rrëfimi? • Si ndikojnë këndvështrimi dhe renditja e ngjarjeve në kuptimin e tekstit?

	• Çfarë e bën një rrëfim joletrar interesant për lexuesin? • Si ndërthuren faktet reale me përjetimet personale? Nxënësit arrijnë në përfundimin se një tekst rrëfyes joletrar nuk paraqet thjesht ngjarje reale, por i organizon ato në një strukturë rrëfimi për t'i dhënë kuptim përvojës dhe për të krijuar lidhje me lexuesin. ***Produkti*** *Një profil analitik i tekstit rrëfyes joletrar*, ku nxënësi analizon: • funksionin e tekstit; • personazhet dhe rolin e tyre; • ngjarjet dhe renditjen e tyre; • mjedisin dhe kohën; • këndvështrimin e rrëfimit; • veçoritë gjuhësore dhe stilistike; duke argumentuar se si këto elemente kontribuojnë në kuptimin dhe efektin e përgjithshëm të tekstit.
Nxënësi analizon funksionin, strukturën, përmbajtjen dhe gjuhën e një teksti përshkrues, duke vënë në dukje renditjen logjike të përshkrimit, përdorimin e mbiemrave ose të	**Veprimtaria "Si e ndërton autori pamjen?"** ***Prezantimi i veprimtarisë*** Nxënësit lexojnë një tekst përshkrues, p.sh., një fragment që përshkruan qytetin e Beratit ose Alpet Shqiptare ose një mjedis urban bashkëkohor. Pas leximit, mësuesi pyet:

<table>
<tr>
<td>shqisave për të krijuar imazhe të qarta te lexuesi.</td>
<td>

A ndodh ndonjë ngjarje në këtë tekst?
Çfarë ju mbeti më shumë në mendje pas leximit?
A mund ta përfytyroni vendin e përshkruar?
Si arriti autori t'ju krijojë këtë përfytyrim?

Mësuesi shpjegon se qëllimi kryesor i tekstit përshkrues është të krijojë një pamje të qartë në mendjen e lexuesit duke përdorur detaje, mbiemra dhe përshkrime që aktivizojnë shqisat.
Zhvillimi i veprimtarisë
Hapi 1: Anatomia e përshkrimit
Nxënësit punojnë në grupe dhe analizojnë tekstin duke plotësuar tabelën:
<table>
<tr><th>Elementi</th><th>Çfarë gjejmë në tekst?</th></tr>
<tr><td>Çfarë përshkruhet?</td><td></td></tr>
<tr><td>Qëllimi i përshkrimit</td><td></td></tr>
<tr><td>Detajet kryesore</td><td></td></tr>
<tr><td>Mbiemrat e përdorur</td><td></td></tr>
<tr><td>Shqisat që aktivizohen</td><td></td></tr>
</table>
Grupet mbështesin përgjigjet me shembuj nga teksti.
Hapi 2: Harta e vëzhgimit
Nxënësit analizojnë mënyrën si autori e organizon përshkrimin. Mësuesi drejton pyetjet:

Nga ku fillon përshkrimi?

</td>
</tr>
</table>

- A lëviz autori nga pamja e përgjithshme te detajet?
- A lëviz autori nga detajet te pamja e përgjithshme?
- A përshkruhen elementet nga e majta në të djathtë, nga lart-poshtë apo nga afër-larg?
- A ndjek autori një rend logjik?

Çdo grup vizaton një skemë që paraqet rrjedhën e përshkrimit.

Hapi 3: Laboratori i shqisave

Nxënësit rikthehen te teksti dhe kërkojnë shembuj që lidhen me shqisat.

Shqisa	**Shembull nga teksti**
Të parit	
Të dëgjuarit	
Të nuhaturit	
Të prekurit	
Të shijuarit	

Diskutohet:

- Cilat shqisa përdoren më shumë?
- Si ndikojnë ato në krijimin e imazheve?

Hapi 4: Fuqia e mbiemrave

Mësuesi zgjedh një paragraf nga teksti dhe heq mbiemrat. Nxënësit lexojnë dy variantet: *Me mbiemra* dhe *pa mbiemra.*

	Më pas nxënësit diskutojnë: • Cili variant krijon pamje më të qartë? • Çfarë humbet teksti pa mbiemra? • Si ndikojnë mbiemrat në atmosferën e përshkrimit? *Hapi 5: Paneli i kritikëve* Çdo grup përgatit një analizë të shkurtër me titull: *"Si e ndërton autori përshkrimin?"*. Ata duhet të komentojnë: • funksionin e tekstit; • organizimin e përshkrimit; • përdorimin e detajeve; • rolin e mbiemrave; • përdorimin e shqisave; • efektin që krijohet te lexuesi. Grupet prezantojnë përfundimet e tyre para klasës. ***Reflektimi*** Mësuesi pyet: • Pse autori nuk mjaftohet vetëm me emërtimin e objekteve ose të vendeve?

	• Si ndihmojnë detajet dhe mbiemrat në krijimin e imazheve? • Cili element ju ndihmoi më shumë për të përfytyruar atë që përshkruhej? • Si ndikon renditja logjike në qartësinë e përshkrimit? Nxënësit arrijnë në përfundimin se një tekst përshkrues ndërtohet përmes organizimit të kujdesshëm të detajeve, përdorimit të mbiemrave dhe aktivizimit të shqisave, duke krijuar imazhe të qarta dhe të gjalla te lexuesi. ***Produkti*** *Një analizë e strukturuar e tekstit përshkrues*, ku nxënësi evidenton: • funksionin e tekstit; • mënyrën e organizimit të përshkrimit; • përdorimin e mbiemrave; • përdorimin e shqisave; • efektin e krijuar te lexuesi; duke argumentuar me shembuj konkretë nga teksti.

Tabela 3. Shembuj veprimtarish praktike për përmbushjen e rezultateve të të nxënit të kompetencës "Krijimi i teksteve të ndryshme"

REZULTATET E TË NXËNIT	*VEPRIMTARITË PRAKTIKE*
Nxënësi planifikon shkrimin duke hartuar një strukturë paraprake dhe duke zgjedhur formatin më të përshtatshëm.	**Veprimtaria "Para se të shkruaj"** ***Prezantimi i veprimtarisë*** Mësuesi paraqet situatën: *"Bashkia e qytetit ka shpallur një konkurs me temë: 'Si e imagjinoj qytetin tim pas 20 vjetësh'. Para se të filloni të shkruani, duhet të vendosni: Çfarë lloj teksti do të shkruani? Si do ta organizoni?"* Mësuesi pyet: • A do të shkruanit njësoj nëse do të hartonit një artikull, një ese apo një rrëfim? • A mjafton të kesh ide për të shkruar një tekst të mirë? • Çfarë duhet të bëjmë para se të fillojmë shkrimin? Nxënësit diskutojnë dhe arrijnë në përfundimin se shkrimi i mirë fillon me planifikimin. ***Zhvillimi i veprimtarisë*** *Hapi 1: Zgjedhja e formatit* Mësuesi paraqet të njëjtën temë: *"Ndikimi i teknologjisë në jetën e të rinjve"*. Nxënësit punojnë në grupe dhe diskutojnë: *Në cilat formate mund të trajtohet kjo temë?* • ese argumentuese; • artikull me opinione;

	• postim blogu; • intervistë; • reportazh; • rrëfim personal. Çdo grup argumenton cili format do të ishte më i përshtatshëm për një qëllim të caktuar dhe për një audiencë të caktuar. *Hapi 2: Kush është lexuesi?* Mësuesi u jep grupeve situata të ndryshme: • Teksti do të botohet në gazetën e shkollës. • Teksti do të publikohet në një blog për të rinjtë. • Teksti do të paraqitet në një konkurs kombëtar. • Teksti do t'u drejtohet prindërve. Nxënësit diskutojnë: • Si ndryshon formati? • Si ndryshon gjuha? • Cilat informacione duhen përfshirë? *Hapi 3: Ndërtimi i skeletit të tekstit*

Pasi zgjedhin formatin, nxënësit hartojnë planin paraprak. P.sh. për një ese argumentuese:

Hyrja	Zhvillimi	Përfundimi
Paraqitja e temës	Argumenti 1	Përmbledhja e qëndrimit
Qëndrimi personal	Argumenti 2	Mesazhi për lexuesin
	Argumenti 3	

Për një artikull:

Titulli	Hyrja	Informacioni kryesor	Përfundimi

Hapi 4: Redaksia e ideve

Grupet shkëmbejnë planet e tyre. Çdo grup analizon:

- A është zgjedhur formati i duhur?
- A është struktura logjike?
- A mungon ndonjë pjesë?
- A është i qartë qëllimi i tekstit?

Më pas japin sugjerime për përmirësim.

Hapi 5: Prezantimi i planit

Çdo grup prezanton temën, formatin e zgjedhur, audiencën, strukturën paraprake. Klasa diskuton dhe argumenton nëse zgjedhjet janë të përshtatshme.

Reflektimi

	Mësuesi pyet: • Pse planifikimi është i rëndësishëm para shkrimit? • Si ndikon audienca në zgjedhjen e formatit? • A mund të shkruajmë të njëjtën temë në forma të ndryshme? • Si na ndihmon struktura paraprake gjatë procesit të shkrimit? Nxënësit arrijnë në përfundimin se planifikimi ndihmon në organizimin e ideve, në përshtatjen e tekstit me qëllimin dhe lexuesin, si dhe në ndërtimin e një teksti më të qartë dhe më koherent. ***Produkti*** *Një plan shkrimi*, ku nxënësi paraqet: • temën; • qëllimin; • audiencën; • formatin e zgjedhur; • strukturën paraprake të tekstit; si bazë për hartimin e draftit të mëvonshëm.
Nxënësi redakton shkrimin duke përmirësuar saktësinë, organizimin logjik, stilin e	**Veprimtaria "Nga drafti te versioni përfundimtar"** ***Prezantimi i veprimtarisë***

qartë dhe përdorimin e elementeve retorike për të bindur ose për të ndikuar lexuesin.	Mësuesi paraqet dy versione të së njëjtës pjesë të një eseje argumentuese. • *Versioni A:* Leximi i librave është i rëndësishëm. Librat na ndihmojnë. Ne mësojmë gjëra të reja. Leximi është i dobishëm. Duhet të lexojmë më shumë. • *Versioni B:* Leximi i rregullt i librave ndihmon në pasurimin e fjalorit, zhvillimin e mendimit kritik dhe zgjerimin e njohurive. Përmes leximit, të rinjtë njihen me ide, kultura dhe përvoja të ndryshme. Për këtë arsye, leximi konsiderohet një nga mënyrat më të rëndësishme për zhvillimin intelektual dhe personal. Mësuesi pyet: • Cili tekst ju duket më bindës? • Çfarë e bën versionin e dytë më të qartë? • A mjafton korrigjimi i gabimeve drejtshkrimore për ta përmirësuar një tekst? Nxënësit diskutojnë dhe kuptojnë se redaktimi përfshin jo vetëm korrigjimin e gabimeve, por edhe përmirësimin e organizimit, stilit dhe fuqisë bindëse të tekstit. ***Zhvillimi i veprimtarisë*** *Hapi 1: Kontrolli me katër ngjyra* Nxënësit marrin një draft të shkruar më parë (ese, artikull ose tekst argumentues). Mësuesi u jep një listë kontrolli: *Përmbajtja*

<table>
<tr>
<td></td>
<td>

A janë të qarta idetë?
A ka argumente të mjaftueshme?

Organizimi

A lidhen logjikisht paragrafët?
A ka hyrje, zhvillim dhe përfundim?

Stili

A ka përsëritje të panevojshme?
A është gjuha e qartë dhe e përshtatshme?

Bindja

A përdoren shembuj, fakte ose pyetje retorike?
A është qëndrimi i autorit bindës?

Nxënësit analizojnë tekstin e tyre sipas këtyre katër aspekteve.
Hapi 2: Redaktorët profesionistë
Nxënësit shkëmbejnë draftet me një shok klase. Secili plotëson tabelën:
<table>
<tr><th>Çfarë funksionon mirë?</th><th>Çfarë mund të përmirësohet?</th></tr>
<tr><td></td><td></td></tr>
</table>
</td>
</tr>
</table>

	Komentet duhet të jenë konkrete dhe të argumentuara. P.sh.: • Argumenti i dytë ka nevojë për një shembull konkret. • Paragrafi i tretë përsërit të njëjtën ide. • Përfundimi mund të jetë më i fortë. *Hapi 3: Forca e argumentimit* Mësuesi paraqet disa elemente retorike, si p.sh.: pyetja retorike, krahasimi, shembulli konkret, citimi, statistika, thirrja drejtuar lexuesit etj. Nxënësit analizojnë tekstin e tyre dhe identifikojnë ku mund të shtojnë një element që ta bëjë më bindës. P.sh.: Në vend të: "*Leximi është i rëndësishëm*.", mund të shkruajnë: "*Si mund të zhvillohet mendimi kritik pa lexim të rregullt*?" ose "*Sipas studimeve, nxënësit që lexojnë rregullisht kanë fjalor më të pasur dhe aftësi më të mira shprehëse*." *Hapi 4: Rindërtimi i tekstit* Nxënësit rishkruajnë draftin: • duke shtuar argumente ose shembuj; • duke hequr përsëritjet; • duke riorganizuar paragrafët; • duke përmirësuar lidhjen mes ideve; • duke forcuar hyrjen ose përfundimin. Mësuesi i udhëzon të justifikojnë çdo ndryshim që bëjnë.

	Hapi 5: Para dhe pas Nxënësit vendosin përballë njëri-tjetrit: • një pjesë nga drafti fillestar; • versionin e redaktuar. Ata shpjegojnë: çfarë ndryshuan, pse e ndryshuan dhe si është përmirësuar teksti. ***Reflektimi*** Mësuesi pyet: • Cili ishte ndryshimi më i rëndësishëm që bëtë? • Si ndihmoi redaktimi në qartësinë e tekstit? • Cilat elemente e bënë tekstin më bindës? • Pse redaktimi është një pjesë thelbësore e procesit të shkrimit? Nxënësit arrijnë në përfundimin se një tekst cilësor ndërtohet përmes rishikimit dhe redaktimit të vazhdueshëm, duke përmirësuar jo vetëm korrektësinë gjuhësore, por edhe organizimin dhe fuqinë bindëse të mesazhit. ***Produkti*** *Versioni i redaktuar i një teksti argumentues*, i shoqëruar me një reflektim të shkurtër ku nxënësi shpjegon: • çfarë ndryshimesh ka bërë; • cilat elemente ka përmirësuar;

<table>
<tr><td></td><td>

- si e kanë bërë këto ndryshime tekstin më të qartë, më të organizuar dhe më bindës për lexuesin.

</td></tr>
<tr><td>Nxënësi krijon tekste të organizuara në paragrafë, duke ndërtuar përmbajtje të qarta dhe të kuptueshme përmes përshkrimeve të hollësishme.</td><td>

Veprimtaria “Pikturo me fjalë”

Prezantimi i veprimtarisë

Mësuesi shfaq një fotografi të pasur me detaje (p.sh. një treg tradicional, një rrugë e vjetër qyteti, një peizazh malor ose një shesh i mbushur me njerëz). Nxënësit e vëzhgojnë për një minutë pa folur. Më pas mësuesi pyet:

- Çfarë vutë re fillimisht?
- Cilat detaje ju tërhoqën vëmendjen?
- A do ta përshkruanit të gjithë pamjen në një paragraf të vetëm?

Mësuesi shpjegon se një tekst përshkrues i organizuar mirë ndërtohet duke grupuar informacionin në paragrafë, ku secili paragraf zhvillon një aspekt të veçantë të përshkrimit.

Zhvillimi i veprimtarisë

Hapi 1: Organizimi i vëzhgimit

Nxënësit punojnë në grupe dhe plotësojnë tabelën:

<table>
<tr><th>Çfarë shoh?</th><th>Çfarë detajesh dalloj?</th></tr>
<tr><td>Mjedisi i përgjithshëm</td><td></td></tr>
<tr><td>Njerëzit ose objektet</td><td></td></tr>
<tr><td>Ngjyrat dhe atmosfera</td><td></td></tr>
<tr><td>Tingujt, aromat ose ndjesitë që imagjinoj</td><td></td></tr>
</table>

</td></tr>
</table>

	Diskutohet se cilat detaje janë më domethënëse dhe si mund të organizohen. *Hapi 2: Ndërtimi i strukturës* Mësuesi propozon një model organizimi: *Paragrafi 1:* Pamja e përgjithshme e vendit. *Paragrafi 2:* Përshkrimi i elementeve kryesore (njerëz, objekte, ndërtesa etj.). *Paragrafi 3:* Atmosfera, ngjyrat, tingujt dhe përshtypjet personale. Nxënësit hartojnë një plan me idetë që do të përfshijnë në secilin paragraf. ***Hapi 3: Pasuro përshkrimin*** Para shkrimit, nxënësit krijojnë një "bankë fjalësh". P.sh.: • *Mbiemra*: i gjallë, i zhurmshëm, i qetë, i ndritshëm, i dendur. • *Folje***:** shtrihej, lëviznin, gumëzhinte, pasqyrohej. • *Etj.* Diskutohet se si zgjedhja e fjalëve ndikon në cilësinë e përshkrimit. *Hapi 4: Shkrimi i tekstit* Nxënësit shkruajnë tekstin e tyre duke respektuar planin dhe duke organizuar idetë në paragrafë. Mësuesi i kujton të: përdorin detaje konkrete; shmangin përsëritjet; lidhin paragrafët logjikisht; krijojnë një përfytyrim të qartë te lexuesi. *Hapi 5: Galeria e teksteve* Nxënësit shkëmbejnë tekstet me njëri-tjetrin. Lexuesit plotësojnë në fletë:

	• Cili paragraf krijon imazhin më të qartë? • Cilat detaje ishin më të goditura? • Çfarë mund të shtohet për ta bërë përshkrimin më të pasur? Në fund autorët përmirësojnë tekstin e tyre. ***Reflektimi*** Mësuesi pyet: • Si ju ndihmoi organizimi në paragrafë? • Cilat detaje e bënë përshkrimin më të gjallë? • Pse nuk mjafton vetëm të emërtojmë objektet ose vendet? • Si ndikojnë fjalët përshkruese në imagjinatën e lexuesit? Nxënësit arrijnë në përfundimin se një tekst i qartë dhe i kuptueshëm ndërtohet përmes organizimit logjik të ideve dhe përdorimit të detajeve të zgjedhura me kujdes. ***Produkti*** *Një tekst përshkrues me 3–4 paragrafë*, ku nxënësi: organizon idetë në mënyrë logjike; përdor detaje dhe përshkrime të hollësishme; krijon imazhe të qarta për lexuesin; ndërton një tekst koherent dhe të kuptueshëm.
Nxënësi përshkruan personazhe, vende, ndjesi apo	**Veprimtaria "Fjalët që krijojnë imazhe"** ***Prezantimi i veprimtarisë***

ngjarje, duke përdorur fjalor të pasur dhe të përshtatshëm.	Mësuesi paraqet një fotografi interesante ose një situatë të shkurtër: *"Një vajzë qëndron e vetme në një stacion autobusi në një mbrëmje me shi."*. Më pas pyet: • Si do ta përshkruanit këtë skenë me disa fjali? • Si do ta bënit përshkrimin më të gjallë dhe më interesant? • Cilat fjalë ndihmojnë lexuesin të krijojë një pamje të qartë? Nxënësit japin shembuj të ndryshëm. Mësuesi thekson se cilësia e një përshkrimi varet jo vetëm nga ajo që përshkruhet, por edhe nga zgjedhja e fjalëve. ***Zhvillimi i veprimtarisë*** *Hapi 1: Pasurimi i fjalorit* Mësuesi shkruan në tabelë fjalë të përgjithshme, si p.sh.: *i bukur, i madh, i mërzitur, ecën, shtëpi*. Në grupe, nxënësit gjejnë alternativa më të pasura. P.sh.: • *i mërzitur*: i trishtuar, i pikëlluar, i dëshpëruar. • *ecën:* shëtit, endet, nxiton, zvarritet, vrapon. Diskutohet se si ndryshon imazhi që krijohet te lexuesi. *Hapi 2: Stacionet e përshkrimit* Klasa ndahet në katër grupe. Çdo grup merr një detyrë të ndryshme: • *Grupi 1:* Përshkruani personazhin. • *Grupi 2:* Përshkruani vendin.

	• *Grupi 3:* Përshkruani ndjesitë e personazhit. • *Grupi 4:* Përshkruani ngjarjen që po ndodh. Nxënësit shkruajnë një paragraf të shkurtër duke përdorur sa më shumë detaje dhe fjalor të pasur. *Hapi 3: Ndrysho këndvështrimin* Mësuesi sfidon grupet: *Si do ta përshkruante skenën një gazetar?; Si do ta përshkruante një poet? Si do ta përshkruante vetë personazhi?* Nxënësit rishkruajnë përshkrimin sipas këndvështrimit të ri dhe krahasojnë rezultatet. *Hapi 4: Galeria e përshkrimeve* Çdo grup afishon tekstin e vet në mur ose në ekran. Nxënësit lëvizin nga një tekst te tjetri dhe plotësojnë në fletë disa komente: *Cilat fjalë krijojnë imazh më të qartë? Cili detaj ishte më mbresëlënës? Çfarë mund të pasurohet më tej?* *Hapi 5: Shkrimi individual* Nxënësit zgjedhin një nga temat: • Një njeri që admiroj; • Një vend që më ka lënë mbresa; • Një ngjarje që nuk do ta harroj; • Një moment kur ndjeva emocion të fortë. Ata shkruajnë një tekst me 3-4 paragrafë, duke përdorur fjalorin e pasuruar gjatë veprimtarisë. ***Reflektimi***

	Mësuesi pyet: • Cilat fjalë e bënë përshkrimin më të gjallë? • Si ndikojnë detajet në imagjinatën e lexuesit? • Pse duhet të shmangim fjalët shumë të përgjithshme? • Si na ndihmon fjalori i pasur për të shprehur më saktë mendimet dhe emocionet? Nxënësit arrijnë në përfundimin se përshkrimet ndërtohen përmes zgjedhjes së kujdesshme të fjalëve, detajeve domethënëse dhe organizimit të qartë të ideve. ***Produkti*** *Një tekst përshkrues me 3-4 paragrafë*, ku nxënësi: përshkruan një personazh, vend, ndjesi ose ngjarje; përdor fjalor të pasur dhe të përshtatshëm; krijon imazhe të qarta dhe të gjalla për lexuesin; organizon përmbajtjen në mënyrë koherente.
Nxënësi shfaq stil vetjak dhe përpiqet të krijojë një zë të dallueshëm në të shkruar, duke përdorur me vetëdije mjete gjuhësore që gjallërojnë tekstin.	**Veprimtaria "Zëri im në shkrim"** ***Prezantimi i veprimtarisë*** Mësuesi paraqet tri përshkrime të ndryshme të të njëjtit fenomen: • *Versioni 1:* Ishte një ditë me shi. • *Versioni 2:* Shiu binte pa pushim dhe rrugët ishin të lagura. • *Versioni 3:* Qielli dukej sikur kishte vendosur të rrëfente gjithë trishtimin e tij; pikat e shiut godisnin trotuarin me këmbëngulje, ndërsa qyteti humbiste ngadalë ngjyrat e zakonshme.

	Mësuesi pyet: *Cili version ju tërhoqi më shumë? Pse? Çfarë e bën një tekst të tingëllojë "ndryshe" nga një tjetër?* Nxënësit diskutojnë dhe kuptojnë se përveç përmbajtjes, rëndësi ka edhe mënyra personale e të shprehurit. ***Zhvillimi i veprimtarisë*** *Hapi 1: Gjej zërin e autorit* Nxënësit lexojnë tri fragmente të shkurtra nga autorë ose publicistë të ndryshëm. Në grupe analizojnë: • Çfarë e dallon mënyrën e të shkruarit? • A përdor autori humor, ironi, emocione apo reflektime? • Cilat fjalë ose struktura e bëjnë tekstin të dallueshëm? Diskutohet ideja se çdo autor ndërton gradualisht stilin e vet. *Hapi 2: Nga i zakonshmi te origjinali* Mësuesi paraqet fjali të zakonshme: • Më pëlqen të lexoj. • Qyteti ishte i zhurmshëm. • U ndjeva i lumtur. Nxënësit i rishkruajnë duke përdorur: figura stilistike; detaje konkrete; ritëm të ndryshëm të fjalive; fjalor më shprehës. P.sh.: "*Librat janë udhëtimet e mia më të gjata*." *Hapi 3: Shkrimi me identitet*

	Mësuesi propozon temën: *"Një vend që flet për mua"* ose *"Një moment që më ndryshoi"*. Nxënësit shkruajnë një tekst të shkurtër reflektues. Kushti është që të përdorin me vetëdije: të paktën tri figura stilistike; detaje personale; një ton që pasqyron personalitetin e tyre; zgjedhje fjalësh që krijojnë atmosferë. *Hapi 4: Lexuesit kritikë* Nxënësit shkëmbejnë tekstet. Çdo lexues plotëson një fletë: • Cila fjali tingëllon më origjinale? • Ku ndihet më qartë zëri personal i autorit? • Cili element e bën tekstin më të gjallë? • Çfarë mund të zhvillohet më tej? *Hapi 5: Rishkrimi i vetëdijshëm* Pas komenteve, nxënësit rikthehen te teksti dhe përmirësojnë: *zgjedhjen e fjalëve; ritmin; figuracionin; tonin.* Më pas lexojnë para klasës një pjesë që mendojnë se përfaqëson më mirë stilin e tyre. ***Reflektimi*** Mësuesi pyet: • Çfarë e bën një tekst të tingëllojë personal? • Si ndikojnë figurat gjuhësore në stil? • A mund të shkruajnë dy njerëz për të njëjtën temë në mënyra krejt të ndryshme? • Cili element i stilit tuaj ju pëlqeu më shumë?

	Nxënësit arrijnë në përfundimin se stili vetjak ndërtohet përmes zgjedhjeve të ndërgjegjshme gjuhësore, përvojave personale dhe mënyrës së veçantë me të cilën autori sheh dhe shpreh botën. *Produkti* *Një tekst me stil personal,* ku nxënësi: ka një zë të dallueshëm; përdor fjalor të pasur dhe të zgjedhur me kujdes; përdor mjete gjuhësore e stilistike për të gjallëruar tekstin; krijon një tekst origjinal dhe shprehës.
Nxënësi përfshin elemente pamore, tinguj ose grafikë për të përforcuar përmbajtjen dhe për ta bërë komunikimin më tërheqës.	**Veprimtaria "Një mesazh, shumë mënyra komunikimi"** ***Prezantimi i veprimtarisë*** Mësuesi paraqet një poster të thjeshtë që përmban vetëm tekst dhe një poster tjetër për të njëjtën temë që përmban fotografi, grafikë dhe elemente vizuale. Më pas pyet: • Cili mesazh ju tërhoqi më shumë vëmendjen? • Cilin e kuptuat më shpejt? • Si ndikojnë fotografitë, grafikët ose tingujt në mënyrën si e marrim informacionin? Nxënësit diskutojnë dhe arrijnë në përfundimin se komunikimi bëhet më efektiv kur teksti mbështetet nga elemente të tjera multimodale. ***Zhvillimi i veprimtarisë*** *Hapi 1: Analiza e shembujve* Mësuesi paraqet disa materiale komunikimi, si p.sh.: *një infografik; një poster ndërgjegjësues; një video e shkurtër; një prezantim me slajde.* Në grupe, nxënësit analizojnë:

Elementi	Çfarë funksioni ka?
Fotografitë	
Grafikët	
Ngjyrat	
Ikonat	
Muzika ose tingujt	

Diskutojnë se si secili element ndihmon në kuptimin e mesazhit.

Hapi 2: Projekto mesazhin

Grupet zgjedhin një temë:

- Përdorimi i përgjegjshëm i rrjeteve sociale;
- Mbrojtja e mjedisit;
- Leximi dhe zhvillimi personal;
- Inteligjenca artificiale në jetën e përditshme.

Detyra është të vendosin: cili është mesazhi kryesor; kujt i drejtohet; cilat elemente pamore ose tinguj do ta përforconin atë.

Hapi 3: Plani multimodal

Nxënësit plotësojnë tabelën:

Përmbajtja	Elementi mbështetës	Pse e zgjedhim?
Fakt ose argument	Grafik	
Mesazh emocional	Fotografi	
Informacion kryesor	Ikonë ose simbol	
Prezantim gojor	Muzikë ose efekt zanor	

Diskutohet se elementi duhet të mbështesë mesazhin dhe jo thjesht ta zbukurojë atë.

Hapi 4: Krijimi i produktit

Çdo grup përgatit një nga produktet e mëposhtme: poster digjital; infografik; prezantim me slajde; video e shkurtër ndërgjegjësuese; postim për rrjetet sociale.

Në produkt duhet të kombinohen teksti me elemente pamore ose zanore.

Hapi 5: Galeria e komunikimit

Produktet prezantohen para klasës. Nxënësit e tjerë vlerësojnë:

- A ishte i qartë mesazhi?
- A e ndihmuan elementet pamore kuptimin?
- A ishin grafikët ose figurat të përshtatshme?
- Cili element ndikoi më shumë te audienca?

Reflektimi

Mësuesi pyet:

	• Kur bëhet një grafik më i dobishëm se një paragraf? • Si ndikojnë fotografitë në emocionet e lexuesit? • Pse duhet të zgjedhim me kujdes elementet pamore? • A mund të jetë një prezantim i pasur vizualisht, por jo efektiv? Pse? Nxënësit arrijnë në përfundimin se komunikimi bashkëkohor kërkon kombinimin e tekstit me elemente pamore dhe zanore për ta bërë mesazhin më të kuptueshëm, më bindës dhe më tërheqës. ***Produkti*** *Një produkt multimodal, ,* ku nxënësi: paraqet një mesazh të qartë; përdor në mënyrë të qëllimshme fotografi, grafikë, ikona ose tinguj; shpjegon funksionin e çdo elementi të përzgjedhur; demonstron se si elementet pamore dhe zanore përforcojnë përmbajtjen e shkruar.

Tabela 4. Shembuj veprimtarish praktike për përmbushjen e rezultateve të të nxënit të kompetencës "Përdorimi i drejtë i gjuhës"

REZULTATET E TË NXËNIT	*VEPRIMTARITË PRAKTIKE*
Nxënësi argumenton kur një fjalë ka funksionin e përcaktorit kallëzuesor.	**Veprimtaria "A është përcaktor kallëzuesor?"** ***Prezantimi i veprimtarisë*** Mësuesi shkruan në tabelë dy fjali: • Shkrimtari i njohur prezantoi veprën e tij më të re. • Shkrimtari u bë i njohur pas botimit të romanit. Më pas pyet: • Në cilën fjali fjala *i njohur* lidhet me kryefjalën? • Në cilën fjali lidhet me kallëzuesin dhe me kryefjalën? • A ka të njëjtin funksion në të dyja fjalitë? Nxënësit diskutojnë përgjigjet. Mësuesi shpjegon se në fjalinë e parë *i njohur* është përcaktor i emrit *shkrimtar*, ndërsa në fjalinë e dytë tregon një cilësi të kryefjalës nëpërmjet kallëzuesit *u bë*, prandaj ka funksionin e **përcaktorit kallëzuesor**. ***Zhvillimi i veprimtarisë*** *Hapi 1: Hetuesit e funksionit sintaksor* Nxënësit punojnë në dyshe dhe analizojnë fjalitë:

- Nxënësi mbeti i përqendruar gjatë gjithë diskutimit, pavarësisht kundërshtimeve të shumta.
- Qyteti dukej i braktisur pas stuhisë që kishte përfshirë zonën.
- Sportistët u kthyen të rraskapitur pas garës në kushte të vështira atmosferike.
- Ajo është e vendosur të ndjekë studimet universitare jashtë vendit.
- Studiuesi i përkushtuar publikoi rezultatet e kërkimit pas disa vitesh pune.

Për secilën fjali plotësojnë tabelën:

Fjala	Lidhet me kryefjalën?	Lidhet me kallëzuesin?	Është përcaktor kallëzuesor?

Hapi 2: Jep provën

Çdo grup zgjedh dy fjali dhe argumenton përgjigjen e vet. P.sh.: *"i braktisur" është përcaktor kallëzuesor sepse lidhet me kryefjalën "qyteti" nëpërmjet kallëzuesit "dukej" dhe tregon gjendjen e tij.*

Mësuesi këmbëngul që nxënësit të mos japin vetëm përgjigjen, por edhe arsyetimin gramatikor.

Hapi 3: Kartonët e gjykimit

Mësuesi lexon fjali të ndryshme. Nxënësit ngrenë një karton:

- Përcaktor kallëzuesor
- Jo përcaktor kallëzuesor

Shembuj:

- Dyert mbetën të mbyllura gjatë gjithë kohës së zhvillimit të mbledhjes.

	• Pjesëmarrësit dukeshin të kënaqur me rezultatet e projektit. • Atmosfera u bë e tensionuar pas shpalljes së rezultateve. • Studiuesi i ri paraqiti gjetjet e tij në konferencën shkencore. • Dritaret mbetën të hapura pavarësisht temperaturave të ulëta. Pas çdo përgjigjeje, një nxënës duhet ***të argumentojë zgjedhjen.*** *Hapi 4: Ndërto dhe shpjego* Nxënësit krijojnë vetë tri fjali: • një me përcaktor kallëzuesor; • një me përcaktor; • një ku përdoret e njëjta fjalë në të dy funksionet. P.sh.: *Nxënësi i kujdesshëm lexoi tekstin. Nxënësi dukej i kujdesshëm gjatë gjithë diskutimit.* Më pas shpjegojnë ndryshimin e funksionit. ***Reflektimi*** Mësuesi pyet: • Me cilat folje shfaqet më shpesh përcaktori kallëzuesor? • Si e dallojmë përcaktorin kallëzuesor nga përcaktori? • Pse duhet të analizojmë lidhjen e fjalës me kallëzuesin?

	Nxënësit arrijnë në përfundimin se një fjalë ka funksionin *e përcaktorit kallëzuesor* kur lidhet me kryefjalën ose kundrinorin nëpërmjet kallëzuesit dhe shpreh një cilësi, gjendje ose tipar të tyre. ***Produkti*** *Një fletë analize gramatikore*, ku nxënësi: identifikon përcaktorët kallëzuesorë; argumenton funksionin e tyre në fjali; i dallon nga përcaktorët e emrit; ndërton fjali të reja me përcaktor kallëzuesor.
Nxënësi shpjegon çfarë janë gjymtyrët e veçuara dhe cilat gjymtyrë mund të veçohen në fjali.	**Veprimtaria "Gjymtyra që del në pah"** ***Prezantimi i veprimtarisë*** Mësuesi shkruan në tabelë dy fjali: • *Nxënësit të lodhur nga gara u kthyen në shkollë.* • *Nxënësit, të lodhur nga gara, u kthyen në shkollë.* Më pas pyet: • Çfarë ndryshimi vini re? • Pse në fjalinë e dytë janë përdorur presjet? • Cila pjesë e fjalisë del më shumë në pah? Nxënësit diskutojnë dhe vërejnë se grupi *"të lodhur nga gara"* është veçuar nga pjesa tjetër e fjalisë. Mësuesi shpjegon se gjymtyrët e veçuara janë gjymtyrë që ndahen me intonacion dhe me shenja pikësimi për t'u theksuar ose për të dhënë një informacion shtesë. ***Zhvillimi i veprimtarisë***

Hapi 1: Zbulo gjymtyrën e veçuar

Nxënësit analizojnë fjalitë:

- Mësuesja, e kënaqur me rezultatet, përgëzoi klasën.
- Biblioteka, e rindërtuar së fundmi, u hap për vizitorët.
- Nxënësit, pas përfundimit të aktivitetit, diskutuan përvojat e tyre.

Në dyshe identifikojnë:

- cila gjymtyrë është veçuar;
- me çfarë shenjash pikësimi është ndarë;
- çfarë informacioni shtesë jep.

Hapi 2: Klasifiko gjymtyrët

Mësuesi paraqet disa fjali të tjera dhe u kërkon nxënësve të përcaktojnë se çfarë lloj gjymtyre është veçuar.

Fjalia	**Gjymtyra e veçuar**
Sportisti, i lodhur nga stërvitja, u ul në stol.	Përcaktori
Fëmijët, pas lojës, u kthyen në shtëpi.	Rrethanori
Qyteti, kryeqendra e vendit, ka histori të pasur.	Ndajshtimi
…	…

Nxënësit plotësojnë tabelën dhe nxjerrin përfundime.

	Hapi 3: Harta e konceptit Në tabelë ndërtohet skema:  Nxënësit japin shembuj për secilin rast. *Hapi 4: Riformulo fjalinë* Çdo grup merr disa fjali pa gjymtyra të veçuara.P.sh.: *Nxënësit të emocionuar pritën rezultatet. Tirana kryeqyteti i Shqipërisë ka mbi një milion banorë.* *Detyra*: T'i rishkruajnë duke veçuar gjymtyrët përkatëse. Më pas diskutojnë efektin që krijon veçimi. *Hapi 5: Gazetari i gjuhës* Nxënësit lexojnë një fragment nga një tekst publicistik ose letrar dhe kërkojnë raste të gjymtyrëve të veçuara. Për secilin rast argumentojnë: • Çfarë gjymtyre është?

	• Pse është veçuar? • Çfarë informacioni shtesë ose theksi sjell? ***Reflektimi*** Mësuesi pyet: • Çfarë janë gjymtyrët e veçuara? • Pse përdoren presjet në këto raste? • Cilat gjymtyrë mund të veçohen? • Si ndikon veçimi në kuptimin dhe stilin e fjalisë? Nxënësit arrijnë në përfundimin se gjymtyrët e veçuara përdoren për të theksuar ose për të shtuar informacion dhe se më shpesh veçohen *përcaktori, rrethanori dhe ndajshtimi*. ***Produkti*** *Një tabelë përmbledhëse*, ku nxënësi; përkufizon gjymtyrët e veçuara; identifikon llojet e tyre; jep shembuj për secilin rast; shpjegon rolin që luajnë në kuptimin e fjalisë.
Nxënësi shpjegon si ndërtohet bibliografia në fund të një pune (autor-i/ët, titulli i veprës, shtëpia botuese, vendi, viti).	**Veprimtaria "Bibliografia: karta e identitetit të burimeve"** ***Prezantimi i veprimtarisë*** Mësuesi paraqet situatën: Një nxënës ka përgatitur një projekt për letërsinë shqipe dhe në fund të punës ka shkruar vetëm: *"Kam përdorur disa libra dhe internetin."*. Më pas mësuesi pyet: • A mjafton ky informacion?

- Si mund ta dijë lexuesi se cilat burime janë përdorur?
- Pse është e rëndësishme të tregojmë se nga e kemi marrë informacionin?

Nxënësit diskutojnë dhe arrijnë në përfundimin se çdo punim ose projekt duhet të përfshijë bibliografinë, e cila tregon burimet e përdorura.

Zhvillimi i veprimtarisë

Hapi 1: Zbulo elementet e bibliografisë

Mësuesi paraqet një libër dhe shkruan në tabelë të dhënat e tij: *Agolli, Dritëro. Arka e djallit. Toena, Tiranë, 2015.*

Nxënësit identifikojnë pjesët përbërëse:

Elementi	Shembulli
Autori	Dritëro Agolli
Titulli i veprës	Arka e djallit
Shtëpia botuese	Toena
Vendi i botimit	Tiranë
Viti i botimit	2015

Mësuesi shpjegon se këto janë të dhënat kryesore që përfshihen në bibliografi.

Hapi 2: Mozaik bibliografik

	Çdo grup merr fletushka të përziera: *Tiranë, Onufri, Ismail Kadare, 2018. Kronikë në gur*. Detyra është t'i vendosin në rendin e duhur për të krijuar një zë bibliografik. P.sh.: *Kadare, Ismail. Kronikë në gur. Onufri, Tiranë, 2018.* *Hapi 3: Korrigjo bibliografinë* Mësuesi paraqet shembuj të pasaktë. Nxënësit evidentojnë informacionin që mungon dhe i plotësojnë sipas modelit të saktë. *Hapi 4: Bibliotekarët e klasës* Mësuesi sjell disa libra ose u jep nxënësve fotografi të kopertinave dhe faqeve të para. Në grupe, nxënësit kërkojnë: *autorin; titullin; shtëpinë botuese; vendin e botimit; vitin e botimit*. Më pas hartojnë bibliografinë e çdo libri. *Hapi 5: Ndërto bibliografinë e një projekti* Nxënësve u jepen 4–5 burime të ndryshme. Detyra është të hartojnë seksionin *"Bibliografia"* të një projekti imagjinar. Mësuesi kujton se burimet zakonisht renditen sipas autorit dhe në mënyrë të njëtrajtshme. ***Reflektimi*** Mësuesi pyet: • Pse është e rëndësishme bibliografia? • Çfarë problemesh krijohen kur nuk tregohen burimet? • Cilat janë elementet kryesore të një zëri bibliografik? • Si ndihmon bibliografia në besueshmërinë e një pune?

	Nxënësit arrijnë në përfundimin se bibliografia është një pjesë e rëndësishme e çdo punimi, sepse dokumenton burimet e përdorura dhe respekton punën intelektuale të autorëve. ***Produkti*** *Një listë bibliografike*, ku nxënësi: identifikon elementet përbërëse të një reference bibliografike; i rendit ato sipas formatit të kërkuar; harton bibliografinë e një projekti ose punimi; shpjegon rëndësinë e përdorimit të saktë të burimeve.
Nxënësi zbaton rregullat drejtshkrimore te dialogu.	**Veprimtaria "Dialogu që merr jetë"** ***Prezantimi i veprimtarisë*** Mësuesi shkruan në tabelë tekstin: *Mësuesja pyeti kush e ka përgatitur projektin.* *Unë tha Ardi.* *Edhe unë tha Ina.* Më pas pyet: • A është shkruar saktë ky dialog? • Çfarë mungon? • Si e kuptojmë kur fillon dhe kur mbaron fjala e secilit personazh? Nxënësit evidentojnë mungesën e vizave të dialogut, shenjave të pikësimit dhe ndarjes së replikave. Mësuesi shpjegon se dialogu ka rregulla të veçanta drejtshkrimore që ndihmojnë lexuesin të kuptojë qartë kush flet dhe si zhvillohet biseda. ***Zhvillimi i veprimtarisë***

	Hapi 1: Zbulo rregullat Mësuesi paraqet dialogun e shkruar saktë: -Kush e ka përgatitur projektin? -pyeti mësuesja. -Unë, -tha Ardi. -Edhe unë, -shtoi Ina. Nxënësit vëzhgojnë dhe evidentojnë: • përdorimin e vizës së dialogut; • përdorimin e pikëpyetjes; • përdorimin e presjes; • ndarjen e çdo replike në rresht më vete. Së bashku hartojnë një listë me rregullat kryesore. *Hapi 2: Redaktorët e dialogut* Çdo grup merr një dialog me gabime drejtshkrimore. Detyra është të korrigjojnë dialogun sipas rregullave. Më pas grupet shpjegojnë çdo ndryshim që kanë bërë. *Hapi 3: Plotëso shenjat e pikësimit* Mësuesi shpërndan dialogë ku mungojnë vizat dhe shenjat e pikësimit. Nxënësit duhet të vendosin: *vizën e dialogut; pikën; presjen; pikëpyetjen; pikëçuditësen.* Në fund krahasojnë zgjidhjet. *Hapi 4: Nga tregimi në dialog* Mësuesi jep një fragment nga një tekst rrëfyes:

	Arta e pyeti shoqen nëse kishte përfunduar detyrën. Shoqja iu përgjigj se e kishte mbaruar një ditë më parë. Më pas Arta e përgëzoi. Nxënësit e shndërrojnë në dialog: *Hapi 5: Shkruaj dhe interpreto* Në dyshe, nxënësit krijojnë një dialog të shkurtër me njërën nga temat e mëposhtme: • organizimi i një aktiviteti; • përgatitja për provim; • zgjedhja e një libri; • përdorimi i rrjeteve sociale. Pasi e shkruajnë, e prezantojnë para klasës. Klasa kontrollon nëse janë zbatuar saktë rregullat drejtshkrimore të dialogut. ***Reflektimi*** Mësuesi pyet: • Pse përdoret viza e dialogut? • Pse çdo replikë shkruhet në rresht më vete? • Cilat janë gabimet më të zakonshme në shkrimin e dialogut? • Si ndikojnë shenjat e pikësimit në kuptimin e bisedës?

	Nxënësit arrijnë në përfundimin se respektimi i rregullave drejtshkrimore e bën dialogun më të qartë, më të kuptueshëm dhe më të lehtë për t'u lexuar. ***Produkti*** *Një dialog i shkruar saktë*, ku nxënësi: përdor vizën e dialogut; vendos shenjat e duhura të pikësimit; ndan replikat sipas rregullave; zbaton normat drejtshkrimore në komunikimin e shkruar.
Nxënësi shpjegon dallimet kryesore midis gjuhës së folur dhe gjuhës së shkruar (p.sh.: spontaniteti, shprehjet joformale, gjestet dhe intonacioni te gjuha e folur; struktura e organizuar dhe korrektësia te gjuha e shkruar).	**Veprimtaria "Kur flasim dhe kur shkruajmë"** ***Prezantimi i veprimtarisë*** Mësuesi paraqet dy versione të të njëjtit mesazh: *Versioni A:* Përshëndetje! Vetëm po ju kujtoj se nesër takohemi te biblioteka në orën 10. Mos harroni të sillni materialet! *Versioni B:* Të nderuar nxënës, ju informoj se takimi do të zhvillohet nesër, në orën 10:00, në mjediset e bibliotekës së shkollës. Ju lutem të paraqiteni me materialet e nevojshme. Mësuesi pyet: • Në cilën situatë mund të përdoret secili mesazh? • Cili duket më afër një bisede? • Cili duket më formal dhe më i organizuar? Nxënësit diskutojnë dhe kuptojnë se mënyra e komunikimit ndryshon sipas faktit nëse flasim apo shkruajmë. ***Zhvillimi i veprimtarisë*** *Hapi 1: Vëzhgo dhe krahaso*

Nxënësit punojnë në grupe. Çdo grup merr:

- një fragment bisede të përditshme;
- një njoftim ose tekst të shkruar formal.

Grupet plotësojnë tabelën:

Elementi	Gjuha e folur	Gjuha e shkruar
Fjalori		
Struktura e fjalive		

Grupet paraqesin gjetjet e tyre.

Hapi 2: Loja e roleve

Dy nxënës zhvillojnë një bisedë spontane për një temë të thjeshtë: *"Organizimi i një ekskursioni."*. Një nxënës i tretë mban shënime. Pas përfundimit të bisedës, klasa diskuton:

- A pati përsëritje?
- A pati ndërprerje të mendimit?
- A u përdorën fjalë joformale?
- Si ndikuan intonacioni dhe gjestet në kuptimin e mesazhit?

Hapi 3: Nga e folura te e shkruara

	Nxënësit marrin thelbin e bisedës së zhvilluar në klasë. *Detyra*: Ta shndërrojnë në një tekst të shkruar formal. Ata duhet: të organizojnë idetë; të shmangin përsëritjet; të korrigjojnë gabimet; të përdorin fjali më të plota dhe më të sakta. Në fund krahasohen dy versionet. *Hapi 4: Hetuesit e komunikimit* Mësuesi paraqet situata të ndryshme: • bisedë mes shokësh; • intervistë televizive; • email zyrtar; • postim në rrjetet sociale; • raport projekti. Nxënësit përcaktojnë: • Cila formë komunikimi përdoret? • Cilat karakteristika të gjuhës vërehen? • Pse janë zgjedhur ato? *Hapi 5: Ndërto hartën e dallimeve*

Klasa ndërton së bashku një organizues grafik.

Gjuha e folur	Gjuha e shkruar
Spontane	E planifikuar
Mbështetet te intonacioni	Mbështetet te shenjat e pikësimit
Shoqërohet me gjeste dhe mimikë	Mbështetet vetëm te teksti
Më e lirshme dhe joformale	Më e organizuar dhe korrekte
Lejon korrigjime të menjëhershme	Kërkon rishikim dhe redaktim
…	…

Reflektimi

Mësuesi pyet:

- Pse gjuha e folur është zakonisht më spontane?
- Si ndikojnë gjestet dhe intonacioni në komunikim?
- Pse gjuha e shkruar kërkon më shumë organizim dhe korrektësi?
- A mund të përdorim të njëjtën mënyrë shprehjeje në të gjitha situatat?

Nxënësit arrijnë në përfundimin se gjuha e folur dhe gjuha e shkruar kanë funksione të përbashkëta komunikimi, por dallojnë në mënyrën e organizimit, në mjetet shprehëse dhe në shkallën e formalitetit.

Produkti

Një tabelë ose ese krahasuese, ku nxënësi: identifikon veçoritë e gjuhës së folur dhe të gjuhës së shkruar; shpjegon dallimet kryesore midis tyre; jep shembuj nga situata reale komunikimi; argumenton pse secila përdoret në kontekste të ndryshme.

Nxënësi shpjegon çfarë janë koherenca (*përshtatja logjike e ideve*) dhe kohezioni (*lidhja gjuhësore mes pjesëve të tekstit*).	**Veprimtaria "A qëndrojnë bashkë idetë?"** ***Prezantimi i veprimtarisë*** Mësuesi paraqet dy paragrafë: *Paragrafi A:* Teknologjia ka ndryshuar ndjeshëm mënyrën se si mësojmë. Përmes platformave digjitale, nxënësit kanë qasje në burime të shumta informacioni dhe mund të bashkëpunojnë me të tjerë edhe jashtë klasës. Për më tepër, mjetet digjitale u japin mundësi të mësojnë sipas ritmit të tyre. Për këtë arsye, procesi i të nxënit është bërë më fleksibël dhe më i larmishëm. *Paragrafi B:* Teknologjia ka ndryshuar ndjeshëm mënyrën se si mësojmë. Shumë nxënës përdorin platforma digjitale gjatë studimit. Procesi i të nxënit është bërë më fleksibël. Disa nxënës preferojnë të lexojnë libra në bibliotekë. Në shkolla përdoren edhe tabela interaktive. Teknologjia është e rëndësishme për arsimin. Më pas mësuesi pyet: • Cili paragraf kuptohet më lehtë? • Në cilin paragraf idetë lidhen më mirë me njëra-tjetrën? • Pse paragrafi i dytë duket më pak i organizuar? • Cilat lidhje logjike mungojnë në paragrafin e dytë? Nxënësit japin mendimet e tyre. Mësuesi shpjegon se një tekst cilësor duhet të ketë *koherencë* (idetë duhet të lidhen logjikisht) dhe *kohezion* (fjalitë duhet të lidhen gjuhësisht me njëra-tjetrën). ***Zhvillimi i veprimtarisë*** *Hapi 1: Zbulo dallimin*

	Mësuesi shkruan në tabelë dy përkufizime të paplota. • Koherenca është... • Kohezioni është... Nxënësit lexojnë shembujt dhe përpiqen të plotësojnë përkufizimet. Pas diskutimit arrihet në përfundimin: • *Koherenca* lidhet me rrjedhën logjike të ideve. • *Kohezioni* lidhet me mjetet gjuhësore që bashkojnë fjalitë dhe paragrafët. *Hapi 2: Hetuesit e koherencës* Çdo grup merr një paragraf me fjali të përziera. P.sh.: 1. Shumë të rinj përdorin rrjetet sociale për të komunikuar. 2. Për këtë arsye, komunikimi është bërë më i shpejtë. 3. Teknologjia ka ndryshuar mënyrën si ndërveprojmë. 4. Përmes tyre mund të shkëmbejmë informacion në kohë reale. 5. ... Nxënësit duhet t'i vendosin fjalitë në rend logjik. Më pas argumentojnë zgjedhjen e tyre. Diskutohet se si koherenca varet nga organizimi i ideve. *Hapi 3: Gjuha që lidh*

	Mësuesi paraqet një paragraf dhe u kërkon nxënësve të nënvizojnë fjalët lidhëse: *prandaj; megjithatë; përveç kësaj; ndërsa; për këtë arsye; gjithashtu.* Më pas evidentohen përemrat, foljet, përsëritjet etj., që lidhin fjalitë. Diskutohet se këto elemente krijojnë kohezion. *Hapi 4: Riparo tekstin* Çdo grup merr një tekst me probleme koherence ose kohezioni. P.sh. *Leximi është i rëndësishëm. Librat janë të shumtë. Për këtë arsye. Shumë nxënës kanë hobi sportin. Ai ndihmon zhvillimin e fjalorit...* Nxënësit duhet: • të heqin informacionin që nuk lidhet me temën; • të riorganizojnë idetë; • të shtojnë lidhëza ose mjete të tjera lidhëse. Më pas lexojnë versionin e përmirësuar. *Hapi 5: Ndërto tekst koherent dhe koheziv* Nxënësit shkruajnë një paragraf të shkurtër me temë: *"Përfitimet e leximit"* Kushti janë: • idetë të zhvillohen logjikisht; • të përdoren të paktën katër mjete kohezioni (lidhëza, përemra, mbiemra etj.). Në fund nxënësit shkëmbejnë paragrafët dhe evidentojnë shembuj të koherencës dhe kohezionit. *Reflektimi* Mësuesi pyet:

	• A mund të jetë një tekst koheziv, por jo koherent? • A mund të ketë ide të mira një tekst, por të mos kuptohet qartë? • Pse janë të rëndësishme koherenca dhe kohezioni në gjuhën e shkruar? Nxënësit arrijnë në përfundimin se: • *Koherenca* siguron lidhjen logjike të ideve dhe kuptimin e përgjithshëm të tekstit. • *Kohezioni* siguron lidhjen gjuhësore ndërmjet fjalive dhe paragrafëve. Të dyja janë të domosdoshme për një tekst të qartë, të organizuar dhe të kuptueshëm. ***Produkti*** ***Një paragraf***, ku nxënësi: • demonstron koherencë në organizimin e ideve; • përdor mjete kohezioni për të lidhur fjalitë; • identifikon dhe shpjegon shembuj të koherencës dhe kohezionit në tekstin e vet.

LËNDA: LETËRSI

VEPRIMTARITË PRAKTIKE NË LËNDËN E LETËRSISË

Veprimtaritë praktike në lëndën e letërsisë mbështeten në qasjen bashkëkohore të të nxënit, e cila e vendos nxënësin në qendër të procesit dhe e nxit atë të ndërveprojë në mënyrë aktive me tekstin letrar. Nëpërmjet leximit, analizës, interpretimit, diskutimit, argumentimit dhe krijimit, nxënësit zhvillojnë jo vetëm njohuritë për letërsinë, por edhe aftësitë për të menduar në mënyrë kritike, për të krijuar, për të shprehur qëndrime të argumentuara dhe për të vlerësuar rolin e letërsisë si një formë e rëndësishme e artit dhe e kulturës njerëzore.

Veprimtaritë praktike ndërtohen mbi vepra dhe tekste përfaqësuese të letërsisë shqipe dhe botërore (pjesë e programit lëndor të letërsisë në klasën e dhjetë), duke u dhënë nxënësve mundësinë të eksplorojnë tema universale, vlera njerëzore, kontekste historike e kulturore, si dhe marrëdhëniet e letërsisë me artet e tjera. Përmes tyre, nxënësit mësojnë të analizojnë personazhet, konfliktet, mjedisin, strukturën e veprës, mesazhet dhe vlerat artistike të teksteve letrare, duke ndërtuar një marrëdhënie aktive dhe reflektuese me leximin.

Këto veprimtari kontribuojnë në zhvillimin e kompetencave lëndore të letërsisë: interpretimin, analizën dhe vlerësimin e teksteve të gjinive dhe llojeve të ndryshme letrare, si dhe vlerësimin e letërsisë shqipe dhe botërore në kontekstin e zhvillimit të saj historik, kulturor dhe estetik. Në të njëjtën kohë, ato ndihmojnë nxënësit të zhvillojnë aftësitë e komunikimit, të bashkëpunimit, të reflektimit dhe të krijimtarisë, duke e parë letërsinë si një mjet për të kuptuar më mirë njeriun, shoqërinë dhe vetveten.

Materiali është hartuar si një mbështetje praktike për mësuesit në planifikimin dhe zhvillimin e veprimtarive që lidhen me disa rezultate të nxëni të programit të letërsisë për klasën e dhjetë. Veprimtaritë e paraqitura kanë karakter orientues dhe mund të përshtaten sipas kontekstit të klasës, nevojave të nxënësve dhe teksteve shkollore që përdoren në klasë, duke ruajtur gjithmonë fokusin te zhvillimi i kompetencave letrare dhe te arritja e rezultateve të të nxënit.

Tabela 1. Shembuj veprimtarish praktike për përmbushjen e rezultateve të të nxënit të kompetencës "Interpretimi, analiza dhe vlerësimi i teksteve të gjinive dhe të llojeve të ndryshme letrare"

REZULTATET E TË NXËNIT	*VEPRIMTARITË PRAKTIKE*
Nxënësi analizon funksionet dhe vlerat e letërsisë si lloj arti.	**Veprimtaria "Pse vazhdojmë të lexojmë letërsi?"** ***Prezantimi i veprimtarisë*** Mësuesi shkruan në tabelë pyetjen: "*Pse njerëzit vazhdojnë të lexojnë vepra letrare të shkruara qindra ose mijëra vjet më parë?"*. Nxënësit mendojnë individualisht për një minutë dhe më pas ndajnë mendimet e tyre me shokun ose shoqen e bankës. Zakonisht nxënësit përmendin arsye të ndryshme, si: kënaqësia e leximit, emocionet që krijojnë veprat, njohja me kultura dhe kohë të tjera, kuptimi më i mirë i natyrës njerëzore, ose mesazhet që përcjellin personazhet dhe ngjarjet. Mësuesi i orienton nxënësit drejt pyetjes kryesore të orës së mësimit: *Çfarë funksionesh kryen letërsia dhe cilat janë vlerat që ajo i sjell individit dhe shoqërisë?* ***Zhvillimi i veprimtarisë*** *Hapi 1: Letërsia dhe përvoja njerëzore* Mësuesi paraqet disa pohime: • Letërsia na jep kënaqësi estetike • Letërsia na emocionon dhe na zhvillon imagjinatën • Letërsia na ndihmon të kuptojmë veten dhe të tjerët. • Letërsia ruan kujtesën kulturore të një populli.

- Etj.

Nxënësit punojnë në grupe. Çdo grup zgjedh një pohim dhe diskuton:

- Çfarë do të thotë konkretisht ky pohim?
- A pajtohen me të?
- Si mund ta argumentojnë?
- Çfarë vlere krijon letërsia përmes këtij funksioni?

Përfundimet paraqiten para klasës dhe diskutohen.

Hapi 2: Nga funksioni te vlera

Mësuesi vizaton në tabelë një skemë me dy kolona: *Funksioni* dhe *Vlera*.

Së bashku me nxënësit plotësohet tabela:

Funksioni i letërsisë	**Vlera që krijon**
Estetik	Kënaqësi artistike, zhvillim i ndjeshmërisë estetike
Njohës	Njohje e njeriut, e jetës dhe e botës
Kulturor dhe kombëtar	Ruajtja e kujtesës dhe identitetit kulturor e kombëtar
Etik	Reflektim mbi vlerat dhe zgjedhjet njerëzore
Shoqëror	Kuptim më i mirë i problemeve dhe marrëdhënieve shoqërore

Më pas nxënësit diskutojnë se cili prej funksioneve u duket më i rëndësishëm dhe pse.

Hapi 3: Diskutimi në grupe

	Çdo grup merr një nga funksionet e letërsisë dhe përgatit një argumentim të shkurtër për pyetjen: *"Pse ky funksion është i rëndësishëm për njeriun?"* Nxënësit duhet të mbështesin mendimet e tyre me shembuj nga përvoja personale si lexues, nga filma, tregime, mite, legjenda ose vepra që njohin. Pas prezantimit të grupeve, klasa diskuton ngjashmëritë dhe dallimet midis funksioneve të ndryshme. *Hapi 4: Funksioni estetik- që e dallon letërsinë* Mësuesi paraqet dy tekste që përcjellin të njëjtën ide: • Teksti 1: Dielli perëndoi pas maleve... • Teksti 2: Dielli i përskuqur u tret ngadalë pas kreshtave, duke lënë mbi qiell një dritë të artë... Nxënësit krahasojnë tekstet dhe diskutojnë: • Cili tekst krijon më shumë përfytyrime? • Cili ngjall më shumë emocione? • Çfarë e bën tekstin e dytë më artistik? Diskutimi përqendrohet te funksioni estetik i letërsisë dhe te mënyra se si gjuha në këtë art krijon bukuri dhe përjetim. *Hapi 5: Përfundimi i debatit*

	Mësuesi shtron pyetjen: *"Nëse letërsia do të na mësonte shumë gjëra, por nuk do të kishte asnjë vlerë artistike, a do të vazhdonte të ishte letërsi?"*. Nxënësit argumentojnë qëndrimet e tyre dhe përpiqen të mbështesin mendimet me argumente. *Reflektimi* Në fund të orës, nxënësit shkruajnë një paragraf të shkurtër me temën: **"***Pse letërsia është një formë arti?"* Në reflektimin e tyre ata duhet të përfshijnë të paktën dy funksione dhe dy vlera të letërsisë, duke shpjeguar lidhjen mes tyre. *Produkti* Një paragraf ku nxënësi analizon funksionet kryesore të letërsisë dhe shpjegon vlerat estetike, njohëse, kulturore, etike dhe shoqërore që ajo krijon për individin dhe shoqërinë.
Nxënësi analizon lidhjet e letërsisë me artet e tjera.	**Veprimtaria "Kur letërsia takon artet e tjera"** ***Prezantimi i veprimtarisë*** Mësuesi paraqet në ekran tri materiale që lidhen me të njëjtën vepër letrare: • kopertinën e një libri; • një pikturë ose një ilustrim të frymëzuar nga vepra; • një fragment nga një film ose nga një shfaqje teatrale që është mbështetur në veprën letrare. Më pas pyet: • A tregojnë të tria të njëjtin subjekt? • Çfarë ndryshon nga një art te tjetri?

	• A mund të shprehet e njëjta ide përmes fjalës, pikturës, muzikës ose interpretimit skenik? Nxënësit japin mendimet e tyre dhe diskutojnë se si një vepër letrare mund të frymëzojë forma të tjera arti. ***Zhvillimi i veprimtarisë*** *Hapi 1: Zbulimi i lidhjeve* Mësuesi paraqet disa shembuj të marrëdhënieve mes letërsisë dhe arteve të tjera: • romani që është përshtatur në film; • drama që vihet në skenë; • poezia e shoqëruar me muzikë; • personazhe letrare ose ngjarje të paraqitura në pikturë ose në skulpturë. Nxënësit punojnë në grupe dhe diskutojnë: • Çfarë merr arti tjetër nga letërsia? • Çfarë elementesh shtohen gjatë përshtatjes? • Çfarë humbet ose ndryshon? *Hapi 2: Analiza krahasuese* Çdo grup merr një fragment të shkurtër letrar dhe një ilustrim ose një skenë filmike që lidhet me të. Nxënësit analizojnë: • Si paraqitet personazhi në tekst?

	• Si paraqitet në figurë ose në ekran? • Cilat detaje janë ruajtur? • Cilat janë interpretuar ndryshe? Grupet prezantojnë gjetjet e tyre para klasës. *Hapi 3: Letërsia dhe muzika* Mësuesi paraqet tekstin e një kënge të njohur me vlera poetike. Nxënësit diskutojnë: • Si ndikon muzika në mënyrën se si e përjetojmë tekstin? • Çfarë shton muzika që nuk gjendet në tekstin e shkruar? • A ndryshon emocioni që përcjell vepra? Diskutimi përqendrohet te marrëdhënia midis fjalës artistike dhe tingullit. *Hapi 4: Galeria e arteve* Grupet zgjedhin një vepër ose personazh letrar të njohur dhe përgatisin një poster digjital ku paraqesin mënyrat se si ai është shfaqur në arte të ndryshme: letërsi, teatër, film, pikturë, muzikë. Nxënësit evidentojnë ngjashmëritë dhe dallimet ndërmjet këtyre formave artistike. *Hapi 5: Diskutimi përfundimtar* Mësuesi shtron pyetjen: "*A mbetet e njëjtë një vepër kur kalon nga letërsia në film, teatër ose muzikë?"* Nxënësit argumentojnë mendimet e tyre duke iu referuar shembujve të analizuar gjatë orës. ***Reflektimi***

	Nxënësit shkruajnë një paragraf të shkurtër ku shpjegojnë: • cilat janë lidhjet kryesore të letërsisë me artet e tjera; • çfarë kanë të përbashkët; • si ndikojnë artet te njëra-tjetra; • pse shumë vepra letrare vazhdojnë të frymëzojnë krijues në fusha të ndryshme artistike. ***Produkti*** Një poster, infografik me temën: **"***Letërsia dhe dialogu i saj me artet e tjera",* ku nxënësi paraqet shembuj konkretë të ndërveprimit të letërsisë me teatrin, filmin, muzikën, pikturën ose artet e tjera dhe analizon mënyrën se si ato pasurojnë njëra-tjetrën.
Nxënësi dallon ngjarjet që shënojnë hyrjen, pikën e lidhjes, zhvillimin, pikën kulmore, zgjidhjen, si dhe shpjegon rëndësinë e tyre.	**Veprimtaria "Harta e konfliktit"** ***Prezantimi i veprimtarisë*** Mësuesi drejton pyetjen: "*A mund të ekzistojë një tregim ose dramë pa konflikt*?". Nxënësit diskutojnë shkurt dhe japin shembuj nga filma, seriale ose vepra që njohin Më pas mësuesi shpjegon se ngjarjet në një vepër letrare nuk paraqiten rastësisht, por ndërtohen sipas një strukture që krijon tension, zhvillim dhe zgjidhje. Në ekran paraqitet skema:



Zhvillimi i veprimtarisë

Hapi 1: Rindërto ngjarjet

Nxënësit punojnë në grupe. Çdo grup merr kartela me ngjarje kryesore nga *Hamleti* të paraqitura në rend të çrregullt.

P.sh.:

- Fantazma i shfaqet Hamletit.
- Hamleti mëson për vrasjen e të atit.
- Organizohet shfaqja teatrale.
- Hamleti vret Polonin.
- Dueli mes Hamletit dhe Laertit.

- Vdekja e Hamletit.

Detyra është t'i vendosin ngjarjet sipas rendit të zhvillimit të veprës.

Hapi 2: Gjej funksionin e ngjarjes

Pasi vendosin rendin, grupet klasifikojnë ngjarjet sipas skemës:

Ngjarja	Pjesa e strukturës
Fantazma i shfaqet Hamletit	Pika e lidhjes
...	...

Nxënësit argumentojnë pse një ngjarje përbën hyrje, pikë lidhjeje, pikë kulminante apo zgjidhje.

Hapi 3: Piramida narrative

Në grupe nxënësit ndërtojnë piramidën narrative të veprës. Për secilën pjesë të strukturës ata shkruajnë:

- ngjarjen kryesore;
- personazhet e përfshira;
- rëndësinë e saj në zhvillimin e konfliktit.

Hapi 4: Po sikur ta hiqnim?

Çdo grup zgjedh një nga ngjarjet kryesore dhe diskuton: *Çfarë do të ndodhte me veprën nëse kjo ngjarje do të mungonte?* P.sh.:

- Çfarë do të ndodhte nëse fantazma nuk do t'i tregonte Hamletit të vërtetën?
- A do të arrinte konflikti të zhvillohej?

	Kjo i ndihmon nxënësit të kuptojnë funksionin e çdo pjese të strukturës. *Hapi 5: Diskutimi përfundimtar* Nxënësit diskutojnë: • Cila ngjarje e ndryshon më shumë rrjedhën e veprës? • Pse pika kulminante konsiderohet momenti më i rëndësishëm? • Si lidhet fundi i veprës me konfliktin që paraqitet në fillim? ***Reflektimi*** Nxënësit shkruajnë një paragraf ku shpjegojnë: • cilën ngjarje konsiderojnë pikë kulmore të veprës; • pse ajo është vendimtare për zhvillimin e konfliktit; • si ndikon në zgjidhjen përfundimtare. ***Produkti*** *Një piramidë narrative e tragjedisë "Hamleti",* ku nxënësi: • identifikon hyrjen, pikën e lidhjes, zhvillimin, pikën kulminante dhe zgjidhjen; • argumenton rëndësinë e secilës pjesë në ndërtimin e veprës; • shpjegon lidhjet ndërmjet ngjarjeve kryesore dhe konfliktit dramatik.

<table>
<tr>
<td>Nxënësi analizon personazhet duke u bazuar në përshkrimet e autorit dhe mendimet, fjalët, veprimet, bindjet e tyre etj.</td>
<td>

Veprimtaria “Kush është në të vërtetë Don Kishoti?”

Prezantimi i veprimtarisë

Mësuesi paraqet një ilustrim të Don Kishotit dhe Sanço Pançës dhe shtron pyetjen: “A është Don Kishoti një idealist që ndjek ëndrrat e tij apo një njeri që nuk arrin të dallojë realitetin nga imagjinata?”. Nxënësit japin mendimet e para dhe i argumentojnë shkurt.

Zhvillimi i veprimtarisë

Hapi 1: Kërko provat

Nxënësit punojnë në grupe me fragmente nga vepra. Çdo grup plotëson tabelën:

<table>
<tr><th>Çfarë thotë Don Kishoti?</th><th>Çfarë bën?</th><th>Çfarë tregon kjo për karakterin e tij?</th></tr>
<tr><td></td><td></td><td></td></tr>
</table>

Nxënësit evidentojnë mendimet, bindjet dhe veprimet e personazhit dhe nxjerrin përfundime për tiparet e tij.

Hapi 2: Portreti i personazhit

Grupet ndërtojnë një profil të Don Kishotit duke iu përgjigjur pyetjeve:

- Cilat janë idealet e tij?
- Çfarë beson ai për botën?
- Si e shohin personazhet e tjera?
- Si e paraqet autori?
- Cilat janë cilësitë dhe dobësitë e tij?

Çdo përgjigje duhet të mbështetet me shembuj nga teksti.

Hapi 3: Don Kishoti përballë Sanço Pançës

</td>
</tr>
</table>

	Nxënësit krahasojnë dy personazhet. **Don Kishoti** | **Sanço Pança** | | Ata analizojnë mënyrën si mendojnë, vlerat që përfaqësojnë, qëndrimin ndaj realitetit, mënyrën si veprojnë përballë vështirësive. Diskutohet se si kontrasti ndërmjet tyre ndihmon në ndërtimin e karakterit të secilit. *Hapi 4: Karrigia e nxehtë* Një nxënës merr rolin e Don Kishotit. Pjesa tjetër e klasës i drejton pyetje: • Pse vendose të bëheshe kalorës? • Pse luftove me mullinjtë e erës? • A mendon se ke dështuar? • Çfarë është më e rëndësishme: ëndrra apo realiteti? • Etj. Nxënësi duhet të përgjigjet duke u mbështetur në karakterin dhe bindjet e personazhit. *Hapi 5: Gjykimi i personazhit* Grupet diskutojnë dhe mbrojnë një nga këto teza: • Don Kishoti është një personazh komik. • Don Kishoti është një idealist fisnik. • Don Kishoti është një personazh tragjik.

	• Don Kishoti është një kombinim i të triave. Çdo grup argumenton me shembuj nga vepra. ***Reflektimi*** Nxënësit shkruajnë një tekst të shkurtër ku shpjegojnë: *Cilat janë tiparet kryesore të Don Kishotit dhe si zbulohet ai përmes mendimeve, fjalëve, veprimeve dhe bindjeve të tij?* ***Produkti*** *Profil analitik i personazhit të Don Kishotit*, ku nxënësi: • identifikon tiparet kryesore të personazhit; • analizon mendimet, fjalët, veprimet dhe bindjet e tij; • argumenton përfundimet me shembuj nga teksti; • vlerëson rolin e personazhit në kuptimin e veprës.
Nxënësi analizon se si ndryshon ose zhvillohet një personazh.	**Veprimtaria "Udhëtimi i Hamletit"** ***Prezantimi i veprimtarisë*** Mësuesi u drejton nxënësve pyetjen: "*A mbetet i njëjtë një personazh nga fillimi deri në fund të veprës?*". Nxënësit japin mendime dhe shembuj nga filma, seriale ose libra që njohin. Më pas mësuesi e lidh diskutimin me Hamletin dhe shtron pyetjen: "*A është Hamleti në fund të veprës i njëjti person që takojmë në fillim?*" ***Zhvillimi i veprimtarisë*** *Hapi 1: Hamleti në pesë momente*

Klasa ndahet në pesë grupe. Çdo grup analizon një moment kyç të zhvillimit të personazhit:

- Hamleti pas vdekjes së të atit;
- Hamleti pas takimit me fantazmën;
- Hamleti gjatë organizimit të shfaqjes teatrore;
- Hamleti pas vrasjes së Polonit;
- Hamleti në fund të veprës.

Çdo grup plotëson tabelën:

Çfarë mendon?	Çfarë ndien?	Si vepron?	Çfarë zbulon kjo për Hamletin?

Hapi 2: Linja e zhvillimit të personazhit

Grupet vendosin momentet në një vijë kohore të përbashkët. Për secilin moment identifikojnë:

- konfliktin që përjeton;
- ndryshimin në mënyrën e të menduarit;
- ndryshimin në mënyrën e veprimit.

Nxënësit vërejnë se Hamleti kalon nga tronditja dhe pasiguria te vetëdijesimi dhe pranimi i fatit të tij.

Hapi 3: Çfarë e ndryshon Hamletin?

Mësuesi shpërndan fletë me ngjarje të rëndësishme:

	• vdekja e mbretit; • martesa e Gertrudës me Klaudin; • takimi me fantazmën; • tradhtitë që zbulon; • vdekja e Ofelisë; • dueli me Laertin. Çdo grup diskuton: *Cila prej këtyre ngjarjeve ndikon më shumë në zhvillimin e Hamletit?*. Nxënësit duhet të argumentojnë përgjigjen me shembuj nga teksti. *Hapi 4: Ditari i Hamletit* Çdo grup shkruan një hyrje ditari nga këndvështrimi i Hamletit në një nga momentet e analizuara. Detyra është të pasqyrohen: • mendimet; • dilemat; • emocionet; • ndryshimet që po përjeton personazhi. Më pas tekstet lexohen dhe krahasohen. *Hapi 5: Debati*

	Mësuesi paraqet tezën: *Hamleti nuk ndryshon; vetëm rrethanat përreth tij ndryshojnë.* Një grup mbron tezën, ndërsa grupi tjetër argumenton se Hamleti zhvillohet ndjeshëm gjatë veprës. Nxënësit mbështeten në fjalët, veprimet dhe qëndrimet e personazhit. ***Reflektimi*** Nxënësit shkruajnë një paragraf ku shpjegojnë: • si është Hamleti në fillim të veprës; • si është Hamleti në fund të saj; • cilat ngjarje ndikojnë më shumë në zhvillimin e tij. ***Produkti*** *Një profil i zhvillimit të personazhit*, ku nxënësi: • identifikon etapat kryesore të ndryshimit të personazhit; • analizon faktorët që ndikojnë në këtë zhvillim; • argumenton me shembuj nga teksti; • shpjegon rëndësinë e këtij zhvillimi për kuptimin e veprës.
Nxënësi analizon marrëdhëniet mes personazheve, si p.sh., ndikimi që ka një personazh te një personazh tjetër.	**Veprimtaria "Dy personazhe, dy botë"** ***Prezantimi i veprimtarisë*** Mësuesi paraqet dy citate ose përshkrime të shkurtra për Don Kishotin dhe Sançó Pançën dhe pyet: "*A mund të mbetet i njëjtë një personazh kur kalon shumë kohë pranë një personazhi tjetër?"* Kush ndikon më shumë

te tjetri: *Don Kishoti te Sanço Pança apo Sanço Pança te Don Kishoti*?. Nxënësit japin mendimet e para, të cilat do t'i rikthehen në fund të veprimtarisë.

Zhvillimi i veprimtarisë

Hapi 1: Harta e marrëdhënies

Në grupe, nxënësit analizojnë fragmente të ndryshme nga vepra dhe plotësojnë tabelën:

Don Kishoti	Sanço Pança
Si mendon?	Si mendon?
Çfarë vlerëson?	Çfarë vlerëson?
Si e sheh botën?	Si e sheh botën?

Më pas identifikojnë ngjashmëritë dhe dallimet.

Hapi 2: Kush ndikon te kush?

Çdo grup merr disa fragmente nga vepra dhe analizon:

- Si reagon Sanço ndaj ideve të Don Kishotit?
- A fillon Sanço të besojë në disa prej idealeve të zotërisë së tij?
- A bëhet Don Kishoti më realist në fund të veprës?
- Çfarë mëson secili prej tjetrit?

Nxënësit duhet të mbështesin përgjigjet me shembuj nga teksti.

Hapi 3: Diagrami i ndikimit

Grupet e nxënësve ndërtojnë një diagram me dy drejtime:

Don Kishoti → Sanço Pança

	Sanço Pança → Don Kishoti Për secilin drejtim vendosin: • ndikime në mënyrën e të menduarit; • ndikime në sjellje; • ndikime në vlerat dhe qëndrimet e personazheve. *Hapi 4: Intervista e dyfishtë* Dy nxënës marrin rolet e Don Kishotit dhe Sanço Pançës. Pjesa tjetër e klasës bën pyetje si: • Çfarë ke mësuar nga shoku yt i udhëtimit? • A të ka ndryshuar ai? • Për cilat gjëra nuk pajtoheni? • Për cilat gjëra jeni bërë më të ngjashëm? Përgjigjet duhet të mbështeten në ngjarje konkrete të veprës. *Hapi 5: Diskutim* Mësuesi paraqet pohimin: "*Marrëdhënia mes Don Kishotit dhe Sanço Pançës është një proces ndikimi të ndërsjellë*.". Grupet diskutojnë nëse pajtohen me këtë pohim dhe argumentojnë qëndrimin e tyre. ***Reflektimi*** Nxënësit shkruajnë një paragraf ku shpjegojnë: • si paraqitet marrëdhënia mes Don Kishotit dhe Sanço Pançës në fillim të veprës;

	• si zhvillohet ajo gjatë rrëfimit; • cilat ndryshime sjell kjo marrëdhënie te secili personazh. ***Produkti*** *Një analizë e marrëdhënies Don Kishoti=Sanço Pançо,* ku nxënësi: identifikon tiparet kryesore të secilit personazh; analizon ndikimin e tyre te njëri-tjetri; argumenton me shembuj nga teksti; shpjegon rëndësinë e kësaj marrëdhënieje në zhvillimin e veprës.
Nxënësi mbron idetë e tij duke i ilustruar me detaje dhe me shembuj nga teksti.	**Veprimtaria "A kishte të drejtë Prometeu?"** ***Prezantimi i veprimtarisë*** Pas leximit të fragmenteve nga *"Prometeu i mbërthyer",* mësuesi drejton pyetjen: *"A ishte i drejtë veprimi i Prometeut kur u dha zjarrin njerëzve, edhe pse e dinte se do të ndëshkohej?"*. Nxënësit shprehin mendimet e tyre. Disa mund të mbështesin Prometeun, ndërsa të tjerë mund të argumentojnë se ai sfidoi autoritetin e Zeusit dhe duhet të mbante përgjegjësi për pasojat. Mësuesi thekson se në letërsi një qëndrim nuk vlerësohet nga fakti nëse është "*i saktë*" apo "*i gabuar*", por nga mënyra se si argumentohet dhe mbështetet në tekst. ***Zhvillimi i veprimtarisë*** *Hapi 1: Opinion apo argument?* Mësuesi paraqet në tabelë disa pohime: • Prometeu është hero. • Prometeu është kryengritës. • Prometeu mendon për njerëzit.

- Prometeu sfidon pushtetin.

Nxënësit diskutojnë:

- Cilat prej tyre janë vetëm opinione?
- Si mund të mbështeten me dëshmi nga teksti?

Më pas plotësojnë tabelën:

Pohimi	Detaji ose shembulli nga teksti
Prometeu mendon për njerëzit.	U dha njerëzve zjarrin dhe njohuri që i ndihmojnë të mbijetojnë.
...	...

Hapi 2: Gjej provat

Nxënësit punojnë në grupe me fragmente të veprës. Çdo grup duhet të gjejë:

- fjalë të Prometeut;
- veprime të tij;
- qëndrime ose bindje që shfaq;
- reagimet e personazheve të tjera ndaj tij.

Më pas diskutojnë: *Çfarë na tregojnë këto detaje për karakterin dhe idealet e Prometeut*?

Hapi 3: Debati

Klasa ndahet në dy grupe.

	• *Grupi A*- Mbron tezën: Prometeu është hero i njerëzimit. • *Grupi B*- Mbron tezën: Prometeu veproi në kundërshtim me rendin e vendosur nga Zeusi. Çdo argument duhet të mbështetet me shembuj ose detaje konkrete nga teksti. Gjatë debatit nxënësit nuk lejohen të përdorin pohime të përgjithshme pa prova. *Hapi 4: Piramida e argumentimit* Mësuesi paraqet tri nivele përgjigjesh: • Niveli 1: Prometeu është trim. • Niveli 2: Prometeu është trim sepse sfidon Zeusin. • Niveli 3: Prometeu është trim sepse, edhe pse e di ndëshkimin që e pret, zgjedh t'u japë njerëzve zjarrin dhe njohuritë që do t'i ndihmojnë të përparojnë. Këtë e dëshmojnë edhe fjalët e tij kur mbron veprimin e vet dhe refuzon të pendohet para Zeusit. Nxënësit analizojnë se cila përgjigje është më bindëse dhe pse. *Hapi 5: Qëndrimi personal* Çdo nxënës zgjedh një nga pyetjet: • A është Prometeu simbol i lirisë? • A është sakrifica e tij e justifikuar? • Pse figura e Prometeut vazhdon të jetë aktuale edhe sot? Nxënësi formulon një qëndrim dhe e mbështet me të paktën dy argumente dhe dy shembuj nga teksti.

	Reflektimi Mësuesi pyet: • Çfarë e bën një argument bindës? • Pse duhet të mbështetemi te teksti kur mbrojmë një ide? ***Produkti*** *Një paragraf ose mini-ese argumentuese*, ku nxënësi: shpreh një qëndrim për figurën e Prometeut; përdor detaje, citime ose ngjarje nga vepra; ndërton argumente logjike; mbron bindshëm idenë e tij.
Nxënësi tregon se si një tekst e informon lexuesin rreth natyrës dhe përvojës njerëzore.	**Veprimtaria "Çfarë na mëson Prometeu për njeriun?"** ***Prezantimi i veprimtarisë*** Mësuesi drejton pyetjen: "*Pse vazhdojmë të lexojmë mite dhe tragjedi të shkruara mijëra vjet më parë? Çfarë mund të na mësojnë ato për njeriun e sotëm?"* Nxënësit diskutojnë shkurt dhe japin mendimet e tyre. Mësuesi shpjegon se letërsia nuk na jep vetëm kënaqësi estetike, histori dhe personazhe, por na ndihmon të kuptojmë më mirë natyrën njerëzore, mënyrën si njerëzit mendojnë, ndiejnë, zgjedhin dhe përballen me vështirësitë. ***Zhvillimi i veprimtarisë*** *Hapi 1: Përvoja njerëzore në tekst* Nxënësit punojnë në grupe me fragmente nga vepra. Çdo grup identifikon situata që lidhen me përvoja universale njerëzore: sakrifica, liria, padrejtësia, guximi, vuajtja, shpresa, qëndresa. Për secilën situatë evidentojnë pjesën e tekstit që e ilustron. *Hapi 2: Nga Prometeu te njeriu*

Grupet plotësojnë tabelën:

Situata në vepër	Çfarë na tregon për njeriun?
Prometeu pranon ndëshkimin.	Njeriu mund të sakrifikojë për bindjet e tij.
Prometeu nuk dorëzohet.	Njeriu kërkon lirinë dhe dinjitetin.
...	...

Nxënësit argumentojnë përgjigjet e tyre duke iu referuar tekstit.

Hapi 3: A ekziston edhe sot?

Çdo grup zgjedh një nga temat e veprës dhe diskuton: *A përballen njerëzit edhe sot me situata të ngjashme?* Ata japin shembuj nga jeta, historia, shoqëria ose aktualiteti. Diskutimi synon të tregojë se përvoja njerëzore e paraqitur në letërsi shpesh tejkalon kohën dhe vendin.

Hapi 4: Mur i ideve

Në tabelë ose në një platformë digjitale shkruhet: *"Prometeu na mëson se..."*. Çdo grup shton një përfundim të argumentuar. P.sh.:

- ...liria shpesh kërkon sakrificë.
- ...njeriu mund të mbrojë bindjet e veta edhe përballë pushtetit.
- ...dija dhe përparimi kanë vlerë për njerëzimin.

Hapi 5: Diskutimi përfundimtar

Mësuesi pyet:

- Çfarë mësojmë për natyrën njerëzore nga Prometeu?

	• Cilat tipare njerëzore paraqiten në vepër? • Pse këto tema mbeten aktuale edhe sot? ***Reflektimi*** Nxënësit shkruajnë një paragraf me temën: *"Një e vërtetë për njeriun që mësova nga Prometeu."*. Ata duhet të mbështesin mendimin e tyre me shembuj nga teksti. ***Produkti*** *Një reflektim argumentues*, ku nxënësi: • identifikon një aspekt të natyrës ose përvojës njerëzore në vepër; • shpjegon si paraqitet ai përmes personazheve dhe ngjarjeve; • e lidh me përvoja ose situata universale njerëzore; • argumenton mendimin e tij me shembuj nga teksti.
Nxënësi analizon tiparet kryesore të gjinisë dramatike dhe të llojeve të saj.	**Veprimtaria "Pse Molieri zgjodhi komedinë?"** ***Prezantimi i veprimtarisë*** Mësuesi paraqet pohimin: "Po të ishte shkruar si tragjedi, "Tartufi'" nuk do të kishte të njëjtin ndikim." Nxënësit diskutojnë në çifte: • A pajtoheni me këtë pohim? • Pse një autor zgjedh komedinë dhe jo tragjedinë për të trajtuar një problem shoqëror? Përgjigjet diskutohen në klasë pa u dhënë ende përfundime.

Zhvillimi i veprimtarisë

Hapi 1: Si ndërtohet një tekst dramatik?

Nxënësit punojnë me një fragment të veprës dhe analizojnë:

- Si paraqitet konflikti?
- Çfarë mësojmë për personazhet përmes dialogut?
- Çfarë roli luajnë didaskalitë?
- Pse mungon rrëfimtari?

Më pas diskutojnë: Si *do të ndryshonte kuptimi i fragmentit nëse ai do të rrëfehej nga një narrator*?

Nxënësit arrijnë në përfundimin se drama ndërton personazhet dhe konfliktin përmes veprimit skenik dhe dialogut.

Hapi 2: Komedi apo tragjedi?

Çdo grup merr një episod nga vepra dhe analizon:

- Ku qëndron konflikti?
- Cilat elemente krijojnë efekt komik?
- Si përdoret ironia?
- Cilat sjellje apo dukuri shoqërore kritikohen?

Pastaj grupet krahasojnë gjetjet e tyre me tiparet e tragjedisë. Ata plotësojnë tabelën:

Elementi	Në komedi	Në tragjedi

	Konflikti		
	Personazhet		
	Fundi		
	Qëllimi		

Hapi 3: Satira si armë artistike

Mësuesi u kërkon nxënësve të analizojnë figurën e Tartufit. Pyetjet orientuese të tij janë:

- Pse Molieri nuk e paraqet Tartufin si personazh tragjik?
- Si përdor autori humorin për të denoncuar hipokrizinë?
- A do të ishte po aq i fortë mesazhi nëse personazhi do të paraqitej në mënyrë serioze?

Nxënësit argumentojnë duke iu referuar dialogëve dhe situatave konkrete.

Hapi 4: Ndrysho gjininë

Çdo grup zgjedh një skenë dhe e rishkruan shkurt sikur të ishte tragjedi ose dramë. Më pas krahasojnë:

- Çfarë ndryshon në ton?
- Çfarë ndryshon në efektin te lexuesi ose spektatori?
- Cili version e përcjell më mirë kritikën e autorit?

Kjo veprimtari i ndihmon të kuptojnë funksionin e gjinisë dramatike dhe jo vetëm tiparet e saj formale.

Hapi 5: Debati

	Teza: "*Tartufi është më shumë se një komedi; ai është një kritikë e shoqërisë së kohës*.". Një grup mbron tezën duke u mbështetur te funksioni satirik i komedisë. Grupi tjetër argumenton se elementi kryesor i veprës mbetet argëtimi dhe efekti komik. Nxënësit duhet të mbështesin argumentet me situata, dialogë dhe personazhe nga teksti. ***Reflektimi*** Nxënësit shkruajnë një paragraf ku shpjegojnë: • cilat janë tiparet kryesore të gjinisë dramatike; • cilat tipare e bëjnë "Tartufin" një komedi; • pse Molieri e zgjedh komedinë si formë artistike për të kritikuar hipokrizinë shoqërore. ***Produkti*** Një analizë e shkurtër me temën: *"Tartufi si komedi satirike",* ku nxënësi: identifikon tiparet e gjinisë dramatike; analizon tiparet e komedisë në vepër; shpjegon funksionin e ironisë, humorit dhe satirës; argumenton pse zgjedhja e komedisë është e rëndësishme për mesazhin e veprës.
Nxënësi dallon konfliktin/et në një tekst dhe vlerëson mënyrën se si zgjidhen ato në vepër.	**Veprimtaria "Konflikti në qendër të skenës"** ***Prezantimi i veprimtarisë*** Mësuesi drejtor pyetjen: *Çfarë do të ndodhte me një dramë nëse personazhet do të binin dakord për gjithçka?* Nxënësit diskutojnë dhe arrijnë në përfundimin se konflikti është elementi që vë në lëvizje veprimin dramatik. Më pas mësuesi pyet: • Kush kundërshton kë në komedinë "Tartufi"?

	• A ka vetëm një konflikt në vepër? *Zhvillimi i veprimtarisë* *Hapi 1: Harta e konflikteve* Në grupe, nxënësit identifikojnë konfliktet kryesore dhe dytësore të veprës. Ata plotësojnë një skemë: • Tartufi - familja e Orgonit • Orgoni - familja e tij • Elmira - Tartufi • Damisi - Orgoni • Marjana - vendimi i Orgonit për martesën Për çdo konflikt përcaktojnë: shkakun; personazhet e përfshira; pasojat në zhvillimin e ngjarjeve. *Hapi 2: Konflikti kryesor apo dytësor?* Çdo grup analizon një konflikt dhe paraqet argumente për pyetjen: A *është ky konflikt kryesor për zhvillimin e veprës apo ka rol mbështetës?* Nxënësit duhet të mbështeten në episode konkrete nga teksti. *Hapi 3: Si përshkallëzohet konflikti?* Nxënësit vendosin në rend kronologjik momentet që rrisin tensionin dramatik: • ardhja e Tartufit në familje;

	• besimi i verbër i Orgonit; • paralajmërimet e familjarëve; • zbulimi i hipokrizisë së Tartufit; • përpjekja e Tartufit për të marrë pasurinë e Orgonit; • ndërhyrja përfundimtare e autoriteteve. Për çdo moment shpjegojnë: • si ndikon në konflikt; • pse e shton tensionin dramatik. *Hapi 4: A është bindëse zgjidhja?* Mësuesi paraqet pyetjen: "*A zgjidhet konflikti si pasojë e veprimeve të personazheve apo nga një ndërhyrje e jashtme?"* Nxënësit analizojnë fundin e veprës dhe diskutojnë: • Sa natyrshëm vjen zgjidhja? • A është e besueshme? • A është e drejtë për personazhet? • Çfarë mesazhi përcjell autori përmes kësaj zgjidhjeje? *Hapi 5: Gjykimi kritik*

	Çdo grup merr një nga pohimet: • Zgjidhja e konfliktit është e drejtë. • Zgjidhja e konfliktit është e papritur, por bindëse. • Zgjidhja e konfliktit varet më shumë nga rrethanat sesa nga veprimet e personazheve. • Molieri e përdor zgjidhjen për të theksuar mesazhin e veprës. Grupet argumentojnë qëndrimin e tyre me shembuj nga teksti. ***Reflektimi*** Nxënësit shkruajnë: *Cili konflikt ju duket më i rëndësishëm në komedinë "Tartufi" dhe pse? Si e gjykoni zgjidhjen e tij në vepër?* ***Produkti*** Një diagram i konflikteve në vepër ose një paragraf analitik ku nxënësi: • identifikon konfliktin kryesor dhe konfliktet dytësore; • shpjegon mënyrën se si zhvillohen; • analizon rolin e tyre në ndërtimin e veprës; • vlerëson mënyrën se si zgjidhen në fund të veprës.

Tabela 2. Shembuj veprimtarish praktike për përmbushjen e rezultateve të të nxënit të kompetencës

REZULTATET E TË NXËNIT	*VEPRIMTARITË PRAKTIKE*
Nxënësi shpjegon rëndësinë e Epit të Gilgameshit si një nga veprat më të hershme të letërsisë botërore.	**Veprimtaria "Pse vazhdojmë ta lexojmë Gilgameshin?"** ***Prezantimi i veprimtarisë*** Mësuesi paraqet pohimin: "Një *vepër e shkruar më shumë se katër mijë vjet më parë vazhdon të lexohet edhe sot."* Më pas pyet nxënësit: • Çfarë e bën një vepër të mbijetojë për mijëra vjet? • A mjafton vjetërsia që një vepër të ketë rëndësi? • Pse Epi i Gilgameshit konsiderohet një gur themeli i letërsisë botërore? Nxënësit japin hipotezat e tyre, të cilave do t'u rikthehen në fund të orës. ***Zhvillimi i veprimtarisë*** *Hapi 1: Zbulimi i veprës* Mësuesi paraqet disa të dhëna për veprën: • është krijuar në Mesopotami; • konsiderohet ndër veprat më të hershme të letërsisë botërore; • ruhet në pllaka balte; • trajton tema që vazhdojnë të preokupojnë njerizimin edhe sot.

	Në grupe, nxënësit diskutojnë: *Çfarë mund të na tregojë kjo vepër për botën e lashtë dhe për njeriun në përgjithësi?* *Hapi 2: Temat që kapërcejnë kohën* Çdo grup analizon një temë të veprës: • miqësia; • pushteti; • vdekshmëria; • kërkimi i pavdekësisë; • kuptimi i jetës. Nxënësit evidentojnë episode nga vepra dhe diskutojnë: • Pse kjo temë ishte e rëndësishme në kohën e Gilgameshit? • Pse mbetet e rëndësishme edhe sot? *Hapi 3: Pse është vepër themelore?* Grupet punojnë me pyetjen: *Çfarë e bën Gilgameshin një vepër të rëndësishme për historinë e letërsisë*? Ata duhet të analizojnë: • hershmërinë e veprës; • strukturën epike;

	• figurën e heroit; • temat universale; • ndikimin në traditat e mëvonshme letrare. Më pas paraqesin përfundimet para klasës. *Hapi 4: Gilgameshi dhe heronjtë e tjerë* Mësuesi paraqet emra si: Akili, Odiseo, Hamleti, Don Kishoti etj. Nxënësit diskutojnë: • Cilat tipare të heroit shfaqen fillimisht te Gilgameshi? • Çfarë e dallon atë nga heronjtë e mëvonshëm? • Pse figura e tij konsiderohet një model i hershëm i heroit letrar? *Hapi 5: Diskutimi* Teza për diskutim: "*Rëndësia e Epit të Gilgameshit nuk qëndron vetëm te lashtësia e tij, por edhe te temat universale që trajton*.". Nxënësit argumentojnë qëndrimet e tyre duke iu referuar veprës. ***Reflektimi*** Nxënësit shkruajnë një paragraf ku shpjegojnë: • pse Epi i Gilgameshit konsiderohet një nga veprat më të rëndësishme të letërsisë botërore; • cilat tema e bëjnë atë aktual edhe sot;

	• çfarë na mëson vepra për njeriun dhe përvojën njerëzore. ***Produkti*** Një tekst argumentues me titull: *"Epi i Gilgameshit: fillimi i një tradite letrare",* ku nxënësi: • shpjegon rëndësinë historike dhe letrare të veprës; • analizon temat universale që trajton; • argumenton pse ajo vazhdon të lexohet edhe sot; • e lidh veprën me zhvillimin e letërsisë botërore.
Nxënësi identifikon elementet e letërsisë gojore në poemën "Iliada", si përsëritjet, epitetet e vazhdueshme, formulat tipike të rrëfimit gojor etj., duke i ilustruar me shembuj nga teksti.	**Veprimtaria "Gjurmët e traditës gojore te Iliada"** ***Prezantimi i veprimtarisë*** Mësuesi lexon dy fragmente të shkurtra nga poema, ku shfaqen epitete dhe formula të përsëritura, p.sh.: • Akil këmbëshpejti • Agim gishttrëndafilti • Zeusi rrufehedhësi • Helena flokarta • Etj. Më pas pyet:

- Pse Homeri i përsërit vazhdimisht këto shprehje?
- A janë ato thjesht zbukurime gjuhësore?
- Çfarë na tregojnë për mënyrën si është krijuar dhe përcjellë poema?

Nxënësit japin mendimet e tyre dhe formulojnë hipoteza.

Zhvillimi i veprimtarisë

Hapi 1: Hetuesit e tekstit

Nxënësit punojnë në grupe me fragmente të ndryshme nga "Iliada". Detyra është të evidentojnë:

- përsëritjet;
- epitetet e vazhdueshme;
- formulat e zakonshme të rrëfimit;
- thirrjet drejtuar muzës ose zotave;
- përshkrimet tipike të heronjve dhe hyjnive;
- etj.

Ata plotësojnë tabelën:

Elementi i letërsisë gojore	Shembulli nga teksti	Funksioni
Epitet i vazhdueshëm		
Përsëritje		
Formulë rrëfimi		
…		

	Hapi 2: Pse përsëriten? Çdo grup zgjedh disa shembuj dhe diskuton: • Si do të ndikonte teksti po të hiqeshin këto përsëritje? • Pse i ndihmonin rapsodët/këngëtarët gjatë recitimit? • Si ndikojnë te ritmi dhe kujtesa e dëgjuesit? Nxënësit analizojnë lidhjen midis formës së veprës dhe traditës gojore. *Hapi 3: Rapsodët në veprim* Mësuesi ndan klasën në grupe dhe u jep një fragment të shkurtër. Nxënësit e lexojnë me zë të lartë duke evidentuar: • ritmin; • përsëritjet; • formulat tipike. Pas interpretimit diskutojnë: *Cilat elemente e bëjnë më të lehtë dëgjimin dhe kujtimin e poemës*? *Hapi 4: Nga tradita gojore te poema epike* Mësuesi drejton pyetjen: Çfarë *na tregojnë këto elemente për origjinën e "Iliadës"?* Grupet përgatisin një përgjigje të argumentuar duke u mbështetur në shembuj nga teksti. Ata duhet të arrijnë në përfundimin se poema është produkt i një tradite të gjatë gojore para se të fiksohej me shkrim. ***Reflektimi***

	Nxënësit shkruajnë një paragraf ku shpjegojnë: • cilat elemente të letërsisë gojore identifikuan në poemë; • çfarë funksioni kryejnë ato; • si lidhen me mënyrën e krijimit dhe të transmetimit të "Iliadës". ***Produkti*** Një analizë e shkurtër me temën: *"Elementet e traditës gojore në Iliadë",* ku nxënësi: • identifikon epitetet e vazhdueshme, përsëritjet dhe formulat tipike; • i ilustron me shembuj nga teksti; • analizon funksionin e tyre artistik dhe mnemonik; • shpjegon lidhjen e tyre me origjinën gojore të poemës.
Nxënësi analizon mënyrën se si trajtohen temat universale të sfidimit të pushtetit dhe të sakrificës për të mirën e njerëzimit në veprën "Prometeu i mbërthyer".	**Veprimtaria "Prometeu kundër Zeusit: rebel apo mbrojtës i njerëzimit?"** ***Prezantimi i veprimtarisë*** Mësuesi paraqet pohimin: "*Përparimi i njerëzimit ka ardhur shpesh si rezultat i njerëzve që kanë sfiduar autoritetin.*". Nxënësit diskutojnë në çifte: • A pajtoheni me këtë pohim? • A mund të justifikohet kundërshtimi ndaj pushtetit? • Kur një sakrificë bëhet e vlefshme për shoqërinë?

Më pas mësuesi e lidh diskutimin me figurën e Prometeut dhe shtron pyetjen: *Pse Prometeu pranon vuajtjen në vend që të nënshtrohet?*

Zhvillimi i veprimtarisë

Hapi 1: Dy boshtet e konfliktit

Nxënësit punojnë në grupe dhe analizojnë fragmente të veprës. Çdo grup evidenton episode që lidhen me:

- sfidimin e pushtetit të Zeusit;
- sakrificën e Prometeut për njerëzit.

Ata plotësojnë tabelën:

Veprimi i Prometeut	Çfarë tregon për qëndrimin e tij?
U jep njerëzve zjarrin.	
Refuzon të kërkojë falje.	
Pranon ndëshkimin.	

Më pas diskutojnë se si këto veprime ndërtojnë konfliktin qendror të tragjedisë.

Hapi 2: Konflikt politik apo konflikt moral?

Mësuesi drejton pyetjen: "*A është konflikti mes Prometeut dhe Zeusit vetëm një përplasje pushteti apo edhe një përplasje vlerash?".* Grupet analizojnë:

- çfarë përfaqëson Zeusi;
- çfarë përfaqëson Prometeu;

	• cilat vlera mbrohen nga secili. Nxënësit mbështesin përgjigjet me fjalë, veprime dhe qëndrime të personazheve. *Hapi 3: Sakrifica dhe pasojat e saj* Çdo grup shqyrton një aspekt të sakrificës së Prometeut: • çfarë humbet ai; • çfarë fitojnë njerëzit; • pse nuk pendohet për veprimin e tij; • si paraqitet qëndrueshmëria e tij gjatë vuajtjes. Më pas grupet diskutojnë: *A do të kishte të njëjtën forcë figura e Prometeut nëse ai do të tërhiqej përballë ndëshkimit?* *Hapi 4: Aktualiteti i temave* Nxënësit punojnë me pyetjen: *Pse temat e sfidimit të pushtetit dhe të sakrificës vazhdojnë të shfaqen në letërsi, histori dhe shoqëri?*. Ata lidhin veprën me raste të njohura nga historia ose aktualiteti, pa u larguar nga analiza e tekstit. *Hapi 5: Debati* Teza për debat: "*Forca e Prometeut nuk qëndron te fuqia e tij, por te besnikëria ndaj bindjeve të veta*.". Nxënësit duhet të përdorin episode, dialogë dhe qëndrime konkrete të personazhit. ***Reflektimi***

	Nxënësit shkruajnë një paragraf ku shpjegojnë: • si paraqitet sfidimi i pushtetit në vepër; • si paraqitet sakrifica e Prometeut; • pse këto tema konsiderohen universale. ***Produkti*** Një analizë me temën: **"***Prometeu si simbol i sfidimit të pushtetit dhe i sakrificës për njerëzimin",* ku nxënësi: • analizon konfliktin midis Prometeut dhe Zeusit; • shpjegon motivet e veprimeve të Prometeut; • analizon vlerën e sakrificës së tij; • argumenton aktualitetin e temave që trajton vepra.
Nxënësi analizon vlerat historike, etike dhe shoqërore që përcjell "Eposi i Kreshnikëve" për jetën dhe botëkuptimin e shqiptarëve në të kaluarën.	**Veprimtaria "Çfarë na tregon Eposi i Kreshnikëve për botën shqiptare?"** ***Prezantimi i veprimtarisë*** Mësuesi paraqet pohimin: "*Eposi i Kreshnikëve nuk është vetëm një rrëfim për trimat, por edhe një pasqyrë e mënyrës se si jetonin, mendonin dhe vepronin shqiptarët*." Më pas pyet: • Çfarë mund të mësojmë për një popull nga këngët e tij epike? • A mund të shërbejë letërsia si dëshmi e një kohe dhe e një mënyre jetese?

	• Cilat vlera mendoni se vlerësoheshin më shumë në shoqërinë e paraqitur në Epos? Nxënësit japin mendimet e para, të cilat do të verifikohen gjatë analizës së tekstit. ***Zhvillimi i veprimtarisë*** *Hapi 1: Leximi i botës së kreshnikëve* Nxënësit punojnë me një këngë të Eposit (p.sh. "Martesa e Halilit", "Muji dhe Behuri" ose "Orët e Mujit"). Në grupe evidentojnë: • mënyrën e jetesës; • marrëdhëniet familjare; • organizimin shoqëror; • raportin me nderin, besën dhe trimërinë; • marrëdhëniet me të huajt dhe me kundërshtarët. Çdo grup paraqet gjetjet e tij duke iu referuar episodeve konkrete. *Hapi 2: Vlera historike* Mësuesi pyet: Çfarë informacioni na jep Eposi për jetën e shqiptarëve në të kaluarën? Nxënësit analizojnë elemente si: • jeta në kufi; • luftërat dhe mbrojtja e trojeve; • organizimi fisnor;

	• roli i burrave dhe grave; • jeta në familje; • zakonet dhe traditat. Diskutohet se si Eposi ruan kujtesën historike dhe kulturore të komunitetit. *Hapi 3: Vlera etike* Çdo grup analizon një vlerë të paraqitur në Epos: • besa; • nderi; • trimëria; • mikpritja; • besnikëria ndaj familjes dhe fisit. Nxënësit duhet të gjejnë: • episode ku shfaqet kjo vlerë; • personazhet që e mishërojnë atë; • rëndësinë që ka për kreshnikët. Më pas diskutojnë: *Cilat prej këtyre vlerave vazhdojnë të jenë të rëndësishme edhe sot? Pse?* *Hapi 4: Vlera shoqërore dhe botëkuptimi*

	Nxënësit analizojnë pyetjen: *Çfarë lloj njeriu paraqitet si model në Eposin e Kreshnikëve?* Ata evidentojnë tiparet e heroit epik dhe diskutojnë: • pse vlerësohet trimëria; • pse mbrohet nderi; • si kuptohet drejtësia; • çfarë roli ka komuniteti në jetën e individit. Diskutimi synon të nxjerrë në pah botëkuptimin e shoqërisë që ka krijuar dhe ruajtur Eposin. *Hapi 5: Debati* Teza për debat: "*Vlera më e rëndësishme që përcjell Eposi i Kreshnikëve është besa*." Grupet zgjedhin të mbrojnë ose të kundërshtojnë tezën. Ata duhet të argumentojnë nëse një vlerë tjetër, si trimëria, nderi ose besnikëria, ka po aq ose më shumë rëndësi në botën e Eposit. ***Reflektimi*** Nxënësit shkruajnë një paragraf ku shpjegojnë: • çfarë mësojmë për jetën e shqiptarëve përmes Eposit; • cilat vlera paraqiten si themelore; • si pasqyrohet botëkuptimi i kohës në veprimet e personazheve. ***Produkti*** *Një tekst i shkurtër me temën "Bota e Eposit të Kreshnikëve",* ku nxënësi:

	• identifikon vlerat historike, etike dhe shoqërore të veprës; • analizon mënyrën si paraqiten ato në tekst; • shpjegon çfarë na tregojnë për jetën dhe botëkuptimin e shqiptarëve në të kaluarën; • argumenton me episode dhe personazhe konkrete nga Eposi.
Nxënësi gjykon për vlerat artistike, zakonore, morale dhe kulturore që përcjellin këngët legjendare të murosjes, të rinjohjes dhe të vëllait të vogël, si pjesë e trashëgimisë shpirtërore shqiptare.	**Veprimtaria "Trashëgimi apo vetëm legjendë?"** ***Prezantimi i veprimtarisë*** Mësuesi shkruan në tabelë katër fjalë: sakrifica, besa, nderi, familja. Më pas pyet: • Cila nga këto vlera ju duket më e rëndësishme? • A mendoni se këto vlera kanë të njëjtën peshë sot si në të kaluarën? • Pse këngët legjendare shqiptare i kanë ruajtur pikërisht këto tema? Nxënësit japin mendimet e tyre dhe argumentojnë shkurt zgjedhjet. ***Zhvillimi i veprimtarisë*** *Hapi 1: Leximi krahasues* Klasa ndahet në tri grupe. • Grupi I punon me një këngë të murosjes. • Grupi II punon me "Konstandini dhe Doruntina".

- Grupi III punon me një këngë të rinjohjes.

Çdo grup evidenton:

- konfliktin kryesor;
- personazhet;
- vlerat që paraqiten në tekst;
- zakonet ose normat që udhëheqin veprimet e personazheve.

Hapi 2: Katër këndvështrime

Çdo grup analizon tekstin sipas katër kategorive.

Lloji i vlerës	Pyetja orientuese
Artistike	Si krijohet emocioni dhe atmosfera legjendare?
Zakonore	Cilat zakone, norma ose tradita paraqiten?
Morale	Çfarë sjelljesh paraqiten si të drejta ose të lavdërueshme?
Kulturore	Çfarë na mëson kënga për botëkuptimin e shqiptarëve?

Nxënësit duhet të mbështesin përfundimet me episode dhe detaje konkrete nga teksti.

Hapi 3: Gjykimi kritik

Mësuesi paraqet disa pohime:

- Sakrifica e Rozafës është një vlerë që duhet admiruar.
- Mbajtja e besës në "Konstandini dhe Doruntina" është vlera më e lartë e këngës.

<table>
<tr>
<td></td>
<td>

Ymer Aga përfaqëson modelin e heroit popullor shqiptar.

Grupet nuk duhet vetëm të bien dakord ose jo, por të argumentojnë:

pse e mbështesin pohimin;
cilat elemente të tekstit e vërtetojnë;
a mund të interpretohet ndryshe sot.

Hapi 4: Debati i trashëgimisë
Çdo grup përgatit një argument për tezën: “Rëndësia e këtyre këngëve nuk qëndron vetëm te vlera artistike, por te vlerat që ato kanë transmetuar ndër breza.”. Nxënësit përdorin shembuj nga këngët për të mbështetur argumentet e tyre.
Hapi 5: Krahasimi dhe vlerësimi
Nxënësit plotësojnë tabelën:
<table>
<tr><th>Kënga</th><th>Vlera më e spikatur</th><th>Pse është e rëndësishme?</th></tr>
<tr><td>Kënga e murosjes</td><td></td><td></td></tr>
<tr><td>Kënga e rinjohjes</td><td></td><td></td></tr>
<tr><td>Kënga e vëllait të vogël</td><td></td><td></td></tr>
</table>
Më pas diskutojnë:

Cila vlerë shfaqet në më shumë se një këngë?
Cila vlerë ju duket më përfaqësuese për kulturën shqiptare?

</td>
</tr>
</table>

	• Cila vlerë ju duket më aktuale sot? ***Reflektimi*** Nxënësit shkruajnë një paragraf argumentues: *Cila është vlera më e rëndësishme që përcjellin këngët legjendare shqiptare dhe pse?* Ata duhet ta mbështesin përgjigjen me shembuj nga të paktën dy këngë. ***Produkti*** *Një poster analitik me temën "Vlerat e këngëve legjendare shqiptare si pjesë e trashëgimisë shpirtërore",* ku nxënësi: • analizon vlerat artistike, zakonore, morale dhe kulturore; • gjykon rëndësinë e tyre në kontekstin e kohës dhe në ditët e sotme; • argumenton me shembuj nga këngët e murosjes, të rinjohjes dhe të vëllait të vogël; • vlerëson rolin e tyre në formësimin e identitetit kulturor shqiptar.
Nxënësi vlerëson rëndësinë e "Komedisë Hyjnore" si një nga veprat më të mëdha të letërsisë botërore.	**Veprimtaria "Pse Dante vazhdon të lexohet edhe sot?"** ***Prezantimi i veprimtarisë*** Mësuesi paraqet pohimin: "*Ka vepra që lexohen në kohën kur shkruhen dhe harrohen. Ka të tjera që vazhdojnë të lexohen për shekuj."* Më pas pyet: • Çfarë e bën një vepër të kapërcejë kohën?

	• A mjafton vlera artistike që një vepër të konsiderohet kryevepër? • Pse "Komedia Hyjnore" vazhdon të studiohet pas më shumë se shtatë shekujsh? Nxënësit japin mendimet e para dhe formulojnë hipoteza. ***Zhvillimi i veprimtarisë*** *Hapi 1: Çfarë e bën një vepër të madhe?* Në grupe, nxënësit diskutojnë dhe rendisin kriteret që, sipas tyre, e bëjnë një vepër të rëndësishme për letërsinë botërore. Ata mund të përmendin: • origjinalitetin; • vlerat artistike; • ndikimin te brezat e mëvonshëm; • temat universale; • rëndësinë historike dhe kulturore. Çdo grup argumenton zgjedhjet e veta. *Hapi 2: Dante nën vëzhgim* Mësuesi paraqet informacione kryesore për veprën: • përmbledhje e dijes, kulturës dhe botëkuptimit mesjetar; • udhëtim simbolik nga humbja drejt shpëtimit; • bashkim i filozofisë, fesë, historisë dhe poezisë;

	• ndikim i jashtëzakonshëm në letërsinë evropiane. Nxënësit analizojnë se si secili prej këtyre elementeve ndikon në rëndësinë e veprës. *Hapi 3: Galeria e argumenteve* Çdo grup merr një temë: • vlera artistike; • rëndësia historike; • temat universale; • ndikimi në letërsinë botërore. Detyra: • të gjejë argumente; • të japë shembuj nga vepra; • të shpjegojë pse ky aspekt e bën veprën të jashtëzakonshme. Më pas grupet prezantojnë gjetjet e tyre. *Hapi 4: Dante përtej Mesjetës* Mësuesi drejton pyetjen: *Pse një vepër e lidhur me botëkuptimin mesjetar vazhdon të flasë edhe për lexuesin modern?* Nxënësit analizojnë tema si:

	• kërkimi i kuptimit të jetës; • përgjegjësia morale; • drejtësia; • zgjedhjet njerëzore; • udhëtimi i njeriut drejt njohjes së vetvetes. Diskutimi synon të nxjerrë në pah universalitetin e veprës. *Hapi 5: Tryeza e kritikëve* Klasa organizon një diskutim me tezën: "Rëndësia e *Komedisë hyjnore* qëndron më shumë te vlerat artistike sesa te përmbajtja e saj fetare dhe historike." Një grup mbron tezën, ndërsa grupi tjetër argumenton se madhështia e veprës qëndron pikërisht në ndërthurjen e të gjitha këtyre elementeve. Nxënësit duhet të përdorin argumente dhe shembuj konkretë. ***Reflektimi*** Nxënësit shkruajnë një paragraf ku shpjegojnë: • pse "Komedia hyjnore" konsiderohet kryevepër; • cili aspekt i veprës u duket më i rëndësishëm; • pse ajo vazhdon të ketë ndikim në kulturën dhe letërsinë botërore. ***Produkti***

	Një ese argumentuese me temën "Pse Komedia Hyjnore është një kryevepër e letërsisë botërore?", ku nxënësi: • vlerëson rëndësinë historike, kulturore dhe artistike të veprës; • argumenton ndikimin që ka pasur në letërsinë dhe kulturën evropiane; • mbështet gjykimet me shembuj dhe referenca nga vepra.
Nxënësi analizon *donkishotizmin* si dukuri që ka lindur nga vepra e Servantesit dhe tregon si është shfaqur e shfaqet në kohë të ndryshme në shoqëri.	**Veprimtaria "A ka Don Kishotë edhe sot?"** ***Prezantimi i veprimtarisë*** Mësuesi shkruan në tabelë shprehjen: ***"Ai është një Don Kishot."*** Më pas pyet: • Çfarë kuptimi ka kjo shprehje sot? • A përdoret si vlerësim apo si kritikë? • Pse emri i një personazhi letrar është kthyer në një nocion që përdoret edhe jashtë letërsisë? Nxënësit japin mendimet e tyre dhe përpiqen të shpjegojnë se çfarë kuptojnë me termin *donkishotizëm.* ***Zhvillimi i veprimtarisë*** *Hapi 1: Nga personazhi te dukuria* Nxënësit punojnë me fragmente nga vepra ku shfaqen tiparet kryesore të Don Kishotit. Ata evidentojnë: • idealizmin e tij;

	• besimin te vlerat kalorësiake; • përplasjen me realitetin; • këmbënguljen për të ndjekur idealet e veta; • gatishmërinë për të sakrifikuar për një botë më të drejtë. Më pas diskutojnë: Cilat prej këtyre tipareve shndërrohen në atë që sot quhet donkishotizëm? *Hapi 2: Dy interpretime të donkishotizmit* Mësuesi paraqet dy pohime: • Donkishotizmi është idealizëm fisnik dhe përkushtim ndaj idealeve. • Donkishotizmi është shkëputje nga realiteti dhe ndjekje e iluzioneve. Klasa ndahet në dy grupe. Secili grup mbledh argumente nga vepra për të mbështetur një nga interpretimet. Në fund diskutohet nëse donkishotizmi mund të përmbajë të dyja dimensionet njëkohësisht. *Hapi 3: Don Kishoti përtej veprës* Nxënësit analizojnë situata të ndryshme: • një njeri që lufton i vetëm kundër një padrejtësie; • një aktivist që mbron një kauzë të pamundur; • një person që ndjek një ideal pa marrë parasysh realitetin; • një reformator që sfidon mendësinë e kohës.

	Për secilin rast diskutojnë: • A mund të quhet donkishotesk? • Cilat tipare të Don Kishotit shfaqen? • A sjell pasoja pozitive apo negative? *Hapi 4: Donkishotizmi në kohë të ndryshme* Grupet analizojnë pyetjen: *Pse figura e Don Kishotit vazhdon të përdoret edhe pas katër shekujsh?* Ata evidentojnë se *donkishotizmi* është shfaqur në kontekste të ndryshme: • në politikë; • në jetën shoqërore; • në art dhe letërsi; • në veprimtarinë qytetare. Diskutohet se si kuptimi i tij mund të ndryshojë sipas kohës dhe rrethanave. *Hapi 5: Debati* Teza për debat: "*Shoqëria ka nevojë për njerëz me shpirt donkishotesk*.".Një grup argumenton se idealistët janë motor i ndryshimit shoqëror. Grupi tjetër argumenton se idealizmi i shkëputur nga realiteti çon në dështim. Nxënësit mbështesin argumentet me shembuj nga vepra dhe nga jeta shoqërore. ***Reflektimi*** Nxënësit shkruajnë një paragraf ku shpjegojnë:

	• çfarë kuptojnë me termin donkishotizëm; • cilat tipare të Don Kishotit e kanë krijuar këtë nocion; • si shfaqet ai në shoqërinë e sotme.
Nxënësi vlerëson rëndësinë që ka "Hamleti" në letërsinë botërore si një nga tragjeditë më të njohura dhe më me ndikim të Shekspirit.	**Veprimtaria "Pse Hamleti vazhdon të jetojë pas katër shekujsh?"** ***Prezantimi i veprimtarisë*** Mësuesi paraqet disa pohime: • "Hamleti" është përkthyer në qindra gjuhë. • "Hamleti" vazhdon të vihet në skenë në mbarë botën. • Figura e Hamletit është bërë simbol i njeriut që përballet me dilema të vështira. Më pas pyet: • Pse një tragjedi e shkruar në fillim të shekullit XVII vazhdon të tërheqë lexues dhe spektatorë? • Çfarë e bën "Hamletin" një vepër të rëndësishme për letërsinë botërore? • A mjafton fama për ta quajtur një vepër kryevepër? Nxënësit japin mendimet e tyre dhe formulojnë hipoteza që do t'i verifikojnë gjatë orës. ***Zhvillimi i veprimtarisë*** *Hapi 1: Çfarë e bën një vepër universale?* Në grupe, nxënësit analizojnë temat kryesore të tragjedisë:

	• pushteti; • drejtësia; • hakmarrja; • tradhtia; • përgjegjësia morale; • dilemat e individit. Për secilën temë diskutojnë: • Pse është e rëndësishme për personazhet? • Pse mbetet aktuale edhe sot? • Si ndihmon në jetëgjatësinë e veprës? *Hapi 2: Hamleti si personazh universal* Nxënësit analizojnë figurën e Hamletit dhe evidentojnë: • konfliktin e tij të brendshëm; • dilemat morale; • marrëdhënien me pushtetin; • raportin me të vërtetën dhe drejtësinë. Më pas diskutojnë: *Pse Hamleti konsiderohet një nga personazhet më të studiuar të letërsisë botërore?*

	Çfarë e dallon atë nga heronjtë e tjerë tragjikë? *Hapi 3: Ndikimi i veprës* Çdo grup analizon një aspekt të ndikimit të "Hamletit": • në teatër; • në letërsinë e mëvonshme; • në filozofi dhe mendimin njerëzor; • në kulturën bashkëkohore. Nxënësit përgatisin argumente për pyetjen: *Pse "Hamleti" konsiderohet një pikë referimi në historinë e letërsisë?* *Hapi 4: Tryeza e kritikëve* Çdo grup merr një rol: • kritik letrar; • regjisor teatri; • studiues i letërsisë; • lexues bashkëkohor. Nga këndvështrimi i rolit të vet, grupi duhet të argumentojë pse "Hamleti" mbetet një vepër e rëndësishme. *Hapi 5: Debati* Teza për debat: "*Rëndësia e Hamletit qëndron më shumë te personazhi sesa te ngjarjet e tragjedisë*."

	Një grup mbron tezën, ndërsa grupi tjetër argumenton se rëndësia e veprës qëndron në ndërthurjen e personazhit, konfliktit dhe temave universale. Nxënësit mbështesin argumentet me shembuj nga teksti. ***Reflektimi*** Nxënësit shkruajnë një paragraf ku shpjegojnë: • pse "Hamleti" konsiderohet kryevepër e letërsisë botërore; • cili aspekt i veprës u duket më i rëndësishëm; • pse tragjedia vazhdon të lexohet dhe të interpretohet edhe sot. **Produkti** *Një ese argumentuese me temën "Pse Hamleti mbetet një nga tragjeditë më të rëndësishme të letërsisë botërore?",* ku nxënësi: • vlerëson rëndësinë artistike dhe kulturore të veprës; • analizon temat universale dhe figurën e Hamletit; • argumenton ndikimin e tragjedisë në letërsinë dhe kulturën botërore; • mbështet gjykimet me shembuj nga teksti.
Nxënësi shpjegon rolin e letërsisë së vjetër shqiptare për ruajtjen e gjuhës shqipe dhe të identitetit të shqiptarëve.	**Veprimtaria "Si mbijetoi gjuha shqipe?"** ***Prezantimi i veprimtarisë*** Mësuesi drejton pyetjen: Si *do ta njihnim sot gjuhën e shqiptarëve të shekullit XVI ose XVII nëse nuk do të ishin shkruar veprat e para në shqip*?

	Më pas paraqet në tabelë titujt: • "Meshari" Gjon Buzuku • "Apologjia e Skënderbeut" Frang Bardhi • poezi nga Pjetër Budi • "Çeta e profetëve" Pjetër Bogdani Nxënësit diskutojnë: • Pse ka rëndësi që një popull të shkruajë në gjuhën e vet? • Çfarë rrezikon të humbasë një popull nëse humbet gjuhën? ***Zhvillimi i veprimtarisë*** *Hapi 1: Katër autorë, një mision* Klasa ndahet në katër grupe. Çdo grup studion shkurt një autor ose vepër. Nxënësit evidentojnë: • kohën kur është shkruar; • qëllimin e veprës; • kontributin për gjuhën shqipe; • kontributin për kulturën dhe identitetin kombëtar. Më pas grupet paraqesin gjetjet e tyre para klasës.

Hapi 2: Më shumë se letërsi

Mësuesi drejton pyetjen: *A kanë këto vepra vetëm vlerë letrare*?

Nxënësit analizojnë dhe plotësojnë tabelën:

Vepra	Kontributi për gjuhën	Kontributi për identitetin
Meshari		
Apologjia e Skënderbeut		
Poezitë e Budit		
Çeta e profetëve		

Diskutimi fokusohet te fakti se këto vepra dokumentojnë ekzistencën dhe përdorimin e shqipes së shkruar.

Hapi 3: Gjuha si identitet

Nxënësit analizojnë pohimin: "*Ruajtja e gjuhës është edhe ruajtje e identitetit."*

Çdo grup duhet të argumentojë këtë ide duke iu referuar një prej autorëve të studiuar.

Pyetje orientuese:

- Pse Buzuku zgjodhi të shkruante në shqip?
- Pse Bardhi mbron figurën e Skënderbeut?
- Çfarë vlerash kulturore përcjellin Budi dhe Bogdani?
- Si ndihmojnë këto vepra në ruajtjen e kujtesës kolektive?

Hapi 4: Tryeza e studiuesve

Çdo grup merr rolin e një studiuesi dhe mbron një tezë:

	• "Meshari" është dëshmia më e rëndësishme e shqipes së shkruar. • Frang Bardhi kontribuon në ruajtjen e kujtesës historike shqiptare. • Pjetër Budi forcon ndërgjegjen kulturore dhe gjuhësore. • Pjetër Bogdani e pasuron shqipen dhe kulturën shqiptare. Nxënësit argumentojnë me fakte dhe shembuj nga veprat. *Hapi 5: Diskutimi përfundimtar* Mësuesi shtron pyetjen: *A do të ishte i njëjtë identiteti kulturor shqiptar pa veprat e letërsisë së vjetër shqiptare?* Nxënësit argumentojnë duke iu referuar autorëve dhe veprave të analizuara. ***Reflektimi*** Nxënësit shkruajnë një paragraf ku shpjegojnë: • pse letërsia e vjetër shqiptare ka rëndësi për historinë e gjuhës shqipe; • si ka ndihmuar ajo në ruajtjen e identitetit shqiptar; • cili autor ose vepër u duket më me ndikim dhe pse. ***Produkti*** *Një infografik me temën "Letërsia e vjetër shqiptare: gjuhë, kulturë dhe identitet"*, ku nxënësi: • shpjegon rolin e veprave të para në shqip; • analizon kontributin e tyre në ruajtjen e gjuhës;

	• argumenton rëndësinë e tyre për identitetin kulturor dhe kombëtar të shqiptarëve; • përdor shembuj nga Buzuku, Bardhi, Budi dhe Bogdani.
Nxënësi gjykon për vlerat artistike të veprës "Historia e Skënderbeut" të Marin Barletit, duke e vendosur në kontekstin e letërsisë evropiane të kohës.	**Veprimtaria "Skënderbeu i historisë apo Skënderbeu i letërsisë?"** ***Prezantimi i veprimtarisë*** Mësuesi paraqet një fragment ku Barleti përshkruan Skënderbeun para një beteje ose në një moment vendimtar. Më pas pyet: • A po lexojmë vetëm një fakt historik? • Si përpiqet autori të ndikojë te lexuesi? • Çfarë e bën këtë tekst letrar? ***Zhvillimi i veprimtarisë*** *Hapi 1: Vëzhgo mjeshtërinë e autorit* Në grupe, nxënësit evidentojnë: • përshkrimet e figurës së Skënderbeut; • fjalimet dhe dialogët; • mjetet stilistike; • elementet emocionale; • momentet ku autori idealizon heroin.

	Diskutojnë: Si ndikon secili element në krijimin e figurës së heroit? *Hapi 2: Heroi humanist* Mësuesi paraqet disa tipare të heroit të letërsisë humaniste: • trimëria; • urtësia; • virtyti moral; • përgjegjësia ndaj atdheut; • aftësia për të frymëzuar të tjerët. Nxënësit analizojnë: *Si mishërohen këto tipare te Skënderbeu? Pse Barleti i kushton kaq rëndësi figurës së individit?* *Hapi 3: Gjykimi kritik* Çdo grup merr një pohim: • Barleti synon më shumë të lartësojë figurën e Skënderbeut sesa të tregojë ngjarje. • Vlera më e madhe e veprës qëndron te ndërtimi artistik i heroit. • Fjalimet e Skënderbeut janë element i rëndësishëm artistik. • Ideali humanist është thelbësor në paraqitjen e figurës së Skënderbeut. Nxënësit mbrojnë ose kundërshtojnë pohimin me argumente nga teksti. *Hapi 4: Vendosja në kontekst*

	Nxënësit krahasojnë figurën e Skënderbeut me modelin e heroit të Rilindjes Evropiane. Diskutojnë: • Cilat ideale përfaqëson? • Pse mund të konsiderohet figurë tipike e humanizmit? • Si lidhet vepra me frymën kulturore të shekujve XV-XVI? ***Reflektimi*** Cila është vlera artistike që ju duket më e rëndësishme në "Historinë e Skënderbeut" dhe si lidhet ajo me idealet e humanizmit evropian? ***Produkti*** Një analizë e shkurtër ku nxënësi: • gjykon vlerat artistike të veprës; • analizon ndërtimin e figurës së Skënderbeut; • identifikon tipare të humanizmit evropian; • argumenton pse vepra konsiderohet pjesë e kulturës dhe letërsisë së Rilindjes.
Nxënësi analizon tiparet dhe parimet estetike të klasicizmit.	**Veprimtaria "Rregull apo krijimtari?"** ***Prezantimi i veprimtarisë*** Mësuesi paraqet dy pohime: • Arti duhet të ndjekë rregulla të qarta.

	• Arti duhet të jetë plotësisht i lirë nga çdo rregull. Nxënësit pozicionohen pranë pohimit me të cilin pajtohen më shumë dhe argumentojnë shkurt zgjedhjen e tyre. Më pas mësuesi shpjegon se kjo ishte një nga çështjet kryesore që qëndron në themel të *klasicizmit*, një drejtim letrar dhe artistik që vlerësonte harmoninë, arsyen, rregullin dhe imitimin e modeleve të Antikitetit. ***Zhvillimi i veprimtarisë*** *Hapi 1: Zbulimi i parimeve të klasicizmit* Nxënësit punojnë në grupe me materiale informuese për klasicizmin. Ata evidentojnë: • kultin e arsyes; • kërkimin e harmonisë dhe të masës; • imitimin e autorëve antikë; • synimin edukativ dhe moral të artit; • respektimin e rregullave artistike; • ndarjen e qartë të gjinive letrare. Çdo grup përgatit një përkufizim të shkurtër të klasicizmit. *Hapi 2: Analiza e një vepre klasiciste* Nxënësit lexojnë një fragment nga "*Tartufi*" ose një vepër tjetër klasiciste. Ata analizojnë: • si paraqitet arsyeja dhe logjika;

	• si ndëshkohen veset dhe shpërblehen virtytet; • si ndërtohet konflikti; • si ruhet qartësia dhe rregulli në zhvillimin e veprimit. Diskutojnë: *Në cilat elemente të fragmentit shfaqen idealet e klasicizmit*? *Hapi 3: Gjurmët e Antikitetit* Mësuesi paraqet disa karakteristika të letërsisë greko-romake: • modeli i heroit; • funksioni edukativ i artit; • harmonia dhe masa; • respekti për rregullat. Nxënësit analizojnë: *Pse klasicistët i konsideronin autorët antikë modele për t'u ndjekur? Çfarë përfitonte arti nga ky rikthim te Antikiteti?* *Hapi 4: Debati* Çdo grup merr një tezë: • Rregullat artistike ndihmojnë krijimtarinë. • Arti duhet t'i shërbejë edukimit moral. • Arsyeja duhet të mbizotërojë mbi emocionin.

	• Modelet klasike mbeten të vlefshme për çdo kohë. Nxënësit argumentojnë duke u mbështetur në parimet e klasicizmit. *Hapi 5: Klasicizmi nën gjykim* Mësuesi u drejton nxënësve pyetjen: *A janë parimet e klasicizmit ende të vlefshme për artin bashkëkohor?* Nxënësit diskutojnë në grupe dhe mbajnë qëndrim të argumentuar, duke krahasuar idealet klasiciste me konceptet moderne të lirisë krijuese. ***Reflektimi*** Nxënësit shkruajnë një paragraf ku shpjegojnë: • cilat janë parimet themelore të klasicizmit; • si shfaqen ato në letërsi; • cili prej tyre u duket më i rëndësishëm dhe pse. ***Produkti*** *Një hartë koncepti me temën "Klasicizmi: arti i arsyes dhe i rregullit",* ku nxënësi: • identifikon tiparet kryesore të klasicizmit; • analizon parimet estetike që e karakterizojnë; • i ilustron me shembuj nga veprat e studiuara.

LËNDA: GJUHË ANGLEZE

Veprimtaritë në lëndën e gjuhës angleze për klasën e dhjetë janë hartuar duke u mbështetur në nivelin B1 të Kuadrit të Përbashkët Evropian të Referencave për Gjuhët dhe Volumit Shoqërues, për të përmbushur shtatë rezultatet kryesore të të nxënit për këtë klasë. Rezultatet e të nxënit të përcaktuara në programin lëndor janë të organizuar sipas veprimtarive gjuhësore: *reception activites (oral comprehension, reading comprehension), production activites (oral production, written production),interaction activities (oral interaction, written interaction), mediation activities.*

Për secilën veprimtari, rezultatet e të nxënit janë konkretizuar dhe përshtatur në përputhje me tema të ndryshme mësimore, duke i lidhur ato me përvoja dhe situata sa më pranë jetës reale të nxënësve. Kjo qasje synon të mbështesë zhvillimin e kompetencave të lëndës dhe përdorimin e gjuhës në mënyrë të natyrshme dhe të zbatueshme në komunikimin e përditshëm.

RECEPTION ACTIVITIES

Table 1: Oral comprehension activities

LO 1: The student understands the main points made in clear standard language or a familiar variety on familiar matters regularly encountered at work, school, leisure, etc., including short narratives.	
Activity 1: Follow the tour!	
LO: The student identifies the main points and key factual	*In this activity, students listen to a guided tour of a famous museum and identify the main points and key factual details in order to complete a meaningful task.*

details from a guided tour of a famous landmark or museum.	*The teacher describes the learning situation by telling students that they are visitors in a famous museum and they will follow a guided tour to collect important information.* *The teacher briefly pre-teaches key vocabulary (e.g. exhibition, hall, statue, built, century, guide) and shows 3–4 pictures of the museum to activate background knowledge and support understanding.* *Students receive a simple "visitor task sheet" with prompts such as:* • *What place is this? What can you see there?* • *When was it built?* • *What is special about it?* *Then, students listen to a short guided tour recording (or the teacher reading) and take notes. The recording is played twice: the first time for general understanding, and the second time to focus on identifying important facts and details.* *During the first listening, the classroom is organised as a "museum" with 3-4 stations (e.g. Entrance Hall, Gallery, Garden, Gift Shop). The teacher reads parts of the guided tour, pausing at key moments. After each pause, students decide which part of the museum the guide is describing and move to the corresponding location. Then, they briefly explain their choice using simple language.* *Before the second listening, each group receives a mission card such as:* • *Find one historical fact.* • *Find something the guide recommends.*

	After that, students listen again, focusing on their specific task, and use their notes to locate and record the required information. *Students work in groups to prepare a short mini guided tour based on the information they have understood. One student from each group takes on the role of the tour guide and presents their tour to another group.* *The teacher guides the listening activity, monitors how students identify the main ideas and the details, and supports them in using the information to produce short spoken responses.*
Activity 2: Social media safety	
LO: The student understands the step-by-step technical instructions for adjusting privacy settings and security features on a social media profile.	*In this activity, students develop their listening comprehension skills by following step-by-step technical instructions related to adjusting privacy settings and security features on social media platforms.* *The teacher introduces the situation: "Today you are digital safety assistants. Your task is to listen carefully to technical instructions and help secure a social media account."* *As a warm-up activity the teacher briefly revises key vocabulary related to online privacy and security privacy settings, password, two-factor authentication, etc. The teacher also demonstrates some common icons and menu options students may encounter on social media platforms such as Instagram, TikTok or Snapchat.* *The teacher plays a short tutorial video as for example:* • *Master your social media privacy settings- step-by-step guide https://www.youtube.com/watch?v=w_QdpSryyUE* • *How do I block someone from using My Wi-Fi? https://www.youtube.com/watch?v=24AyLCLsz5Y*

	• *How to add two factor authentication to your google account* *https://www.youtube.com/watch?v=rPxr2y7PH-M* *First, students listen and watch without taking notes in order to understand the general process. During the second viewing, students complete a simple "Digital safety checklist" where they identify the order of the steps, important actions, security features mentioned in the instructions, as for example:* • *Open settings, click privacy, turn on private account, etc.* *After that, students work in groups. The teacher presents each group with short digital safety problems connected to social media use.* *For example:* • *A stranger is sending messages.* • *Your location is public.* • *Your password is weak.* *After listening to the problem, students discuss possible solutions together and decide which privacy or security setting should be changed, what actions should be taken, which security features could help solve the problem. They use ideas and vocabulary from the tutorial video while discussing their solutions.* *After the discussion, students move to a short role-play activity. One student becomes the "Tech support assistant" and gives step-by-step instructions in English on how to solve the problem, while the second student*

	acts as the "User" and follows the instructions using a simulated social media profile, screenshots or setting cards. *The teacher's role is to select age-appropriate and realistic digital safety materials, support students in following spoken instructions step by step, encourage active listening and peer support, and monitor students' comprehension through task completion and reactions*
Activity 3: Travel control room	
LO: The student understands the main points and key information in public announcements at airports, stations and on planes, buses and trains, when spoken clearly and at normal speed.	*In this activity, students become members of an international travel control room. Their task is to listen to authentic travel announcements from airports, stations and transport services and help passengers reach the correct destination by identifying key information.* *The teacher introduces a real life situation: " Today you are travel coordinators. Passengers need your help to understand announcements and avoid missing their flights, trains or buses."* *The teacher briefly revises key travel vocabulary: gate, boarding, platform, departure, delay, etc. The teacher uses authentic listening material from YouTube:* • *Airport announcements in English https://www.youtube.com/watch?v=10Wx0hlIPhk* • *Boarding announcement https://www.youtube.com/watch?v=fHL5OK2CXps* *Students work in groups of 3–4. Each group receives passenger travel cards containing incomplete information. For example: Passenger A: Flight: _____, Gate: _____, Problem: _____* *Students listen to the announcements and complete the missing information. The teacher encourages students to focus on: destination, gate/platform number, departure time, delays or boarding information.*

	Then, the classroom is organised into different transport zones: Airport gate area, train station and bus terminal. *The teacher appoints some students to act as travel coordinators, while the remaining students become passengers. Each passenger receives a travel card with a problem or missing information.* *For example:* • *I missed the announcement. Where should I go?* • *Has my bus changed?* *The travel coordinators use the information collected during the listening task and respond to the passengers by making announcements and giving travel information.* *For example:* • *Passengers for Flight BA452 to London, please go to Gate 12.* • *Train 208 to Paris departs from Platform 5.* *The passengers listen carefully to the announcements made by the coordinators and move to the correct transport zone. The activity continues with new travel problems, announcements and changes (gate changes, delays, platform changes), allowing different students to take the role of travel coordinators.* *The teacher's role is to select authentic travel announcements and prepare passenger travel scenarios, guide students in identifying key travel information from the announcements, and monitor students' ability to understand, interpret and react to announcements in different transport contexts.*

Table 2: Reading comprehension activities

LO 2: The student reads straightforward factual texts on subjects related to their field of interest with a satisfactory level of comprehension.	
Activity 1: Job hunters online	
LO: The student understands emails, notices and online posts related to part-time jobs or volunteering opportunities, identifying the main message and key information.	*In this activity, students become "job hunters" searching for the best part-time jobs and volunteering opportunities online. Through authentic-looking emails, notices, social media posts and digital advertisements, students practise reading for key information and identifying the main message of different texts.* *First, the teacher introduces the situation: "Imagine you are looking for a summer job, a volunteering project or a student opportunity. Your task is to search, compare and decide which opportunities are the most interesting and suitable for you."* *As a warm up activity, the teacher briefly revises useful reading strategies and key vocabulary such as requirements, location, deadline, etc.* *The teacher also revises scanning and skimming strategies such as reading titles and headings first, identifying keywords, etc.* *Students work in pairs or small groups. The teacher asks students to search online for real part-time job advertisements, volunteering opportunities, online posts, emails or digital notices suitable for teenagers and young people. Students may search through websites, social media pages, school or community announcements, volunteering platforms, student job advertisements.*

	After selecting the materials, students analyse the texts together and identify the main message, responsibilities and requirements, working hours or dates, location, contact information, benefits or opportunities offered. *Then, each group receives different student profiles.* *For example:* • *Mira is 16, likes photography and is free at weekends.* • *Endri enjoys sports and wants volunteer experience.* *Students must quickly decide which opportunity best matches each student profile using evidence from the texts.* *If time allows, each group chooses one opportunity they believe is the most interesting for teenagers and presents it briefly to the class by explaining what the opportunity is, who it is suitable for, why students might be interested in it.* *For example:* • *This volunteering opportunity is good for creative students. The job is flexible and students can work after school.* *As home work, the teacher may assign students to write emails or messages related to the opportunities.*

<table>
<tr><td></td><td>The teacher's role is to support students when selecting the materials, guide students in using reading strategies effectively, support students in identifying key information quickly, monitor comprehension through discussion and task completion.</td></tr>
<tr><th colspan="2">Activity 2: SmartLab safety</th></tr>
<tr><td>LO: The student understands most short safety instruction in manuals for the use of electrical equipment.</td><td>
In this activity, students read and understand short extracts from user manuals and safety instructions related to equipment commonly used in the SmartLab such as smartboards, laptops and tablets.
The teacher introduces the learning situation: "The school is opening a new SmartLab. Before students can use the equipment, your team must check the manuals and make sure that all devices are used safely."
The teacher starts by doing a brainstorming activity to teach and revise vocabulary. (switch off, plug in, disconnect, charging cable, screen, keep away from liquids, etc).
Students work in groups of three. Each group receives:

Smartboard manual extract
Laptop safety instructions
Tablet user guide

Students read the extracts and complete a worksheet as in the following example:
<table>
<tr><th>Device</th><th>Safety rule</th><th>Why is it important?</th></tr>
<tr><td>Laptop</td><td>Keep away from water</td><td>Protect the device</td></tr>
<tr><td></td><td></td><td></td></tr>
<tr><td></td><td></td><td></td></tr>
</table>
</td></tr>
</table>

	After completing the worksheet, the teacher presents students with short SmartLab situations as for example: • *A student sprays cleaner directly on the smartboard.* • *A laptop is placed next to a bottle of water.* • *A student uses another charger for the tablet.* *Students work in groups to identify the problem, find the correct instruction in the manual, and explain the solution.* *For example:* • *Do not use liquids directly on the screen!* • *Use only the original charger!* *As a follow up activity each group prepare a short oral briefing for new students entering the SmartLab and then present their safety tips to the class.* *The teacher's role is to select and adapt short manual extracts related to SmartLab equipment, guide students in identifying important safety instructions while reading the manuals, and support students in applying information from manuals to real classroom situations.*
Activity 3: Global opportunities	
LO:The student understands standard formal correspondence	*In this activity, students explore and understand authentic online posts, emails and announcements related to courses, exchange programmes and youth activities in order to choose suitable opportunities.*

and online postings related to courses, exchange programmes and youth activities.	*The teacher presents the learning situation: "Imagine that your school has been invited to participate in an international Youth Opportunities Fair. Your team must explore different opportunities and help other students decide which programmes are the most suitable for them."* *As a warm up activity, the teacher briefly revises some useful vocabulary such as: exchange programme, application, deadline, requirements, course, etc.* *In the previous class, the teacher has asked students to search online for different opportunities related to exchange programmes, online courses, volunteering projects, youth camps, etc.* *Students might have explored school and university websites, Erasmus+ youth pages, youth organisations, social media pages and bring screenshots, printed copies or links to class.* *Students work in groups and select one of the opportunities they have found. They read and analyse the material in order to identify the main information and understand the type of opportunity, its purpose, the target participants, requirements and application criteria, as well as other information such as dates, deadlines, location and benefits for participants.* *After that, the teacher gives groups different student profiles as for example:* • *Sara (16): interested in technology and international projects.* • *Ana (15): wants to improve English.* *Groups read the opportunities again and decide which programme best matches each profile. Groups justify their choices using evidence from the texts.* *As a follow up activity, the teacher organizes a youth opportunities fair. One student from each group stays at the stand as programme representative while the others move around visiting different opportunities.*

	Representatives explain the opportunity briefly and answer classmates' questions. Visitors collect information and vote for the best international opportunity, the most interesting programme, the best learning experience, etc. *The teacher's role is to guide students in selecting authentic materials, support them in identifying the information from formal texts and online posts, and monitor students' reading comprehension.*

PRODUCTION ACTIVITIES

